



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Inputi për Raportin e Progresit

Maj 2011
PRISHTINË

TABELAT	3
LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE	4
HYRJE	8
1. KRITERET POLITIKE	9
1.1. DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I LIGJIT	9
1.1.1. <i>Institucionet</i>	9
1.1.2. <i>Parlamenti / Zgjedhjet</i>	9
1.1.3 <i>Administrata Publike</i>	10
1.1.4. <i>Sistemi gjyqësor</i>	11
1.1.5. <i>Politikat Kundër Korrupsion</i>	13
1.2. TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E MINORITETEVE	14
1.2.1 <i>Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve</i>	14
1.2.2. <i>Të drejtat e minoriteteve, të drejtat kulturore dhe mbrojtja e minoriteteve</i>	15
1.3 ÇËSHTJET RAJONALE DHE OBLIGIMET NDËRKOMBËTARE	17
2. KRITERET EKONOMIKE	20
2.1. FUNKSIONIMI I EKONOMISE SË TREGUT	20
2.1.1. <i>Raportimi në lidhje me zhvillimet e fundit ekonomike</i>	20
2.1.2. <i>Raporti për politikat monetare dhe fiskale gjatë periudhës raportuese</i>	24
2.1.3. <i>Funksionimi i tregjeve të produkteve</i>	26
2.1.4. <i>Sektori financiar</i>	28
2.2. KAPACITETI PËR TU PËRBALLUR ME PRESIONIN E KONKURENCËS DHE FORCAVE TË TREGUT BRENDA UNIONIT	29
2.2.1. <i>Kapitali Njerëzor dhe Fizik</i>	29
2.2.2. <i>Reforma dhe liberalizimi i industrive të rrjetit</i>	32
2.2.3. <i>Zhvendosjet strukturore në ekonomi</i>	34
2.2.4. <i>Intervenimet e Qeverisë në ekonomi</i>	35
2.2.5. <i>Integrimi tregtar</i>	36
3. STANDARDET EVROPIANE	37
3.1. TREGU I BRENSHËM	37
3.1.1 <i>Lëvizja e Lirë e Mallrave</i>	37
3.1.2. <i>Lëvizja e Lirë e Kapitalit</i>	38
a. <i>Doganat</i>	39
a. <i>Administrata Tatimore e Kosovës</i>	40
3.1.4. <i>Konkurrenca</i>	41
3.1.5. <i>Prokurimi Publik</i>	41
3.1.6. <i>Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale dhe të Drejtat e Autorit</i>	42
3.1.7. <i>Punësimi dhe Politikat Sociale</i>	42
3.1.8. <i>Arsimi dhe Hulmtimi</i>	45
3.2. POLITIKAT SEKTORIALE	46
3.2.1. <i>Industria dhe NVM-të</i>	46
3.2.2 <i>Bujqësia dhe Peshkataria</i>	47
3.2.3 <i>Mjedisi</i>	48
3.2.4. <i>Politikat e Transportit</i>	50
3.2.5. <i>Energjia</i>	50
3.2.6. <i>Shoqëria Informativë dhe Media</i>	52
3.2.7. <i>Kontrolli Financiar</i>	53
3.2.8. <i>Statistikat</i>	54
3.3. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA	55
3.3.1. <i>Vizat, kufijtë, azili dhe migrimi</i>	55
3.3.2. <i>Pastrimi i Parave</i>	61

3.3.3. Policia dhe Luftimi i Krimin të Organizuar.....	61
3.3.4. Mbrojtja e të dhënave personale	64
4. ANEKSI I: LISTA E LEGJISLACIONIT PRIMAR DHE SEKONDAR TË MIRATUAR GJATË PERIUDHËS 7 TETOR 2010 - 30 PRILL 2011.....	65
5. ANEKSI II: TABELAT	76

TABELAT

Tabela 1 - BPV nominale dhe reale sipas shpenzimeve	21
Tabela 2 - Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm, si % në GDP	22
Tabela 3 - Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm 2008-2011, në milion euro	23
Tabela 4 - Normat efektive të këmbimit, nominale dhe reale	25
Tabela 5 - Bruto borxhi shtetërorë si % e GDP-së.....	26
Tabela 6 - Pjesëmarrja e sektorit privat në BPV, në përqindje	27
Tabela 7 - Investimet private dhe publike, në miliona euro	30
Tabela 8 - Pjesëmarrja e FDI në GDP dhe vlera kumulative e FDI nga viti 2004.....	30
Tabela 9 - Hapërdarja e FDI nëpër sektorë, si përqindje e totale FDI	31
Tabela 10 - Të dhënat mbi kontrollin e personave dhe automjeteve në kufi (tetor 2010 – prill 2011)*	59
Tabela 11 - Të dhënat mbi shfrytëzimin e Fondit për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar gjatë periudhës raportuese (tetor 2010 – prill 2011).....	59
Tabela 12 - Të dhënat mbi azilkërkuesit (2009 – 2011)*	60
Tabela 13 - Të dhënat mbi luftimin e krimeve ekonomike dhe korrupsionit gjatë periudhës raportuese (tetor 2010 – mars 2011)	61
Tabela 14 - Të dhënat mbi kundërvajtjet gjatë periudhës raportuese – të gjithëmbarshme (tetor 2010 – prill 2011)	62
Tabela 15 - Të dhënat mbi kundërvajtjet gjatë periudhës raportuese – pjesa e Policisë Kufitare (tetor 2010 – prill 2011)	63
Tabela 16 - Të dhënat mbi luftimin e drogave gjatë periudhës raportuese (tetor 2010 – prill 2011)*	63
Tabela 17 - Të dhënat mbi sasinë (në gram) e narkotikëve të konfiskuar gjatë periudhës raportuese (tetor 2010 – prill 2011).....	63
Tabela 18 - Të dhënat mbi luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore gjatë periudhës raportuese (tetor 2010 – prill 2011).....	64
Tabela 19 - Të dhënat mbi luftimin e llojeve të tjera të krimit ndërkufitar gjatë periudhës raportuese (tetor 2010 – prill 2011)*	64
Tabela 20 - Të dhënat mbi konfiskimet në kufi gjatë periudhës raportuese (tetor 2010 – prill 2011)	64
Tabela 21 - Të hyrat, shpenzimet dhe bilanci aktual për vitin 2010 dhe projekt-buxheti 2011.....	76
Tabela 22 - Operacionet mujore të Qeverisë qendrore gjatë vitit 2010	77
Tabela 23 - Trendi i të hyrave buxhetore, 2007 – 2010	77
Tabela 24 - Operacionet mujore të Qeverisë lokale gjatë vitit 2010	78
Tabela 25 - Treguesit e sektorit bankar	78
Tabela 26 - Trajnimet në Agjencinë Kosovare të Privatizimit	79

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
AKB	Aleanca Kosovare e Bizneseve
ARBK	Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë
AKK	Autoriteti i Kualifikimeve Kombëtare
AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
APP	Agjencia për Prokurim Publik
ART	Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (<i>Central European Free Trade Agreement</i>)
DAK	Drejtoria e Akreditimit të Kosovës
DASHC	Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil
DK	Doganat e Kosovës
DMRAPIE	Departamenti për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike dhe Integritimeve Evropiane
DPI	Departamenti i Pronësisë Intelektuale

ECAA	Hapësira e Përbashkët Evropiane e Aviacionit (<i>European Common Aviation Area</i>)
ESK	Enti i Statistikave të Kosovës
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
FADN	Rrjeti i te Dhënave për Kontabilitetin e Fermave (<i>Farm Accountancy Data Network</i>)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GND	Grupi Ndërministror për Decentralizim
GP	Grupi Punues
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IFS	Institucionet Ndërkombëtare Financiare
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
IOM	Organizata ndërkombëtare e Migrimit (<i>International Organization for Migration</i>)
IPA	Instrumenti për asistencë të Para Anëtarësimit
KE	Komisioni Evropian
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KK	Kuvendi/et Komunal/e
KKK	Korniza e Kurrikulumi të Kosovës
KKDFE	Kompania Kosovare e Distribuimit dhe Furnizimit me Energji Elektrike
KOSTT	Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës
KPK	Komisioni për parandalimin e korrupsionit
KPMM	Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve
KPGJP	Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MAP	Ministria e Administratës Publike
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë

MF	Ministria e Financave
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MFSK	Ministria e Forcës dhe Sigurisë
MIE	Ministria e Integritimit European
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MM	Memorandum Mirëkuptimi
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MI	Ministria e Infrastrukturës
NJDNJK	Njësia për të Drejtat e Njeriut të Komunave
NP	Ndërmarrje Publike
NSH	Ndërmarrje Shoqërore
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
OEAK	Oda Ekonomik Amerikane e Kosovës
OJQ	Organizatata Jo-Qeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OShP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PK	Policia e Kosovës
PKK	Pika e Kalimit Kufitar
PSH	Prokuroria e Shtetit
PTB	Projekti Tam/Bas
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
PVPE	Plani i Veprimit për Partneritet Evropian
QAP	Qendra për Aftësim Profesional
Projekti RAE	Projekti për Romët, Ashkalitë dhe Egjiptasit
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
SMIL	Sistemi i Menaxhimit Informativ të Lëndëve

SHKCAK	Shoqata e Kontabilisteve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
TAIEX	Asistence teknike dhe shkëmbim i informacionit (<i>Technical Assistance and Information Exchange</i>)
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UA	Udhëzim Administrativ
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (<i>United Nations Development Programme</i>)
UNHCR	Zyra e Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (<i>Office of the United Nations High Commissioner for Refugees</i>)
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZÇK	Zyra për çështje të komuniteteve
ZKK	Zyra për Kthim dhe Komunitete
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZPI	Zyra për Pronësi Industriale
ZRE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
ZRRUM	Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina

Hyrje

Ky raport përmban zhvillimet kryesore në Kosovë nga tetori 2010 deri në fund të prillit 2011. Qeveria e Republikës së Kosovës ka shprehur gatishmërinë e saj për t'i dorëzuar të dhënat shtesë për këtë periudhë tre mujore për Raportin e Progresit të Kosovës për Komisionin Evropian, i cili do të publikohet në vjeshtën e këtij viti.

Të dhënat e prezantuara në këtë raport fokusohen në arritjet e bëra karshi:

- zbatimit të reformave
- zhvillimin e kapaciteteve legislative dhe administrative
- sfidat e identifikuara në raportin e progresit të Komisionit Evropian për vitin 2010, dhe
- Zbatimin e prioriteteve të Partneritetit Evropian, përmes Planit të Veprimit për Partneritet Evropian

Struktura e të dhënave korrespondon me Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2010 duke ofruar informata mbi tri fushat në vijim: Kriteret Politike, Kriteret Ekonomike dhe Standardet Evropiane. Raporti gjithashtu është i bazuar në raporte periodike të hartuara nga institucionet e Republikës së Kosovës.

1. KRITERET POLITIKE

1.1. Demokracia dhe Sundimi i Ligjit

1.1.1. Institucionet

Më 2 nëntor 2010 u shpërnda Kuvendi, pas votimit të mocionit të votëbesimit. Pas mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme të 12 dhjetorit 2010, Kuvendi i dalë nga to u konstituua më 22 shkurt 2011, kur edhe u zgjodh Presidenti dhe Qeveria.

Sidoqoftë, më 30 mars 2011, Gjykata Kushtetuese shpalli vendimin me anë të të cilit u interpretua se zgjedhja Presidentit, më 22 shkurt 2011, ishte në kundërshtim me dispozitat kushtetuese. Si rezultat, rivotimi për zgjedhjen e Presidentit u zhvillua më 7 prill 2011, kur edhe u zgjodh Presidenti i ri.

Në bazë të PVPE 2011, me qëllim të adresimit të prioritetëve në fushën e institucioneve, Qeveria, me vendimin nr. 02/02 të datës 2 mars 2011, ka miratuar Rregulloren nr. 01/2011 për Departamentet për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, e cila ka hyrë në fuqi pas nënshkrimit nga Kryeministri më 18 mars 2011.

Ndërsa në drejtim të ngritjes së kapaciteteve administrative të Kuvendit të Kosovës, nga 1 tetori 2010 deri në fund të marsit 2011 janë mbajtur gjithsej 22 trajnime për stafin administrativ të Kuvendit, ku kanë marrë pjesë 159 zyrtarë. Trajnimet kanë mbuluar këto fusha: politikat anti-korrupsion, menaxhimin e resurseve humane, shërbimin civil, arkivat, raportimin financiar, menaxhimin e ciklit të projektit, legjislacionin e BE-se dhe negocimin gjatë procesit të integritimit evropian, si dhe auditimin e korporatave multinacionale.

1.1.2. Parlamenti / Zgjedhjet

Me qëllim të *avancimit të kornizës ligjore* me synim të përmirësimit të transparencës së punës së Kuvendit, më 19 prill 2011 Ju lutem vëreni se Kryesia e Kuvendit të Kosovës me date 19 prill 2011, me propozimin e Sekretarit të Kuvendit të Kosovës z. Ismet KRASNIQI ka miratuar aprovuat Rregulloren për Rendin dhe Qasjen e Mediave dhe të Publikut në Punën e Kuvendit të Kosovës, përmes së cilës rregullohet pjesëmarrja e qytetarëve në seancat plenare dhe mbledhjet e Komisioneve Parlamentare. Në fushën e zgjedhjeve, më 12 dhjetor 2010 janë mbajtur zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Kosovës. Në këto zgjedhje pjesëmarrja e qytetarëve me të drejtë vote ishte 45.29%.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia si dhe Gjykata Supreme e Kosovës kanë vendosur për përsëritjen e zgjedhjeve në Skenderaj, Gillogoc, Deçan dhe në dy qendra votimi në Lipjan dhe Malishevë, më 9 janar 2011, kurse në Komunën e Mitrovicës më 23 janar 2011.

Janë gjithsej 141 raste të mashtrimit gjatë zgjedhjeve të paraqitura në prokuroritë e Kosovës. KPK ka vendosur t'i japë përparësi procedimit të këtyre rasteve.

1.1.3 Administrata Publike

Në drejtim të reformës së administratës publike janë miratuar këto akte nënligjore për zbatimin e Ligjit mbi Shërbimin Civil:

- Rregullorja për procedurat e rekrutimit;
- Rregullorja për përshkrimin e vendeve të punës;
- Rregullorja për orarin e punës;
- Rregullorja për përfaqësim të drejtë dhe proporcional të komuniteteve jo-shumicë në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;
- Rregullorja për transferimin e nëpunësve civilë;
- Rregullorja për emërimin e nëpunësve civilë;
- Rregullorja për ndërprerjen, pezullimin dhe përfundimin e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil;
- Rregullorja për punën provuese;
- Rregullorja mbi dosjet dhe Regjistrin Qendror të Nëpunësve Civilë;
- Rregullorja për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Për më tepër, sa i përket zbatimit të Ligjit për Administratën Shtetërore është miratuar Rregullorja nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive. Për më tepër, më 7 tetor 2010 Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë, i cili është shpallur në Gazetën Zyrtare më 3 nëntor 2010. Më 1 prill 2011 ka filluar regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, i cili ka përfunduar më 19 prill 2011.

Në drejtim të ngritjes së kapaciteteve të shërbyesve civilë, në DASHC janë punësuar tre zyrtarë si dhe janë organizuar trajnime për aftësimin e dy nëpunësve civilë për menaxhimin e sistemit të zhvillimit të burimeve njerëzore. Ndërsa DMRAPIE ka përpiluar raportin vlerësues mbi zbatimin e planit zhvillimor strategjik të MAP-it. Për më tepër, në këtë drejtim IKAP gjatë periudhës 1 janar - 30 mars 2011 ka organizuar kurse trajnime në fushat e prokurimit publik, administratës së përgjithshme, Teknologjisë Informative, Bashkimit Evropian, ku kanë marrë pjesë zyrtarë nga kategoritë funksionale drejtuese dhe ekzekutive (gjithsej 631 pjesëmarrës).

Në drejtim të avancimit të procesit të qeverisjes lokale dhe decentralizimit, më 28 tetor 2010 është miratuar Ligji nr. 03/L-226 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe është hartuar Rregullorja për Vlerësimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunave. Për më tepër MAPL ka hartuar raportin mbi identifikimin e kolizioneve të ligjeve me legjislacionin për vetëqeverisje lokale, i cili i është prezantuar GND-së. Ndërsa në bashkëpunim me MIE është finalizuar Udhëzimi mbi Përgjegjësitë e Komunave në Procesin e Integritimit Evropian.

Për më tepër, është zhvilluar sistemi i bazuar në indikatorë për vlerësimin e performancës së komunave, i cili është vënë në funksion në të gjitha komunat, me përjashtim të Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit. Të përfshira në këtë sistem janë pesëmbëdhjetë shërbime, të cilat i ofron komuna për qytetarët, bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Në drejtim të ngritjes së kapaciteteve të zyrtarëve komunalë, në muajin mars 2011 është përfunduar Plani Strategjik 2011 – 2015 për ndërtimin e kapaciteteve në komuna. Më tej, janë mbajtur 10 module të trajnimeve për komunat e reja: Graçanicë, Ranillug, Kllokot, Partesh dhe komunat e tjera, ku kanë marrë pjesë 149 zyrtarë komunalë, prej tyre 52 nga komuniteti serb. Gjithashtu janë caktuar 36 zyrtarë të NJDNJ-ve në komunat e reja si dhe në shkurt 2011 është miratuar programi përkrahës për zhvillimin e kapaciteteve të NDNJ-ve në komunat e reja, e në këtë kontekst deri më tani janë mbajtur dy trajnime për 18 zyrtarë, dhe janë planifikuar edhe 18 trajnime të tjera, si vazhdimësi për zyrtarët e tjerë.

1.1.4. Sistemi gjyqësor

Sa i përket kompletimit të kornizës institucionale në sistemin gjyqësor, gjatë periudhës raportuese është themeluar Këshilli Prokurorial dhe Sekretariati i Këshillit Prokurorial. Ndërsa me qëllim të funksionalizimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, më 4 mars 2011 është miratuar Rregullorja e Punës së këtij Këshilli. Për më tepër, më 4 mars 2011 është miratuar Rregullorja për Komisionet për Rekrutim dhe Masa Disiplinore.

Me qëllim të implementimit të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës është bërë përzgjedhja e Kryetarit dhe dy anëtarëve të Komisionit Disiplinor për Gjyqtarë. Gjithashtu gjatë periudhës raportuese MD ka miratuar Rregulloren për Procedurat e Brendshme.

Gjithashtu, në drejtim të reduktimit të lëndëve të vjetra, Këshilli Gjyqësor i Kosovës më 1 nëntor 2010 ka miratuar Strategjinë Shtetërore për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra, ndërsa sa i përket normave për identifikimin e kategorive sipas llojit të lëndëve është miratuar Rregullorja për Përcaktimin e Normave të Detyrueshme për Gjyqtarë, ajo për Shpërndarjen e Lëndëve dhe Rregullorja për Vlerësimin e Punës së Gjyqtarëve. Po ashtu më 11 shkurt 2011 janë miratuar udhëzimet administrative për: (1) lirim nga taksat gjyqësore, (2) shpenzimet dhe paushallët në rastet penale, civile, (3) dhe për ekzekutime, (4) për numër unik për një lëndë dhe (5) Qarkoren për çështjet e kompensimit të gjykatësve dhe personelit ndihmës të gjykatës për “Këqyrje në vend”.

Sa i përket implementimit të Strategjisë Shtetërore për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra dhe koordinimit ndër-institucional Këshilli Gjyqësor ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me Policinë e Kosovës, për konsolidim dhe avancim të bashkëpunimit, me Ministrinë e Punëve të Brendshme, për sigurimin e qasjes së gjykatave në regjistra civilë, me Postën dhe Telekomunikacionin e Kosovës, për konsolidim dhe avancim të bashkëpunimit, me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për sigurimin e qasjes së gjykatave në informatat që posedon Agjencia Kadastrale, me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, për procedimin e lëndëve gjyqësore me palë biznesore, dhe me Bankën Qendrore, për identifikimin e llogarive bankare në procedimin e lëndëve përmbartimore civile. Gjithashtu KGJK ka miratuar Planin Kornizë për Hartimin e Akteve Nënligjore që dalin nga Ligji mbi Gjykatat dhe janë formuar grupet punuese përkatëse.

Për më tepër, për sa i përket fuqizimit të koordinimit ndër-institucional, Këshilli Prokurorial ka nënshkruar MM me Doganën e Kosovës (21 janar 2011), Këshillin Gjyqësor të Kosovës (3 mars 2011), Ministrinë e Drejtësisë (16 mars 2011), si dhe me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Gjithashtu është përzgjedhur Drejtori i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe është themeluar Zyra për Verifikimin dhe Vlerësimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Ndërsa sa i përket procesit të dytë të emërimit, më 16 shkurt 2011 është miratuar Rregullorja për Emërimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në përputhje me kriteret e parapara nga KPGJP, ndërsa lidhur me aplikimin e kriterëve për emërim, me kërkesë nga KGJK janë mbajtur trajnime për anëtarët e panelit vlerësues nga kryetari i KPGJP-së me qëllim të shkëmbimit të praktikave dhe kriterëve të përdorura nga KPGJP. Në kuadër të këtij procesi është shpallur konkursi për 112 pozita për gjyqtarë dhe 45 për prokurorë, për të gjitha nivelet e gjykatave dhe prokurorive të Kosovës. Paraprakisht, është mbajtur provimi i kodit të etikës si dhe duke bërë përzgjedhjen e kandidatëve që do ta ndjekin. Nga numri i përgjithshëm 112 të pozitave të lira për gjyqtarë dhe 45 për prokurorë, 26 pozita janë shpallur për komunitetet pakicë. I tërë procesi i emërimit është planifikuar të përfundojë në fund të vitit 2011. Për më tepër, me qëllim të rritjes së performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve janë ngritur pagat prej 60% deri në 100%.

Me qëllim të avancimit ligjor të gjyqtarëve dhe prokurorëve aktualë, KGJK ka mbajtur trajnime mbi implementimin e Doracakut për Menaxhimin e Gjykatave, ku janë trajnuar lidershpi i të gjitha gjykatave (53 Kryetarë të gjykatave) dhe 53 administratorë të gjykatave, si dhe 397 përdorues të SMIL-it, dhe janë punësuar 3 zyrtarë mbështetës të TI-së, në Gjykatat Komunale të Prishtinës, Ferizajt dhe atë të Gjakovës.

Po ashtu, Instituti Gjyqësor i Kosovës, në dhjetor 2010, ka organizuar një trajnim dyditor për luftimin e krimit kibernetik, një trajnim një ditor për krimin e organizuar, dhe nga 1 tetori 2010 e deri më 11 shkurt 2011 janë mbajtur trajnime për kandidatët potencialë për gjyqtarë dhe prokurorë të gjeneratës së tretë lidhur me krimin financiar dhe trafikimin me qenie njerëzore. Më tej, në mars 2011 është përgatitur Provimi përgatitor/Hyrës për gjeneratën e katërt të kandidatëve potencialë për gjyqtarë dhe prokurorë, ndërsa në kuadër të Programit për Avancim Ligjor më 1 tetor të vitit 2010 është mbajtur një trajnim për krimin e organizuar. Më tej, më 1-2 shkurt 2011 janë mbajtur dy trajnime për krim të organizuar. Për më tepër, në drejtim të implementimit të reformës së sistemit të arsimit ligjor, IGJK ka filluar zbatimin e projektit *E-learning për Gjyqtarë dhe Prokurorë*.

Përveç kësaj, gjatë periudhës raportuese është publikuar numri i dytë i revistës shkencore të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë, 'Justicia', si dhe Raporti Vjetor i IGJK-së, broshura informative për IGJK-në, Raporti për organizimin e Provimit Përgatitor, Programi Vjetor i punës për vitin 2011, si dhe buletinet mujore.

Në drejtim të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar janë ratifikuar marrëveshjet me Austrinë, Belgjikën, Çekinë, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ndërsa në shkurt 2011 MD ka nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare për ekstradim me Irlandën. Gjithashtu më 8 prill 2011 është nënshkruar marrëveshja me Maqedoninë për ekstradim, transferim të personave të dënuar dhe bashkëpunim gjyqësor në çështjet penale.

Sa i përket avancimit të Divizionit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, më 5 prill 2011 ky divizion është ngritur në Departament si dhe ka rekrutuar katër zyrtarë shtesë (duke rritur kështu numrin nga 14 në 18). Ndërsa me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të këtij Departamenti, në janar të 2011 janë mbajtur trajnime paralele me zyrtarët e këtij departamenti si dhe gjyqtarët, prokurorët dhe policinë, për ekstradim dhe bashkëpunim gjyqësor në çështjet penale dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Në anën tjetër, Komisioni për Ndërmjetësim ka miratuar këto akte nënligjore dhe dokumente politikash:

- Rregulloren e punës;
- Kodin e mirësjelljes së ndërmjetësve;
- Rregulloren për trajnimin dhe certifikimin e ndërmjetësve (28 tetor 2010);
- Rregulloren për përzgjedhjen e pjesëmarrësve në trajnim për ndërmjetësim (4 shkurt 2011);
- Planin e veprimit për trajnimin e ndërmjetësve (11 nëntor 2010);
- Planin e Programit të Punës (23 shkurt 2011);
- Doracakun për trajnimin e ndërmjetësve dhe vendimin mbi shpalljen e konkursit për përzgjedhjen e ndërmjetësve në Gjiilan, Prishtinë dhe Pejë (22 dhjetor 2010)

1.1.5. Politikat Kundër Korrupsion

Gjatë vitit 2010, gjykatat e Kosovës kanë pranuar 106 raste që përfshijnë vepra korruptive, numër ky që i është shtuar 284 rasteve të trashëguara nga vitet e mëhershme. Nga totali prej 390 rasteve në procedim e sipër në gjykata janë zgjidhur 114 raste gjatë vitit 2010.¹

Në anën tjetër, për sa i përket luftimit të korrupsionit brenda institucioneve të zbatimit të ligjit, në Inspektoratin Policor të Kosovës gjatë periudhës raportuese janë raportuar 53 raste që përfshijnë vepra korruptive. Në anën tjetër, nuk është raportuar për ndonjë rast të tillë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës. SHKK në anën tjetër ka themeluar Inspektoratin për mbikëqyrjen e punës së këtij institucioni.

Për më tepër, gjatë periudhës raportuese Dogana ka iniciuar 3 raste të korrupsionit brenda strukturës së saj, të cilat janë nën hetim. Paralelisht me këtë, Komisioni Disiplinor i Doganës ka shqyrtuar 4 raste që përfshijnë 8 zyrtarë doganorë dhe ka marrë këto vendime disiplinore:

- a) 2 vërejtje me shkrim;
- b) 7 ndalim promovime;
- c) 2 transferime në detyrë tjetër;
- d) 1 vërejtje e fundit me shkrim (para-përjashtim);
- e) 1 anulim të performancës së propozuar për shpërblime dhe
- f) 1 degradim.

Gjatë periudhës raportuese, AKK ka zhvilluar procesin e deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë, dhe nga deklarimi i pasurisë për vitin 2011, 1830 zyrtarë kanë qenë të obliguar ta deklarojnë pasurinë nga të cilët 1563 kanë deklaruar atë gjatë muajit mars 2011, ndërsa 267 zyrtarë të tjerë kanë pasur afat të deklarojnë pasurinë deri në mes të prillit 2011. Për shkak të mosrespektimit të afatit ligjor, AKK do të iniciojë procedurat e kundërvajtjes ndaj zyrtarëve të lartë.

Gjithashtu AKK më kuadër të aktiviteteve sensibilizuese më 22 - 25 shkurt 2011 ka organizuar punëtori me pjesëmarrjen e 150 pikave kontaktuese të institucioneve të linjës lidhur me obligimet të cilat burojnë nga Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë.

¹ KGJK nuk posedon me statistikatat më të fundit rreth rasteve të korrupsionit gjatë periudhës raportuese.

Për më tepër, sa i përket përmirësimit të koordinimit ndërinstitucional, është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të AKK-së dhe Zyrës së Prokurorit Disiplinor.

Ndërsa sa i përket sensibilizimit të institucioneve lidhur me rolin dhe aktivitetet e AKK-së, janë organizuar trajnime për zyrtarët e Administratës Tatimore të Kosovës mbi menaxhimin e aktiviteteve dhe legjislacionit adekuat anti-korrupsion.

1.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve

1.2.1 Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve

Për sa i përket funksionalizimit të mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, MFSK ka themeluar Njësinë e vet për të Drejtat e Njeriut dhe ka punësuar tre zyrtarë që merren edhe me barazinë gjinore.

Për më tepër, më 10 mars 2011 është miratuar Plani i Veprimit për Personat e Pagjetur. Janë përpiluar planet e zhvarrimeve për muajin prill dhe maj, ku përparësi kanë projektet rreth Liqenit të Livoqit dhe atij të Zhilivodës. Gjithashtu EULEX ka përkrahur trajnimin e 4 zyrtarëve të Departamentit të Mjekësisë Ligjore në MD rreth teknikave të mjekësisë ligjore gjatë zhvarrimeve, trajnim ky që zhvillohet edhe në terren, së bashku me ekipet përkatëse të EULEX-it.

Në mars 2011 është publikuar Raporti Vjetor për të Drejtat e Fëmijëve si dhe janë finalizuar raportet vjetore të monitorimit dhe vlerësimit të implementimit të Strategjisë për të Drejtat e Njeriut, Strategjisë për Personat me Aftësi të Kufizuara, dhe ai për Strategjinë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas.

Më tej, në aspektin e çështjeve gjinore, institucionet e Kosovës janë fokusuar në aktivitete sensibilizuese, dhe kështu në Gjilan, me rastin e 25 Nëntorit, është organizuar debat publik mbi "Dhunën në familje-identifikimi dhe njoftimi me institucionet relevante që e trajtojnë këtë dukuri" si dhe është publikuar fletushka 'Mos Hesht'. Për më tepër, në drejtim të implementimit të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, më 15 mars 2011 ABGJ dhe Instituti Gjyqësor i Kosovës kanë zhvilluar trajnimin "Mbrojtja nga Dhuna në Familje", ku kanë marrë pjesë 20 gjyqtarë, 3 zyrtarë nga MD, 1 bashkëpunëtor profesional, 1 zyrtar nga Policia e Kosovës, 1 juriste nga Gjykata Komunale e Pejës (gjithsej 26 pjesëmarrës).

Sa i përket fushës së të drejtave sociale, në mars 2011 është miratuar UA për Ofrimin e Shërbimeve në Komunitet (për personat me aftësi të kufizuara mendore , nr. 06/2011 dhe për të moshuarit, nr. 07/2011). Për sa i përket respektimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, janë trajnuar 169 zyrtarë në temën "Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në kontekst të të drejtave të njeriut". Trajnimi është mbajtur në pesë regionet e Republikës së Kosovës: Pejë, Mitrovicë, Prishtinë, Gjilan dhe Prizren.

Për sa i përket fuqizimit të mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel komunal, MAPL, në bashkëpunim me Komunitat e reja, ka bërë vlerësimin e nevojave për Zyrat komunale të të Drejtave të Njeriut dhe janë rekrutuar 36 zyrtarë shtesë, është rishikuar programi i trajnimeve dhe i njëjti është miratuar në shkurt 2011. Më tej, në prill 2011 janë mbajtur dy trajnime, ku kanë marrë pjesë 18 zyrtarë. MAPL gjithashtu ka

mbajtur trajnim me zyrtarë të Komunës së Klllokotit rreth funksionalizimit të Njesisë për të Drejtat e Njeriut në këtë Komunë.

1.2.2. Të drejtat e minoriteteve, të drejtat kulturore dhe mbrojtja e minoriteteve

Për sa i përket funksionalizimit të mekanizmave për mbrojtjen e minoriteteve, institucionet e Kosovës janë në fazën finale të përgatitjes së Termave të Referencës dhe Përshkrimeve të Punës për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim. ZÇK/ZKM gjatë periudhës raportuese ka organizuar tri trajnime regjionale për ngritjen e vetëdijes për të drejtat e komuniteteve. Pjesëmarrës në këto trajnime kanë qenë përfaqësues të lartë të komuniteteve, të shoqërisë civile dhe zyrtarë komunalë nga të gjitha komunitetet. Gjatë shkurtit 2011 ZÇK/ZKM, në bashkëpunim me MPB, ka mbajtur 5 punëtori rajonale me temën "Funksionalizimi i Zyrave Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe procesi i ri-integrimit të personave të riatdhesuar". Trajnimi u është dedikuar Drejtorëve të Drejtorive Komunale (me fokus në ato të Buxhetit dhe Financave) si dhe zyrtarëve komunalë për komunitete dhe kthim. Në këto 5 punëtori kanë marrë pjesë më shumë se 200 zyrtarë komunalë. Edhe pse trajnimi ka pasur në fokus ri-integrimin e personave të riatdhesuar, janë adresuar edhe çështjet e funksionalizimit të këtyre zyrave në aspektin e mbrojtjes së minoriteteve.

Në kuadër të ruajtjes së trashëgimisë kulturore gjatë vitit 2010 është shënuar progres në restaurimin dhe konservimin e tërësive të trashëgimisë kulturore:

- a) Restaurimi dhe konservimi i Kullës në Llukavc të Bebut, Istog (faza e dytë);
- b) Restaurimi dhe konservimi i Kullës së Sylrexhve në Vranovc, Pejë (faza e dytë);
- c) Restaurimi dhe konservimi i Konakut të Jashar Pashës në Pejë,
- d) Konservimi dhe restaurimi i Mejtepit Ruzhdije (shkollës së parë shqipe), në Gjakovë,
- e) Renovimi i Parkut Arkeologjik i Muzeut të Kosovës;
- f) Konservimi dhe restaurimi i Sahat Kullës në Gjilan;
- g) Konservimi dhe restaurimi i Urës së Zallqit mbi Lumin e Istogut;
- h) Rindërtimi i Objektivit të Taphanes në Gjakovë;
- i) Restaurimi dhe konservimi i Urës së Vjetër në fshatin Bubël,
- j) Rregullimi i oborrit në Kishën Sinodale të Shën Gjergjit në Prizren,
- k) Riparimi i kambanores dhe pastrimi i bunarit në Manastirin e Deviçit në Skënderaj,
- l) Riparimi i kishës, rindërtimi i ndërtesës për pritjen e mysafirëve dhe murit rrethues në kishën e Shën Gjon Pagëzuesit në Pejë.

Sa i përket ngritjes së vetëdijes së publikut për trashëgimi kulturore, gjatë periudhës raportuese janë realizuar këto aktivitete:

- a) Ditët e Trashëgimisë Evropiane 2010 (14 - 30 shtator 2010); dhe
- b) Forumi për Trashëgimi Kulturore në Prishtinë (30 shtator 2010).

Gjithashtu MKRS, në bashkëpunim me MMPH-në, gjatë periudhës së parë të vitit 2011 ka organizuar debatin me temën "Hartimi dhe Zbatimi i Mekanizmave Ligjorë për Zonën Historike të qytetit të Prizrenit", i mbajtur në Prizren.

Për sa i përket qasjes së komuniteteve jo-shumicë në sistemin e arsimit, gjatë periudhës raportuese janë përgatitur dhe botuar disa tekste në gjuhën e komuniteteve jo-shumicë për shkollim fillor. Gjatë kësaj periudhe gjithashtu është bërë identifikimi i nevojave për

staf mësimdhënës për arsimim në gjuhën boshnjake dhe turke. Për më tepër, është mbajtur sesion trajnues me mësimdhënës të shkollave me nxënës nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas në lidhje me zbatimin e plan-programit në gjuhën rome.

Gjatë periudhës raportuese, Komisioni për Përdorimin e Gjuhëve, në vazhden e monitorimit të implementimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, ka zhvilluar një numër vizitash pune në nivelin qendror dhe atë lokal. Komisioni ka organizuar tryeza të rrumbullakëta rreth përdorimit të gjuhëve zyrtare në pesë rajonet e Kosovës, ku kanë marrë pjesë rreth 200 pjesëmarrës nga komunat dhe nga shoqëria civile. Gjithashtu më 30 nëntor – 17 dhjetor 2010 është organizuar trajnimi “Teknikat dhe shkathtësitë e përkthimit”, ku pjesëmarrës ishin 31 përkthyes (të nivelit qendror), të ndarë në dy grupe (16 përkthyes për gjuhën serbe dhe 15 përkthyes për gjuhën angleze). Gjatë tetorit 2010 ZÇK/ZKM ka zhvilluar trajnime në gjithë Kosovën për promovimin e drejtave të komuniteteve në përdorimin e gjuhëve. Pjesëmarrës në këto trajnime kanë qenë pjesëtarë të komuniteteve të cilat jetojnë në Kosovë dhe zyrtarë që punojnë në institucionet e nivelit komunal.

Gjatë periudhës raportuese është përfunduar drafti i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Rregullimin e Vendbanimeve Jo-formale, e cila pritet të miratohet së shpejti.

Në lidhje me ofrimin e qasjes së komuniteteve në sistemin shëndetësor, MSH ka ofruar shërbimet shëndetësore për menaxhimin dhe trajtimin e helmimit me plumb te pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas, ku aktualisht ky aktivitet zhvillohet me grupmoshat dhe kategoritë më të ndjeshme ndaj ekspozimit (fëmijët e moshës 0-6 dhe gratë shtatzëna), si dhe janë siguruar barërat për trajtim e këtyre pacientëve.

Më tej, Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Planeve Zhvillimore Komunale në MMPH ka dhënë pëlqimin për 13 Plane Zhvillimore Komunale. Këto plane janë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Planifikim Hapësinor. Kurse sa i përket shërbimeve kadastrale, janë themeluar Zyrrat Kadastrale Komunale në komunat e reja (Graçanicë, Ranillug, Klllokot dhe Partesh), si dhe të gjitha shërbimet e ZKK-ve, përfshirë ZKK-të në komunat e reja, janë të kyçura në sistemin e shërbimeve për të dhënat kadastrale.

MKK gjithashtu ka organizuar takime në 20 qendra komunale në kuadër të grupeve punuese të Zyrrave Komunale për Komunitete dhe Kthim, ku janë njoftuar për kthim potencial të komuniteteve, mbi bazat juridike dhe kushtet për kthim dhe ri-integrim në shoqërinë kosovare.

Në kuadër të vizitave `Shko-Shiko` dhe `Shko-Informohu`, gjatë marsit 2011 janë organizuar tri syresh:

- a) Një vizitë në Serbi, për të zhvendosurit nga Klina;
- b) Një vizitë në Podgoricë, për të zhvendosurit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas nga Vushtrria; dhe
- c) Një vizitë për 13 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas në Mitrovicë.

Me qëllim të përkrahjes, zhvillimit dhe ri-integrimit të komuniteteve pakicë, të qëndrueshmërisë dhe zhvillimit ekonomik të tyre, janë realizuar këto projekte:

- a) Është përfunduar projekti i implementimit direkt të MKK-së dhe Komunës së Istogut, ku janë ndërtuar 53 objekte banimi për familjet e zhvendosura në fshatrat

- e Komunës së Istogut (në fshatin Zallq 24 objekte, në fshatin Dragolevc 14 objekte, në fshatrat Tugjevc dhe Gjurakocv 10 objekte dhe në fshatrat Dobrushë dhe Muzhevinë 5 objekte).
- b) Është përfunduar projekti i përbashkët i UNHCR-it dhe MKK-së sipas MoU III ku janë ndërtuar 78 objekte banimi në të gjitha regjionet e Kosovës dhe janë vendosur familjet e kthyer.
 - c) Është përfunduar projekti RRK I më 21.10.2010. Ku janë ndërtuar 181 objekte banimi për familjet e kthyer në dy faza për 4 Komuna: F. Kosovë – 25 objekte; Istog – 70 objekte; Pejë – 55 objekte dhe Gjilan – 31 objekte.
 - d) Ka filluar projekti 'Kthimi urban në qytetin e Prizrenit' i cili është financuar nga ana e Ambasadës Britanike dhe MKK-së, ku është paraparë ndërtimi i 10 objekteve banimi në qytet. Në fazën e parë, ndërtimi i 5 objekteve banimi është në fazën përfundimtare. Ndërsa në fazën e dytë kanë filluar punët e 5 objekteve banimi.
 - e) Implementimi i projektit RRK II i cili zbatohet në 4 Komuna, ku parashihet ndërtimi i 210 objekteve të banimit për të kthyerit: Klinë – 80 shtëpi, Ferizaj – 80 shtëpi, Rahovec – 30 shtëpi dhe Obiliq – 20 shtëpi. Gjetë kësaj periudhe në kuadër të këtij projekti janë ndërtuar 126 objekte banimi: Klinë 63 shtëpi, Ferizaj 28 shtëpi, Rahovec 15 shtëpi, Obiliq 20 shtëpi.
 - f) Ka përfunduar ndërtimi i dy ndërtesave banesore me 40 banesa në Llapnasellë, si dhe dy objekte banesore-afariste me 40 banesa në Graçanicë për familjet e zhvendosura.
 - g) Gjatë muajve tetor – nëntor, ZÇK/ZKM ka realizuar projektet në vijim:
 - Ndërtimi i shtëpisë në Podujevë/Besianë – ky projekt u realizua pas kërkesës së parashtruar nga kjo familje dhe pas analizimit të gjendjes së rëndë në të cilën jetonin shtatë anëtarë të familjes nga komuniteti egjiptas.
 - Ndërtimi i shtëpisë në Ferizaj - Zyra për Çështje të Komuniteteve ka realizuar projektin për familjen shtatë-anëtarësh të komunitetit egjiptas të cilët jetonin në kushte të rënda.
 - h) Është bërë pranim-dorëzim i projektit për rikonstruktimin e ndriçimit të rrugës që lidh nëntë fshatra me qendrën e komunës së Graçanicës. Ky projekt u financua nga ZÇK.
 - i) Në fshatin Kishnicë të Komunës së Graçanicës është bërë pranim-dorëzimi i projektit "Terreni i sportit" financuar nga ZÇK/ZKM.

Për më tepër, janë hartuar kriteret e vlerësimit të projekteve si dhe formulari përkatës i aplikacionit, i raportimit narrativ dhe financiar si dhe është nxjerrë rregullorja e brendshme e MKK-së për financimin e projekteve të OJQ-ve.

1.3 Çështjet Rajonale dhe Obligimet Ndërkombëtare

Me qëllim të *përmirësimit të kornizës ligjore dhe të politikave* që mbulon *bashkëpunimin rajonal politik*, gjatë periudhës raportuese ka filluar puna për hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për politikën e jashtme (përfshirë bashkëpunimin rajonal) me formimin e Grupit Punues për hartimin e saj, të kryesuar nga MPJ.

Për sa i përket kryesimit të CEFTA-së, Kosova ka marrë pjesë në takimin e Komitetit Drejtues të CEFTA-së gjatë muajit shkurt në Bruksel, ku edhe ka kryesuar me takimin. Gjithashtu, është marrë pjesë në aktivitete të tjera të planifikuara: të Nën-komiteteve për Bujqësi, Tregun e Shërbimeve, Dogana dhe pastaj takimi i GP për Tregun e Shërbimeve,

Java e CEFTA-së dhe takimi i Komitetit të Përbashkët (takimi i Ministrave).

Për sa i përket implementimit të dispozitave që dalin nga *Marrëveshja me Shqipërinë për standardizim dhe akreditim*, Drejtoria e Akreditimit të Kosovës ka mbajtur trajnim për dy nga zyrtarët përkatës në këtë fushë.

Sa i përket implementimit të Marrëveshjes mbi Hapësirën e Përbashkët Evropiane e Aviacionit (*Marrëveshjes ECAA*), gjatë periudhës raportuese janë transponuar këto akte nënligjore që janë kërkesë e fazës së dytë të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje:

1. Rregullorja 6/2010 (transponim i rregullores EC nr. 1032/2006) mbi kërkesat për sistemet automatike për shkëmbimin e shënimeve të fluturimeve me qëllim të notifikimit, koordinimit dhe transferimit të fluturimit midis njësive të kontrollit të trafikut ajror
2. Rregullorja 7/2010 (transponim i rregullores EC nr. 1265/2007) mbi kërkesat e kanaleve ajër-tokë në qiellin e vetëm evropian
3. Rregullorja 8/2010 (transponim i rregullores EC nr. 1321/2007) për përcaktimin e rregullave implementuese për integrimin e të dhënave të shkëmbyera në përputhje me Direktivën 2003/42/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, për ndodhitë në aviacionin civil në bazën qendrore të të dhënave
4. Rregullorja 9/2010 (transponim i rregullores EC nr. 1330/2007) për përcaktimin e rregullave implementuese për shpërndarjen palëve të interesuara të informatave për ndodhitë në aviacionin civil, të listuara në Nenin 7(2) të Direktivës 2003/42/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian;
5. Rregullorja 10/2010 (transponim i rregullores EC nr. 104/2004 për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe përbërjen e bordit të apelit të Agjencisë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit;
6. Rregullorja 11/2010 (transponim i rregullores EC nr. 736/2006) mbi metodat e punës së Agjencisë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit për kryerjen e inspektimeve të standardizimit.
7. Rregullorja 14/2010 (transponim i rregullores EC nr. 1794/2006) mbi vendosjen e skemës së përbashkët të tarifave për Shërbime të Navigacionit Ajror
8. Rregullorja 15/2010 (transponim i rregullores EC nr. 1033/2006) mbi vendosjen e kërkesave për procedurat e planeve të fluturimit në fazën e para-fluturimit në Qiellin e Vetëm Evropian
9. Rregullorja 16/2010 (transponim i rregullores EC nr. 633/2007) mbi vendosjen e kërkesave për aplikimin e protokollit për transmetimin e porosive të fluturimit që përdoren për notifikim, koordinim dhe transferim të fluturimeve mes njësive të kontrollit të trafikut ajror
10. Rregullorja 17/2010 (transponim i rregullores EC nr. 219/2007) mbi krijimin e një ndërmarrje të përbashkët për zhvillimin e gjeneratës së re të sistemeve evropiane për Menaxhim të Trafikut Ajror (SESAR)
11. Rregullorja 18/2010 (transponim i rregullores EC nr. 2150/2005) mbi rregullat e përbashkëta për përdorimin fleksibil të hapësirës ajrore

Gjatë periudhës tetor 2010 – mars 2011, raportuese institucionet kosovare kanë marrë pjesë në tetë (8) kurse trajnimi të organizuara nga *ReSPA* (të mbajtura në Danilovgrad) mbi këto tema:

1. *Planifikimi dhe implementimi i fushatave të komunikimit dhe lobimit II;*
2. *Drejt menaxhimit total të cilësisë me anë të kornizës së përbashkët të vlerësimit;*
3. *Cikli i politikave: nga hartimi deri te vlerësimi i politikave II;*
4. *Menaxhimi i administratës publike (moduli II);*

5. *Roli i qeverisë në krijimin e besimit dhe sigurisë: mbrojtja e të dhënave personale në Evropë;*
6. *Hartimi i Legjislacionit;*
7. *Konceptet e menaxhimit dhe aftësitë për shërbyesit e lartë civilë I;*
8. *Teoria dhe Praktika e ciklit të politikave*

Sipas të dhënave preliminare, *qarkullimi tregtar* i Kosovës me vendet e rajonit (anëtare në CEFTA-së) gjatë vitit 2010 ka arritur vlerën mbi €860 milionë. Nga kjo, vlera e importit është €799 milionë, ose 37.3% nga vlera e përgjithshme e importit, një rritje prej 1.6% në raport me vitin 2009. Në anën tjetër, vlera e eksporteve drejt vendeve të tjera anëtare ka arritur në €70 milionë, ose 24.1% të vlerës së përgjithshme të eksporteve, vlerë kjo 8% më e ulët në raport me vitin 2009.

Në fushën e *bashkëpunimit ndërkufitar*, gjatë periudhës raportuese, përkatësisht më 8 - 9 mars është realizuar trajnimi për stafin e Strukturës Operacionale mbi *Skemën e granteve në kuadër të komponentit të IPA-së për BNK*, ku kanë marrë pjesë 12 zyrtarë të MAPL-së.

2. KRITERET EKONOMIKE

2.1. Funksionimi i Ekonomise së Tregut

Gjatë muajit Tetor 2010, Ministria e Financave përfundoi përgatitjet për hartimin e buxhetit të vitit 2011, i cili buxhet paraprakisht u harmonizua me FMN-në. Po ashtu gjatë këtij muaji, Ministria e Financave dërgoi shkresën zyrtare drejtuar Komisionit Evropian për lirim të fondeve të kështit të dytë të mbështetjes direkte buxhetore, së bashku me Raportin e Përbushjes së Kriteve specifike në harmoni me memorandumun e nënshkruar me KE-në.

Për shkak të zhvillimeve politike, që ndodhën gjatë muajit Tetor-Nëntor të përcjellura me shpërbërjen e Kuvendit të Kosovës, Ligji i Buxhetit për vitin 2011 nuk arriti që të aprovohet brenda afatit ligjor (31 Tetor 2010).

Gjatë vitit 2010, u përmbushën edhe kushtet teknike nga ana e Qeverisë së Kosovës (që ndërlidhen me realizimin e ndarjeve buxhetore për financimin e strategjisë për punësim të qëndrueshëm), për pranimin e ndihmës direkte buxhetore të Bankës Botërore në vlerë prej 20 milion euro në formë të grantit si dhe 5 milion euro në formë të kredisë.

Pas konstituimit të institucioneve të reja të Kosovës, gjatë muajit Shkurt 2011 në Kosovë, Ministria e Financave, rishikoj draftin e buxhetit për vitin 2011 në përputhje me prioritetet e reja të deklaruara nga Qeveria e re e Kosovës.

Me qëllim të diskutimit të ndryshimeve në draft buxhetin e vitit 2011, gjatë muajit Shkurt 2011, Qeveria e Kosovës ka pritur misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar si dhe ka zhvilluar takimin e radhës së Mekanizmit të Mbikëqyrjes Fiskale me Komisionin Evropian. Gjatë këtyre takimeve u raportua mbi ndryshimet në strukturën e buxhetit nga drafti i diskutuar në Tetor 2010, si dhe mbi mundësitë e reja të gjenerimit të të hyrave për të reflektuar rritjen e shpenzimeve.

Gjatë këtij misioni Qeveria e Kosovës, arriti që në pjesën më të madhe të linjave buxhetore të harmonizojë qëndrimet me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Qeveria e Kosovës ka përgatitur Buxhetin e Kosovës 2011 Ligji Nr. 04/L-001 i cili është aprovuar në Kuvendin e Kosovës më 31 Mars 2011, dekretuar më 1 prill 2011, Nr. DL-001-2011.

2.1.1. Raportimi në lidhje me zhvillimet e fundit ekonomike

Treguesit makroekonomik të përfshirë në librin e Buxhetit 2011, sugjerojnë se ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2010 ka shënuar ecuri pozitive. Më saktësisht, gjatë vitit 2010, ekonomia e Kosovës është vlerësuar të ketë shënuar një rritje vjetore prej 4.0% krahasuar me vitin 2009, e cila vjen si rrjedhojë e rritjes së kërkesës së jashtme e po ashtu edhe asaj të brendshme.

Duke u bazuar në të dhënat e importit dhe të kreditimit nga ana e sektorit financiar, investimet private janë vlerësuar të kenë rënë me 0.9%. Përkundër kësaj, kontributi i sektorit publik në kërkesën agregate ka vazhduar të jetë pozitiv. Më saktësisht, ndikimi i shpenzimeve kapitale në investimet totale ka qenë shumë më i rëndësishëm se vitin e kaluar duke shënuar një rritje prej 13.7%, e që kanë ndikuar që investimet totale të rriten me 4.1% krahasuar me vitin 2009.

Për sa i përket sektorit të jashtëm, gjatë vitit 2010 u shënuar një përmirësim i bilancit tregtar, ku në krahasim me vitin 2010 eksportet u rriten me 66.2% ndërsa importet me 4.4%. Kjo lëvizje ka ndikuar në zvogëlimin e deficitit tregtar prej 42.8% në 40.7% të BPV-së.

Luhatja e çmimeve botërore të ushqimit dhe naftës është reflektuar pothuajse drejtpërdrejt edhe në Indeksin e Çmimeve të Konsumit në Kosovë. Për më shumë, IÇK gjatë vitit 2010 ka shënuar një rritje mesatare vjetore prej 3.5% e ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve të bukës dhe naftës, sidomos gjatë gjysmë-vjetorit të dytë të po këtij viti (Shih tabelen 2.1 në vijim).

Tabela 1 - BPV nominale dhe reale sipas shpenzimeve

<i>Pershkrimi</i>	2007 aktuale	2008 aktuale	2009 aktuale	2010 e vleresuar
<i>Nominale</i>				
Konsumi	3,811	4,345	4,280	4,756
Investimet	893	1,094	1,166	1,214
Eksportet neto	-1,309	-1,587	-1,534	-1,711
BPV	3,394	3,851	3,912	4,259
<i>Reale</i>				
Konsumi	3,719	4,088	4,359	4,571
Investimet	831	1,029	1,211	1,192
Eksportet neto	-1,234	-1,488	-1,607	-1,694
BPV	3,316	3,628	3,963	4,069
Rritja reale	6.3%	6.9%	2.9%	4.0%

Metodologjia e përdorur për kalkulimin e rritjes reale është ndryshuar në pajtim me metodologjinë e përdorur nga Enti Statistikor i Kosovës (ESK). Rritjet për vitet 2007-2009 janë kalkuluar nga ESK, duke paraqitur rritjen reale në krahasim me vitin paraprak. Me të njëjtën metodologji është bërë edhe vlerësimi i rritjes reale për vitin 2010 nga Ministria e Financave.

Zhvillimet në Bilancin e Pagesave

Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm gjatë vitit 2010 u karakterizuan kryesisht me rënie të transaksioneve rrjedhëse neto, përkeqësim të mëtutjeshëm të llogarisë rrjedhëse si dhe zvogëlim modest të deficitit tregtar, zvogëlim të të hyrave në llogarinë kapitale si dhe të investimeve direkte. Këto zhvillime si dhe zhvillimet në sektorët tjerë të

ekonomisë sugjerojnë që kriza ekonomike ndërkombëtare e vitit 2009 mund të ketë pasur efekt të vonuar në ekonominë e Kosovës.

Parashikimet për llogarinë rrjedhëse sugjerojnë për thellim të mëtutjeshëm të deficitit të kësaj kategorie gjatë vitit 2011 e cila në një masë të madhe vjen si rrjedhojë e rritjes së konsumit e cila pritet të rritë edhe me shumë importin e mallrave. Për vitet që vijojnë, parashikimet flasin për një përmirësim të moderuar të llogarisë rrjedhëse kur pritet të bie në 17.9% të BPV-së nga 18.1% sa është parashikuar në vitin 2011 (shih tablen 2.2 në vijim).

Tabela 2 - Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm, si % në GDP

	2008	2009	2010	2011
në përqindje të BPV-së				
Bilanci Tregtar	-43.3%	-42.8%	-40.5%	-41.2%
Eksportet, f.o.b.	5.2%	4.2%	7.1%	7.3%
Importet, f.o.b.	-48.5%	-47.0%	-47.6%	-48.4%
Shërbimet, neto	2.1%	3.4%	0.9%	0.9%
Transferet, neto	20.8%	19.8%	20.7%	19.5%
Bilanci I Llogarisë Rrjedhëse	-16.2%	-17.5%	-17.8%	-21.6%
Llogaria Financiare dhe Kapitale	12.0%	13.7%	10.5%	12.3%
Llogaria Kapitale	0.3%	2.8%	0.6%	2.6%
Financimi Afatgjatë	12.3%	8.5%	11.0%	9.2%
Investimet Direkte	8.9%	7.0%	7.3%	7.4%
Portfolio Investimet	0.4%	0.0%	-0.2%	-0.2%
Investimet tjera	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
Asetet Rezerve	-0.6%	2.4%	-1.1%	0.6%

Burimi: Departamenti Makroekonomik -MF

Të dhënat për tregtinë me jashtë për vitin 2010 tregojnë se eksportet kanë vazhduar të rriten për 78% në krahasim me vitin 2009 ndërsa importet janë rritur për 11%. Ky relacion i zhvillimit në komponentët kryesorë të bilancit tregtar ka bërë që ky bilanc për këtë vit të thellohet për 5% për dallim nga viti 2009.

Vetëm gjatë kuartalit të fundit të vitit 2010, eksportet arritën vlerën €79.6 milionë duke shënuar një rritje prej 47% në krahasim me të njëjtën periudhë kohore të vitit 2009. Ndërsa vetëm në Janar të vitit 2011, sipas të dhënave të disponueshme, eksportet arritën vlerën në €22.9 milionë nga €15.8 milionë euro sa ishte në Janar të vitit 2010.

Megjithatë, niveli i lartë i importeve mbetet komponenti kryesor për bilancin negativ të llogarisë rrjedhëse pasi që rritja e BPV-së parashihet të varet nga sektori i jashtëm, dhe kjo tregon se paralel me ringjalljen e kërkesës globale dhe me ngritjen e çmimeve të mallrave eksportet parashihen të rriten gjatë vitit 2011.

Importet gjatë kuartalit të fundit të vitit 2010 arritën në €591.8 milionë nga €552.3 milionë sa ishin në kuartalin e katërt të vitit 2009 duke shënuar një rritje prej 7%. Parashikimet për vitin 2011 flasin për një rritje të importeve në 10.4% që reflekton edhe ngritjen e investimeve të përgjithshme.

Investimet e huaja direkte të cilat përbëjnë rreth 7% të GDP-së gjatë vitit 2010 kanë arritur në €300 milionë euro ku është shënuar një ngritje prej 9% për dallim nga viti 2009. Ndërsa remitancat të cilat përbëjnë rreth 13% të GDP-së, sipas të dhënave preliminare, kanë shënuar një rënie të vogël prej rreth 0.2% në vitin 2010, me një diferencë në vlera nominale prej -€1 milionë për dallim nga viti 2009. Megjithatë, me rikooperimin e ekonomisë në euro-zonë, performanca e remitancave pritet të rritet gjatë vitit 2011 dhe që mund të ketë ndikim pozitiv në përmirësimin e llogarisë rrjedhëse (shih tabelen 2.3 në vijim).

Tabela 3 - Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm 2008-2011, në milion euro

	2008	2009	2010	2011
(në miliona euro)				
Bilanci Tregtar	-1,668	-1,673	-1,735	-1,908
Eksportet, f.o.b.	198	165	305	336
Importet, f.o.b.	-1,867	-1,839	-2,041	-2,245
Shërbimet, neto	81	133	37	43
Transferet, neto	800	776	889	905
Bilanci I Llogarisë Rrjedhëse	-623	-674	-684	-833
Llogaria Financiare dhe Kapitale	463	536	450	570
Llogaria Kapitale	10	108	27	119
Financimi Afatgjatë	475	333	470	426
Investimet Direkte	341	274	311	343
Portfolio Investimet	17	-57	-231	-45
Investimet tjera	117	116	390	127
Asetet Rezerve	-23	94	-47	26

Burimi: Departamenti Makroekonomik –MF

Trendet në punësim

Bazuar në të dhënat e regjistruara mbi numrin e të papunëve nga Ministria e Punës dhe mirëqenies sociale, numri kumulativ i të regjistruarve si të papunë në fund të Dhjetorit 2010 ishte 335,620. Papunësia ende mbetet një problem serioz që e shoqëron ekonominë e Kosovës. Trendi i të papunëve të regjistruar, i cili gjatë vitit 2009 qëndroj pothuajse stabil, duke filluar nga tremujori i parë i vitit 2010 filloj të tregoj tendenca rënëse. Ajo që vlen të potencohet është se në fund të vitit 2010, u shënuar një rënie e theksuar prej 3,275 personave në numrin e të papunëve të regjistruar (prej 338,895 sa ishin në fund të Dhjetorit 2009 në 335,620 në fund të Dhjetorit të vitit 2010). Nga ana tjetër numri i të punësuarve përmes zyrave të punësimit gjatë vitit 2010 ishte 6,787.


Ndërsa të dhënat në fund të shkurtit 2011 dëshmojnë që në fund të shkurtit 2011, numri i përgjithshëm i të regjistruarve si të papunë arriti në 336,363 persona, ose për rreth 1%me i ulët se sa në periudhën e njëjtë gjatë vitit 2010. Ndërsa që numri i të punësuarve përmes zyreve të punësimit gjatë këtyre dy muajve të vitit 2011 ishte 781persona.

Indekset e trendit të inflacionit (inflacioni bazë)

Viti 2010 u karakterizua me rritje të nivelit të përgjithshëm të çmimeve prej 3.5% krahasuar me -2.4% sa ishin në vitin 2009. Të dhënat e mbledhura nga ESK dëshmojnë që kjo ngritje ka filluar nga gjysma e dytë e vitit 2009 dhe ka vazhduar edhe përgjatë vitit 2010. Kontribuesit kryesor në këtë ngritje kanë qenë ngritja e çmimeve të ushqimit

dhe naftës të cilat gjatë kësaj periudhe janë rritur me 4.8% respektivisht 16% krahasuar me vitin 2009 kur ato shënuan një rënie vjetore prej 4.9% respektivisht 18.7%. Duke pasur parasysh që një pjesë e madhe e produkteve ushqimore importohet dhe duke ditur që ushqimi përbën një pjesë të rëndësishme në shportën e konsumatorit, mund të konkludohet që rritja e çmimeve botërore të ushqimit është reflektuar edhe në nivelin e çmimeve të ushqimit në Kosovë (shih tabelen figurën 1 në vijim).

1 Figura 2.1 - Ndryshimi vjetor në IÇK dhe në IÇK bazë (Core Inflation)



Siç shihet në figurën më lartë, niveli i inflacionit baze (IÇK përjashtuar ushqimin dhe naftën) ka shënuar një rritje mesatare prej 1.4% gjatë vitit 2010 krahasuar me vitin 2009 kur ajo ishte 2.4%. Kjo vërteton faktin që ndryshimi i nivelit të përgjithshëm të inflacionit në Kosovë vjen si rrjedhojë e ndryshimit të çmimeve të ushqimit dhe naftës.

2.1.2. Raporti për politikat monetare dhe fiskale gjatë periudhës raportuese

Evoluimi i kornizës së politikave monetare: Si përdorues unilateral i euros, Kosova nuk ka politikë monetare vendore pasi ajo është ekzogjene. Në sektorin monetar, Banka Qendrore e Kosovës ushtron detyrën e mbikëqyrësit të institucioneve financiare dhe siguron mjaftueshmërinë e kapitalit si dhe imponon rregulla për qëllim të ruajtjes së likuiditetit të këtij sektori.

Korniza e normës së këmbimeve: Kosova përdorë euron prandaj norma nominale e këmbimit përcaktohet nga lëvizjet e euros kundrejt valutave tjera në tregjet ndërkombëtare. Sa i përket normës reale efektive të këmbimit, këto kalkuloohen duke marrë për bazë çmimet e konsumit të vendeve të cilat kane pjesëmarrje të madhe në tregtinë me Kosovën (shih tablen 2.4 në vijim).

Tabela 4 - Normat efektive të këmbimit, nominale dhe reale

Pershkrimi		2010												2011
		Jan	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korrik	Gusht	Shtat	Tetor	Nent	Dhjet	Janar
Indeksi	NEER	101.4	101.3	101.2	100.9	100.6	100.4	100.4	100.6	100.6	101.0	101.1	100.8	100.7
	REER (Total)	102.4	102.3	101.7	100.0	100.0	99.9	100.4	103.1	103.2	104.3	104.5	104.8	106.0
	REER (CEFTA)	101.9	102.4	101.9	100.6	101.2	101.2	101.9	104.2	104.2	105.2	105.4	105.8	106.0
	REER (EU)	103.4	103.4	102.5	101.0	101.1	101.3	101.8	104.6	104.7	105.7	105.9	106.4	108.2

Normat efektive të këmbimit, nominale dhe reale

Evoluimi i politikave fiskale: Të përcaktuara me buxhetin e vitit 2010, caqet fiskale janë realizuar me nivel të lartë si nga komponentët e të hyrave buxhetore ashtu edhe nga komponentët e shpenzimeve buxhetore. Të hyrat buxhetore, duke përjashtuar dividenden nga PTK kanë shënuar rrije prej 10% krahasuar me vitin 2010 (**shih Aneksin II, tabelën 21**). Kjo rritje i atribuohet më së shumti rritjes së të hyrave nga dogana të cilat shënuan një rritje prej 10.3%.

Për sa i përket shpenzimeve buxhetore, realizimi i tyre ka qenë 96% e vlerës që është buxhetuar për vitin 2010. Nga këto, vlen të ceket që shpenzimet kapitale janë realizuar me 91% dhe duke qenë se vlera e planifikuar e tyre ishte shumë më e madhe krahasuar me vitet paraprake. Kjo tregon për një përmirësim të theksuar të efikasitetit të planifikimit dhe ekzekutimit të shpenzimeve. Transferet sociale përfshijnë beneficionet e asistencës sociale, beneficionet për invalid të luftës dhe familjet e dëshmoreve të luftës dhe pensionet si për ata kontribut-dhënës ashtu edhe për ata që nuk kanë kontribuar në skemën e mëparshme pensionale. Rritja e shumës në këtë kategori i atribuohet rritjes së popullsisë ndërsa subvencionet për ndërmarrjet publike përfshijnë kryesisht subvencionet që i jepen KEK-ut për import të energjisë elektrike (**shih Aneksin II, tabelën 22**).

Bilanci primar në vitin 2010 ka arritur vlerën prej -€76 milionë. Pas pagesës së interesit në borgjin e jashtëm dhe dhënies së huas për KEK-un, bilanci i përgjithshëm ka arritur vlerën prej -€145 milionë. Ky deficit është financiar kryesisht nga suficiti i grumbulluar nga vitet e mëparshme në bilancin bankar në Bankën Qendrore të Kosovës si dhe nga një pjesë donacioneve të BE-së dhe pjesës së parë të huas së marr nga FMN.

Buxheti për vitin 2011 parasheh shpenzimet totale në vlerë prej €1.434 milionë, vlerë e cila përfshinë të gjitha iniciativat e reja të Qeverisë për ngritje të pagave për kategori të caktuara të shërbyesve civil si dhe për ngritje të përfitimeve të invalidëve të luftës dhe familjeve të dëshmoreve të luftës. Të hyrat për këtë vit janë parapare të arrijnë vlerën prej €1.264 milionë e që janë rezultat i rritjes së ekonomisë në rend të parë dhe ngritjes së efikasitetit të institucioneve përgjegjëse për mbledhjen e të hyrave buxhetore (**Aneksin II, tabelën 21 dhe 22**).

Duhet theksuar se përpos shpenzimeve të rregullta primare, pjesë e buxhetit të përgjithshëm nën menaxhimin e Qeverisë së Kosovës, për vitin 2011, është edhe rezerva fiskale në vlerë të planifikuar prej 477 milion euro. Po ashtu, ngjashëm me vitet tjera, pjesë e shpenzimeve të përgjithshme të Qeverisë janë edhe pagesa e interesit për huamarrje në vlerë prej 11.3 milion euro si dhe kredia e planifikuar për ndërmarrje publike në vlerë prej 45 milion euro, duke e ngritur vlerën e përgjithshme të shpenzimeve të Qeverisë për vitin 2011 në 1,553 milion euro.

Borxhi publik i Republikës së Kosovës (shih aneksin II, tabelën 21) përfshinë mjetet (huadhëniet) e ofruara nga agjencitë ndërkombatare për modernizimin e infrastrukturës së rëndë në Kosovë. Vlenë të theksohet se Kosova ende vazhdon të mos ketë politika mbi huamarrje publike nëpërmjet letrave me vlerë, dhe një gjë e tillë sipas parashikimeve mund të ndodhë gjatë vitit 2012. Megjithatë, përgjatë vitit 2010 dhe vitit 2011 Kosova vazhdon të ketë përqindje të vogël të borxhit publik në relacion me kriteret e lejuara sipas normave ndërkombëtare ku një shtet duhet të ketë borxhin publik më të vogël se 40% e GDP-së.

Shuma totale e paguar për të shërbyer borxhin për vitin 2010 ka qenë rreth €10,333 milion nga të cilat €10 milion janë kredi nga banka Botërore dhe €249.7 milion nga marrëveshja për mbështetje buxhetore e garantuar nga Fondi Monetarë Ndërkombëtar (shih tabelën 2.5 në vijim).

Tabela 5 - Bruto borxhi shtetërorë si % e GDP-së

Shteti	2009	2010	2011 (proj)
Kosova	6.40%	6.10%	7.10%

2.1.3. Funkcionimi i tregjeve të produkteve

Liberalizimi i çmimeve; Sa i përket liberalizimit të çmimeve dihet se Kosova ka një ekonomi tregut të bazuar në konkurrencën e lire, dhe për shumicën e produkteve dhe shërbimeve, çmimet vendosen në bazë të raportit të ofertës me kërkesën.

Në lidhje me kontrollin administrativ ekziston një kategori e caktuar e shërbimeve publike për të cilat çmimet përcaktohen në bazë të analizave nga institucionet administrative:

- Çmimet e energjisë elektrike caktohen nga Rregullatori i energjisë
- Çmimet e ujit dhe mbeturinave rregullohen nga ZRRUM bazuar në Ligjin Nr. 03/L-086
- Çmimet për shërbimet në arsimin universitar shtetëror janë të caktuara në mënyrë fikse
- Çmimet në sektorin e shëndetësisë publike janë unike

Gjatë kësaj periudhe raportuese, operatori i furnizimit me energji (KEK) ka kërkuar nga ZRRE ngritjen e tarifave të energjisë elektrike, por Bordi i ZRRE në takimin e mbajtur më 14 prill 2011, ka vendosur që tarifën e energjisë elektrike për konsumatorët, të cilat do të zbatohen nga data 1 prill 2011, të mbesin të njëjta me ato të vitit të kaluar.

Çmimet në sektorët tjerë si: bankar, telekomunikacion, shërbime konsulente, arsim privat etj, caktohen në bazë të parimeve të konkurrencës në treg.

Madhësia e sektorit privat

Konsumi privat përbën një pjesë të rëndësishme të GDP-së së Kosovës. Gjate kësaj periudhe, konsumi privat nuk ka shënuar lëvizje të theksuara duke mbetur kështu në një mesatare prej 93.5% të GDP-së. Ndërsa, investimet private janë vlerësuar të kenë rënë gjate vitit 2010 e kjo mund të jetë rezultat i krizës ekonomike globale e cila mund të ketë pasur efekt të vonuar në ekonominë e Kosovës. Deri te kjo e dhënë është ardhur duke u bazuar në të dhënat e importit dhe kredive të lëshuara nga bankat komerciale në Kosovë. Sipas të dhënave të importit, mallrat kapitale kanë shënuar një rritje modeste duke u zëvendësuar kështu me një fluks më të madh të mallrave për përpunim të mëtejshëm për qellim të konsumit si dhe mallra për konsum. Në anën tjetër, kreditë e bankave komerciale kanë qenë të orientuara në masë më të madhe nga kreditë konsumuese duke i lënë kështu hapësirë më të vogël kredive për ndërmarrjet private.

Tabela 6 - Pjesëmarrja e sektorit privat ne BPV, në përqindje

Pershkrimi	2008	2009	2010	2011
Konsumi privat	95.3	92.3	93.9	92.6
Investimet private	19.4	19.6	17.8	18.6
Totali	114.7	111.8	111.8	111.2

Privatizimi

Në fillim të vitit 2011 përkatësisht në 27 janar, Bordi i Drejtorëve të AKP-së, bazuar në nenin 11 të Ligjit mbi Shërbyesit Civil nr. 03/L-149/2010 dhe Udhëzimit Administrativ mbi Procedurat e Rekrutimit të Ministrisë së Shërbimeve Publike MSHP/DASHC Nr. 2003/01, ka votuar unanimisht për kandidatën Shkelzen Lluka për Drejtor Menaxhues të AKP-se. Drejtori i ri Menaxhues i pari që nga themelimi i AKP-se ka filluar punën më 28 janar, 2011.

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) në periudhën raportuese ka mbajtur dy valë të privatizimit, vala 48 (28 Shkurt 2011) dhe Vala e 49 (13 Prill 2011) të bazuara në Biznes Planin e AKP-së për vitin 2011. Në këtë valën 48 janë krijuar 10 newco nga 10 Ndërmarrje Shoqërore. Për këtë valë ka pasur 37 oferta me vlerë totale prej 10,484,624 €, ndërsa në valën 49 nga 11 Ndërmarrje Shoqërore janë krijuar 11 Ndërmarrje të Reja. Gjithsjet ka pasur 38 oferta dhe shuma e ofruar është 9,558,841 €.

Është mbajtur shitja e gjashtë e aseteve përmes likuidimit me datën 09 Mars 2011 e cila shitje ishte e përbërë nga 13 njësi. Numri total i ofertave të pranuar ishte 47, ndërsa shuma totale e ofertave fituese ishte 8,061,364 €.

Sa i përket shpërndarjes së 20% të punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore (NSH) gjatë vitit 2011, AKP ka bërë shpërndarjen e pjesëshme për 39 NSH. Shpërndarja u është bërë 3,936 punëtorëve në shumë prej 5,769.595 €.

AKP poashtu ka punuar në drejtim të zhvillimit të kapaciteteve njerëzore. Në këtë drejtim, 45 zyrtarë janë trajnuar në kontabilitet, menaxhim dhe ekzekutim të shpenzimeve publike, pune ekipore etj. (shih Aneksin II, tabelen 26).

Hyrja dhe dalja e bizneseve

Gjatë periudhës raportuese Shtator -Mars 2011 në ARBK janë regjistruar 4427 Biznese të reja kurse ndryshime në Bizneset ekzistuese janë bërë në 3164 Biznese dhe janë shuar 474 Biznese. Gjatë kësaj periudhe në Zyrën e Pengut janë regjistruar 18861 Pengje.

Ambienti biznesor, sistemi gjyqësor dhe kapacitetet administrative

Ka filluar përzgjedhja e Arbitrave të parë të Gjykatës së Arbitrazhit nga Oda Ekonomike e Kosovës, dhe që do të ketë një lehtësirë më të madhe edhe për Biznesin.

Për sa i përket fushës së gjyqësisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka nxjerrë strategjinë për menaxhimin e lëndëve me të cilën u ka dhënë prioritet lëndëve të vjetra që janë ende të pazgjidhura në gjykata. Kjo strategji është e miratuar më 18 Nëntor 2010.

2.1.4. Sektori financiar

Sektori financiar në Kosovë vazhdoi të zgjerojë aktivitetin edhe gjatë vitit 2010, duke arritur vlerën e asetëve prej €3.2 miliardë (79% e BVP-së). Sektori bankar vazhdoi të dominojë strukturën e sektorit financiar edhe në vitin 2010 (77% e asetëve). Fondet pensionale në vitin 2010 menaxhuan 15% të asetëve, ndërsa pjesa tjetër e asetëve i takoi institucioneve mikrofinanciare (4% të asetëve), kompanive të sigurimit (3% të asetëve) dhe ndihmësve tjerë financiarë (0.6% të asetëve). Sa i përket numrit të institucioneve financiare në Kosovë, viti 2010 nuk u karakterizua me ndonjë ndryshim substancial në krahasim me vitin e kaluar. Numri i bankave dhe fondeve pensionale mbeti i pandryshuar, ndërsa një institucion mikrofinanciar vendosi të përfundojë së operuari dhe është mbyllur.

Megjithatë, gjatë periudhës 2008-2010, shkalla e koncentrimit të asetëve të tri bankave më të mëdha ka rënë vazhdimisht. Shkalla e koncentrimit, e shprehur përmes Indeksit Herfindahl-Hirschman (IHH) për asetet tregon rënie në 2,303 pikë në vitin 2010, krahasuar me 2,482 pikë në vitin 2009 dhe 2,745 pikë në vitin 2008.

Bashkë me rikuperimin e ekonomisë globale pas krizës, edhe perceptimet e bankave në Kosovë në lidhje me tregun vendor u përmirësuan, gjë e cila u reflektua përmes rritjes së kreditimit të ekonomisë. Në vitin 2010, vlera e kredive të lëshuara ishte €1.5 miliardë (36% e BPV-së). Norma e rritjes së kredive në vitin 2010 ishte 13.2%, krahasuar me normën e rritjes prej 8.9% në vitin 2009. Shkalla më e lartë e rritjes së kredive në vitin 2010 është shënuar te kreditë e ekonomive familjare (25.5%). Kreditë e ndërmarrjeve vazhduan të rritën me një normë më të ngadalshme të rritjes, prej 8.4%.

Struktura e kredive në vitin 2010 u dominua nga kreditë e ndërmarrjeve 70.4%, ndërsa 29.6% tjera ishin kredi për ekonomitë familjare. Niveli i ulët i prodhimit në Kosovë, si dhe varësia e lartë e Kosovës në importe është reflektuar edhe në shpërndarjen sektoriale të kredive. Pjesa më e madhe e kredive të lëshuara në vitin 2010 u absorbua nga kreditë tregtare (52.7%), pasuar nga kreditë industriale (26%), kreditë bujqësore (4%), etj.

Viti 2010 u karakterizua me rënie të normave të interesit në depozita, dhe me ngritje të lehta në normat e interesit në kredi. Norma mesatare e interesit në kredi gjatë vitit 2010

ishte 14.6% (14.4% në vitin 2009), ndërsa norma mesatare e interesit në depozita ishte 3.7% (4.3% në vitin 2009).

Sektori bankar në Kosovë e përmbylli vitin 2010 me profit neto prej €41.6 milionë (€29.6 milionë në vitin 2009). Faktorët që kontribuuan në rritjen e profitabilitetit të sektorit bankar në vitin 2010 ishin rritja më e shpejtë e të hyrave, kundrejt rritjes më të ngadalshme të shpenzimeve të sektorit bankar. Po ashtu, në rritjen e profitabilitetit ka ndikuar edhe rritja e kreditimit të ekonomisë, duke pas parasysh se të hyrat nga interesi përbëjnë burimin kryesor të gjithsej të hyrave në sektorin bankar. Rritja e profitabilitetit ndikoi edhe në përmirësimin e indikatorëve të performancës, si Kthimit Mesatar në Asete (KMA) dhe në Kthimin Mesatar në Kapital (KMK). Në vitin 2010, KMA u rrit në 1.6% (1.3% në vitin 2009), ndërsa KMK u rrit në 16.5% (12.8% në vitin 2009).

Portfolio investimet jashtë vendit shënuan rritje të konsiderueshme gjatë vitit 2010. Vlera e portoflio investimeve jashtë vendit deri në vitin 2010 ishte €231.0 milionë (€56.5 milionë në vitin 2009). Stabilizimi i tregjeve globale financiare mund të konsiderohet si faktori më i rëndësishëm që ka ndikuar në rritjen e portoflio investimeve jashtë vendit gjatë vitit 2010. Prej €231.0 milionë, 66.9% janë investime të fondeve pensionale ndërsa 33.1% janë investime të bankave komerciale që operojnë në Kosovë. Pjesa më e madhe e këtyre mjeteve janë investuar në instrumente të tregut monetar, si p.sh. letra me vlerë, ndërsa një pjesë më e vogël e këtyre mjeteve janë investuar edhe në tregje të kapitalit. (Shih Aneksin II, tabela 25)

2.2. KAPACITETI PËR TU PËRBALLUR ME PRESIONIN E KONKURENCËS DHE FORCAVE TË TREGUT BRENDIA UNIONIT

2.2.1. Kapitali Njerëzor dhe Fizik

Kapitali njerëzor. Në fokus të një funksionimi më të mirë të tregut të punës dhe një harmonizimi më të mirë të ofertës dhe kërkesës si dhe zbutjes së papunësisë strukturale në Kosovë, Divizioni i Punës dhe Punësimit gjatë periudhës Tetor 2010- Prill 2011 përmes Shërbimeve Publike të Punësimit ka ndërmjetësuar në punësim rreth 306 punëkërkues të të gjitha minoriteteve përfshirë komunitetin rom, ashkali dhe egjiptas(RAE).

Gjithashtu për këtë periudhë kohore Shërbimet Publike të Punësimit kanë regjistruar 9302 punëkërkues të rinj prej tyre 5379 femra, 1028 minoritarë, dhe 72 me aftësi të kufizuara dhe kanë ndërmjetësuar në punësim në total 2991 punëkërkues (1096 prej tyre femra). Në Projektin Kosvet-6 "Zhvillimi i skemave të trajnimit në kompani dhe zhvillimi i aftësive në ndërmarrësi" ku deri në mbarim të vitit 2010 janë ndërmjetësuar 1200 punëkërkues në trajnim në kompani kurse në këtë vit do të përfshihen 530.

Që nga janari i vitit 2010 është filluar me realizimin e Veprimeve të Strategjisë së Punësimit sipas Planit Akcional dhe rrjedha e tyre është sipas dinamikës së paraparë. Janë aprovuar 34 Projekte të punëve publike, përfitues kanë qenë 25 Komuna, ku gjatë periudhës raportuese në këtë projekt janë ndërmjetësuar në punësim 854 punëkërkues.

Divizioni i Punës dhe Punësimit në bashkëpunim me ekspertët e angazhuar në kuadër të Projektit „Mbështetje MPMS-së dhe DPP-së (Departamenti i Punës dhe Punësimit) e DMS-së (Departamenti i Mirëqenies Sociale) në ngritje të kapaciteteve e mbështetur dhe

financuar nga BE-ja ka mbajtur 3 punëtori lidhur me definimin dhe implementimin e standardeve minimale funksionale dhe strukturale në shërbimet publike të punësimit të Kosovës.

Në kuadër të periudhës raportuese në Qendrat e Aftësimit Profesional janë përfshire 1062 punëkërkuar. Sipas skemave të trajnimit në punë janë trajnuar 792, prej tyre 31 persona me aftësi të kufizuara. Janë aprovuar 14 kurrikula sipas standardeve të reja të cilat janë zhvilluar nga trajnerët e QAP-ve. Po ashtu me mbështetje të projektit Lux-Development është themeluar fondi i trajnimeve profesionale prej 100.000 eurove i cili menaxhohet nga MPMS-ja.

Nga tetori 2010 nën financimin e MPMS-së përmes blerjes së shërbimeve janë trajnuar 75 persona me aftësi të kufizuara në profilet teknologji informative për të verbër dhe njohje bazike të gjuhës së shenjave dhe interpret të gjuhës së shenjave.

Janë pajisur me vegla dhe mjete tri punëtori të reja të Qendrës për Aftësim Profesional (QAP) në Pejë me mbështetjen e projektit të Lux-development. Kjo qendër ofron mundësinë e zgjerimit të trajnimeve edhe për tri profesione të reja. Në mbështetje të projektit Lux-Development janë pajisur shumica e QAP me pajisje për profesionet e vrazhda. Janë zhvilluar 6 kurrikula për kontabilitet, turizëm, kuzhinier, përdorim i kompjuterit ESDL, auto-elektrik, furrтари.

Kapitali fizik: Nga investimet publike janë ndare mjete vetëm për autostradë (shih tabelën e mëposhtme), ndërsa për sa i përket energjisë, KEK-ut i është siguruar kredia prej €60 milionë dhe €45 milion për vitet 2010 respektivisht 2011, kryesisht për hapjen e minierës së Sibovcit. Për sa i përket fushës së telekomunikacionit, Posta dhe Telekom i Kosovës (PTK) është një korporatë fitimprurëse andaj të gjitha investimet që kanë të bëjnë me ngritje të kapaciteteve dhe zhvillim të korporatës bëhen nga profiti i vet kompanisë (shih tabelat 7, 8 dhe 9 në vijim).

Tabela 7 - Investimet private dhe publike, në miliona euro

Pershkrimi	2008	2009	2010	2011
Investimet private	746.8	766.0	758.8	859.6
Investimet publike	347.1	400.4	455.4	540.5
<i>Nga te cilat: autostrada</i>			131.0	225.0
Totali	1,094	1,166	1,214	1,400

Tabela 8 - Pjesëmarrja e FDI në GDP dhe vlera kumulative e FDI nga viti 2004

Pershkrimi	2008	2009	2010	2011
FDI si % e GDP	8.9	7.0	6.5	6.4
FDI kumulativ nga viti 2004	1,212	1,486	1,761	2,055

Vërejtje: Të dhënat për vitin 2010 janë vlerësime

Tabela 9 - hpërndarja e FDI nëpër sektorë, si përqindje e totale FDI

Pershkrimi	Sherbimet financiare	Prodhim	Patundshme eri	Transport dhe telekomuni kacion	Energji	Miniera	Ndërtimtari	Industri përpunuese	Bujqësi	Sherbimet tregtare, pastrim	Sherbime te keshillimit dhe	Sanitari	Te tjera
2008	34.9	6.0	16.8	13.8	4.5	4.7	3.7	8.5	2.3	2.7	0.6	0.6	0.9
2009	25.5	17.1	14.9	7.4	2.9	2.4	12.0	2.4	4.4	5.5	0.9	0.8	3.8
2010	24.5	13.7	14.3	6.4	0.1	4.6	17.0	9.7	0.6	3.8	2.9	1.0	1.5
2010 T1	16.8	18.7	19.2	8.6	0.0	1.0	17.5	10.5	1.5	2.6	1.4	1.1	1.2
T2	27.1	18.7	9.7	2.5	0.1	0.2	15.9	11.0	0.1	5.7	4.8	1.9	2.3
T3	29.4	3.6	14.1	8.2	0.2	12.8	17.6	7.5	0.1	3.2	2.4	0.0	1.0

Siç është paraqitur në tabelën e më sipërme, investimet e huaja direkte kanë treguar një rënie gjatë vitit 2010 dhe parashihet që të mbesin në po atë nivel edhe në vitin 2011. Kjo rënie është rezultat i ndikimit të krizës ekonomike globale e cila është manifestuar me rënie të ndjeshme të kërkesës globale. Kjo e përcjellur me shtrëngimin e kushteve të institucioneve ndërkombëtare financiare për të lëshuar kredi ka ndikuar në masë të madhe në hezitimin e kompanive ndërkombëtare për të investuar.

Infrastruktura Rrugore. Gjatë kësaj periudhe ka pasur përparim të konsiderueshëm në fushën e përmirësimit dhe zhvillimit infrastrukturor. Këtu para së gjithash duhet theksuar fillimin e ndërtimit të autostradës Morinë-Merdar, ku janë zhvilluar punime të intensitetit të lartë në segmentet 1, 2 dhe 3 (Vërmicë-Prizren-Suharekë), me gjatësi prej 34 kilometrash, realizimi i përgjithshëm i të cilave në vitin 2010 ka arritur 28,4%. Krahas kësaj është punuar në plotësimin e projektit zbatues për segmentet 5-7 (Qafa e Dulës-Prishtinë).

Përmirësimi, zhvillimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së transportit dhe infrastrukturës e cila është e integruar në korridoret panevropiane dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare: Në kuadër të këtij objekti janë zhvilluar aktivitete të rëndësishme, siç janë:

- Vazhdimi i projektit të zgjerimit të rrugëve nacionale M9 dhe M2, që është duke u zhvilluar sipas dinamikës së paraparë. Në rrugën M9, segmenti Fushë-Kosovë - Sllatinë është në përfundim e sipër, përveç objektit të rrethrotullimit të Aeroportit dhe nënkalimeve, që duhet të përfundojnë në vitin 2011, ndërsa segmenti Sllatinë - Gjurgjicë është realizuar 70%,
- ndërtimi i rrugëve të reja (10 km), objektiv ky që është realizuar konform kushteve të kontratave. Në vitin 2010 në tërësi kanë përfunduar 8 km rrugë;
- rehabilitimi i rrugëve ekzistuese (70 km), tek i cili është arritur progres në realizimin e punimeve sipas planeve dinamike, me ç'rast kanë përfunduar në tërësi 60 km rrugë,
- ndërtimi dhe rehabilitimi i rrugëve lokale (52.5 km), tek i cili është arritur progres në realizimin e punimeve në ndërtimin dhe rikonstruksionin e rrugëve lokale, me ç'rast kanë përfunduar në tërësi 85% e projekteve.

Energjia; Në kuadër të projektit të financuar nga KE, auditorët e trajnuar të energjisë në periudhën e parë tremujore të vitit 2011 janë pajisur me dokumentin që dëshmon përfundimin e testit. Numri i auditorëve që kanë dhënë provimin është 28+23=51 auditorë.

Ka filluar procesi i auditimit të rreth 80 objekteve të shkollave publike që do të jenë objekt i vlerësimit për t'iu nënshtruar zbatimit të masave të Eficiencës së Energjisë në kuadër të projektit të përkrahur nga Komisioni Evropian.

Për vitin 2011 janë buxhetuar dy projekte për mbështetjen e auditimit të energjisë në vlerë prej 80000€.

KOSTT me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe ngritjes së kapaciteteve transmetuese dhe transformuese në Rrjetin e Transmisionit në periudhën raportuese është duke implementuar projektin për SCADA/EMS dhe Telekomunikacion (Supervisory Control and Data Acquisition/Energy Management System) & shërbimet konsulente.

Buxheti i Kosovës (BK) ka ndarë mjete financiare për implementimin e këtij projekti. Projekti është në fazën përfundimtare të implementimit, janë instaluar pajisjet e SCADA/EMS në Qendrën Emergjente Kontrolluese, njëherit është duke u përgatitur qendra kontrolluese në KOSTT, janë realizuar testimet përkatëse të nënstacioneve 110 kV.

2.2.2. Reforma dhe liberalizimi i industrive të rrjetit

Zyra e Rregullatorit për Energji : Kompletimi i Kornizës rregullative (miratuar në Dhjetor 2010):

- Rregulla për krijimin e sistemit të certifikatave të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtërishme, mbeturinat si dhe nga bashkëprodhimi i kombinuar me nxehtësinë, në një njësi të vetme gjeneruese.
- Rregulla për mbështetjen e energjisë elektrike për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës dhe Procedurat për praninë në Skemën Mbështetëse.
- Standardet e kualitetit të furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike

Bordi i ZRRE-së në takimin e mbajtur me 30 mars 2011 ka miratuar Feed-in Tarifor për energjinë e prodhuar nga Era, Uji dhe Biogasi/Biomasa.

Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM); Në bazë të planit të punës 2011 për rishikimin e politikave tarifore, ZRRUM në këtë periudhë raportuese ka aprovuar Dokumentin e Politikave Tarifore dhe Kalendarin Rregullator si dhe është aprovuar Rregulla e Amandamentuar për Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve (R-08U&K).

Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit (ART): Bordi i ART-së për herë të parë 11 Shkurt, 2011 ka adoptuar dhe aprovuar Planin e Veprimit (Plani i Punës) me objektivat kryesore, të cilat derivojnë nga obligimet e parapara në Ligjin e Telekomunikacionit, dokumentin e Politikave të sektorit të Telekomunikacionit, si dhe veprimet e përcaktuara në Planin e Veprimit të Partneritetit Evropian (PVPE).

Që nga periudha e fundit raportuese e deri më sot janë aprovuar vendime dhe rregullore të ndryshme të cilat kanë rëndësi të veçantë në rregullimin e tregut të telekomunikacionit (shih Aneksin 1 për detajet).

Sa i përket liberalizimi të tregut të telekomunikacionit dhe konkurrencës, pas hyrjes në fuqi të Ligjit mbi Telekomunikacionin Nr. 2002/7 (i amendamentuar Nr. 03/L-85) janë krijuar kushtet për liberalizimin e tregut.

Deri më tani janë liberalizuar të gjitha shërbimet telekomunikuese, duke përfshirë shërbimet e telefonisë fikse, mobile, internetit, shërbimeve me vlerë të shtuar, etj.

Aktiviteti licencues është njeri prej aktiviteteve rregullatore me të rëndësishme që ka të bëjë me reformën e sektorit telekomunikues. Deri me tani ART, ka lëshuar gjithsej 52 licenca për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese. Në **janar 2011** është formuar Grupi Punues për analizën e tregut dhe definimin e ofruesve me fuqi te ndjeshme në treg (OFNT). Zyrtarisht analiza e tregut të telefonisë fikse, me nen-tregjet përkatëse ka filluar në muajin shkurt dhe pritet të përfundoj gjatë muajit shtator 2011.

Tregu i telefonisë mobile: Tregu i telefonisë mobile ka vazhduar me një trend pozitiv të rritjes edhe në vitin 2010. Aktualisht 4 operatorë (2 MNO dhe 2 MVNO) janë aktiv në treg dhe shkalla e penetrimit deri me K4-2010 ka arritur mbi 70%.

Sa i përket ndarjes se tregut midis operatoreve mobil gjate kuartalit te Katërt 2010, kemi pjesëmarrjen si ne vijim: Vala me 70% te tregut, Ipko me 27%, Z mobile me 2.5%, dhe D3 mobile me 0.5% te tregut.

Të ardhurat totale të katër operatorëve Mobil gjatë tremujorit të IV-të të vitit 2010 janë 45.6 mil euro.

Sa i përket përdoruesve rreth 96% e tyre janë me parapagim, ndërsa vetëm 4% me kontrate.

Tregu i telefonisë fikse: Liberalizimi i shërbimeve telekomunikuese ka ndikuar në zvogëlimin e tarifave për parapaguesit e telefonisë fikse. Aktualisht penetrimi i shërbimeve të telefonisë fikse është nën 5% në nivel të popullsisë. Krahasuar me nivelin e penetrimit të telefonisë mobile, përkundër investimeve të bëra në rrjetin e telefonisë fikse vërehet një ngadalësim në rritjen e numrit të konsumatorëve. Nëse krahasohen të dhënat e trafikut në K4 2009 në raport me K4 2010 mund të vërehet se trafiku i telefonisë fikse ka shënuar rritje për 29%, ndërsa nëse i krahasojmë të dhënat e trafikut të K4 në raport me K3 2010 po ashtu ka një rritje prej 2.4 %.

Tregu i internetit: Deri në prill 2011 janë licencuar 15 operatorë për ofrimin e shërbimeve të internetit në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Penetrimi i shërbimeve brezgjera (broadband) të internetit për momentin në Kosovë është rreth 7%. Aktualisht, në Kosovë dominojnë dy teknologji, të cilat mundësojnë ofrimin e shërbimeve broadband:

- Teknologjia DSL (Digital Subscriber Line), e cila si medium transmetimi shfrytëzon çiftin e telave të bakrit të linjës telefonike;
- Teknologjia e modemit kabllovik, e cila bazohet në kabllin koaksial

Shërbimet e internetit përmes teknologjisë DSL ofrohen vetëm nga Telekom i Kosovës, ndërsa operatorët privat shërbimet e tyre të internetit i ofrojnë kryesisht përmes teknologjisë së modemeve kabllovik dhe rrjetave pa tela (wireless), të cilat dominojnë në viset rurale në brezin 2.4GHz.

Shërbimet Postare: Në bazë të Ligjit 03/L-173 për Shërbimet Postare të datës 15 Prill 2010 ku përcaktohen roli dhe detyrat e rregullatorit, shërbimet postare definojnë si sektor në kuadër të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit (ART).

ART ka krijuar departamentin e shërbimit postar dhe rekrutuar Zyrtarin e Larte për Shërbime Postare.

ART me 18 Prill, 2011 ka aprovuar vendimin (Nr. 81, Nr. Prot. 018/B/11) për tarifën e reja të licencimit të operatoreve postar dhe tarifën vjetore nga të hyrat brutto të operatoreve postar të licencuar.

2.2.3. Zhvendosjet strukturore në ekonomi

Struktura sektoriale

Në mungesë të të dhënave relevante për zhvendosjen sektoriale ndërmjet bujqësisë, industrisë dhe shërbimeve, këtë proces do ta paraqesim përmes indikatorëve agroekonomik :

1. Bizneset e reja të regjistruara bujqësore,
2. Pjesëmarrjes së bujqësisë në BPV,
3. Komercializimit të fermave

Si rezultat i mbështetjes financiare nga MBPZHR-ja dhe donatorët, kemi pasur një rritje të fermave komerciale (të orientuara nga tregu) për 10 % në vitin 2010 në raport me vitin 2009.²

Sa i përket numrit të ndërmarrjeve bujqësore, kemi një rritje për 13% në vitin 2010 në raport me vitin 2009.³

Nga të dhënat e Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) shohim se numri më i madh i regjistruar i ndërmarrjeve të reja është në sektorin e Tregtisë me 2,111 Ndërmarrje të reja tregtare, derisa numri më i vogël i ndërmarrjeve është regjistruar në sektorin e peshkatarisë me vetëm 3 ndërmarrje të reja.

Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM)

Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM-të) në numrin total të ndërmarrjeve në Kosovë e përbëjnë mbi 99.4%. Në punësimin e përgjithshëm marrin pjesë me rreth 61%. Kontributi i NVM-ve në Bruto Produktin Vendorë (BPV) rreth 43.3%. Në Qarkullimin e përgjithshëm me rreth 57%. Pjesëmarrja e qarkullimit të përgjithshëm të NVM-ve të realizuar nga sektori privat 76.21 %.

Sipas madhësisë së NVM 98.37 % janë mikro-ndërmarrje (1-9 punëtorë), Ndërmarrje të Vogla (10-49 punëtorë) janë 1.35 %, Ndërmarrje të Mesme (50-249 punëtorë) janë 0.22 %, dhe Ndërmarrje të mëdha (mbi 250 të punësuar) janë 58 ose 0.06 %

Sipas të punësuarve mikro-ndërmarrjet (1- 9 punëtorë) kanë të punësuar 171,393 punëtorë apo 62.9%. Në ndërmarrje të vogla (10-49 punëtorë) janë të punësuar 23,380 apo 8.73 %, në ndërmarrje të mesme (50-249 punëtorë) janë të punësuar 22,026 punëtorë apo 8.58 %. Sa u përket ndërmarrjeve të mëdha (mbi 250 punëtorë) një karakteristikë e

² Raporti i mbështetjes financiare të MBPZHR-së për periudhën 2007-2010.

³ Raporti statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike në Kosovë (tremujorë dhe vjetore): 2009, 2010 ESK

veçantë e cila vlenë të theksohet është se këtu janë të regjistruara edhe ndërmarrjet shoqërore dhe publike (KEK, PTK etj.) dhe më gjithë këtë në ndërmarrje të mëdha janë të punësuar 55,658 punëtorë apo 20.42% e të punësuarve në bizneset e regjistruara.

Për nga forma e pronësisë, zhvendosja e formave po ndodhë shumë ngadalë edhe pse ka një progres në format e tjera të SHPK dhe Ortakërive. NVM që kanë formën e regjistrimit si biznes Individual përbëjnë mbi 90% të të gjitha formave të regjistrimit të bizneseve në Kosovë, Ortakëritë 4%, Shoqëritë 6.2%, Kompanitë e huaja 0.46%, NSH 0.01%, Ndërmarrjet publike 0.01%, Kooperativat 0.06%, ndërmarrjet nën AKP 0.03%

Struktura sektoriale e shpërndarjes së NVM-ve - po zhvendoset shumë ngadalë. NVM-të në sektorin e Tregtisë edhe pse kanë një rënje në krahasim me vitet e kaluara ende kanë një pjesëmarrje shumë të lartë duke e cila përbënë mbi 45% të totalit të NVM-ve në Kosovë. Këto tre vitet e fundit si rezultat i shtimit të investimeve publike në infrastrukturë NVM-të e sektorit të transportit përbëjnë 13% që shënon rritje të dukshme në krahasim me vitet para 2008. NVM-të në sektorin e Hoteleve dhe Restoranteve në 9.4%, sektori i patundshmërive në 4.8% dhe ndërtimtarisë në 6% ndërsa sektori i prodhimit të ushqimit ka një rritje të vogël numerike po në pjesëmarrje sektoriale ka një stagnim në 9%.

2.2.4. Intervenimet e Qeverisë në ekonomi

Ndërmarrjet e mëdha shtetërore

Qeveria e Kosovës ka marrë vendime për inicimin e proceseve për futjen e kapitalit privat në ndërmarrjet e mëdha publike në Kosovë, duke përfshirë KEK-un, PTK-në, dhe ANP-në. Sa i përket Aviacioni Civil më 04.04.2011 Aeroporti Nderkombetar i Prishtinës „Adem Jashari“ fillon zyrtarisht të operohet dhe menaxhohet nga kompania Limak Kosovo Airport International JSC, të cilit edhe i është transferuar certifikata e operimit nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr. 03/L-05 dhe Rregullores 1/2008 mbi Aeroportet. Ndërsa sa i përket privatizimit të distribucionit dhe shpërndarjes (KKDFE), në Janar 2011 është bere publikimi i ftesës për parakualifikim i cili vazhdon deri me 18 Mars 2011, datë e cila është përcaktuar si afat i fundit për parakualifikim.

Në qershor 2010 është marrë vendimi nga Qeveria e Republikës së Kosovës për ofrimin në tenderim dhe shitje të 75 % të aksioneve të Postes dhe Telekomunikacionit të Kosovës.

Kuvendi i Kosovës me 31.03.2011 ka dhënë miratimin e tij (në dy lexime) për vendimin e Qeverisë nr. 02/03 i cili ka qenë i vendosur në nenin 4 të ligjit të buxhetit dhe së bashku me dokumentin shpjegues i është bashkangjitur atij ligji, i cili do të kontribuoj në procesin e mëtutjeshëm të privatizimit të Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës.

Në vazhden e liberalizimit të tregut të shërbimeve ndaj qytetareve të Kosovës, Ministria e Ekonomisë dhe Financave (tani Ministria e Financave) ka iniciuar gjithashtu veprimin për shqyrtimin e mundësive të futjes së sektorin privat në sektorin e mbeturinave. Duke pasur parasysh këtë qellim, është nënshkruar kontrata me International Finance Corporation (pjesë e Bankës Botërore) për të analizuar opsionet për futjen e kapitalit privat në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës. Procesi është në vazhdimësi dhe priten dorëzimet e raporteve hulumtuese.

Në funksion të liberalizimit të tregut në sektorin e transportit hekurudhor, Qeveria e Kosovës ka marrë vendimin për liberalizimin e këtij tregu duke mundësuar futjen e kompanive private në këtë sektor. Ky vendim bën ndarjen e hekurudhave në Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA (tani e tutje INFRAKOS), e cila ka për detyrë të bëjë menaxhimin, mirëmbajtjen dhe ndërtimin e infrastrukturës hekurudhore, dhe Operimet e Transportit të Hekurudhave të Kosovës ShA (tani e tutje TRAINKOS), e cila ka për detyrë të bëjë menaxhimin dhe operimin me shërbimet e transportit të udhëtarëve dhe të mallrave me hekurudhë dhe me mjetet e tjera të transportit (Transporti Multi Modal).

Ndihma shtetërore

Në mungesë të legjislacionit për ndihma shtetërore i cili pritet të dërgohet për aprovim në Qeveri në muajin Maj, nuk kemi shifra dhe evidenca. Për momentin subvencionet e dhëna nuk mund të konsiderohen ndihma shtetërore në kuptim të legjislacionit për shkak të mungesës së kriterëve ligjore. Përfitues të skemave të ndihmës shtetërore do të jenë të gjithë sektorët me përjashtim të sektorëve të Bujqësisë dhe peshkimit.

Totali i ndihmës shtetërore është 48,568,100.00 (rreth 1% e GDP-së) Euro për investime kapitale dhe subvencione për ndërmarrjet publike. Kjo mbështetje dedikohet në sektorët e energjisë, ujit dhe mbeturinave dhe në sektorin e transportit. NJPMNP - MZHE ka përpiluar marrëveshjet e monitorimit të cilat përcaktojnë përgjegjësitë për përfituesit. Ndërmarrjet raportojnë në baza tremujore sipas kësaj marrëveshje për progresin e arritur për investimet e përfituara.

2.2.5. Integrimi tregtar

Gjatë vitit 2010 nga Kosova janë eksportuar mallra në vlerë 294,031,000 €, ndërsa janë importuar mallra në vlerë prej 2,139,534,000 €.

Gjatë vitit 2010 eksporti i rregullt është në vlerë prej 38,62 % e vlerës së eksporteve të përgjithshme ndërsa pjesa tjetër, apo 57.1 % është riekспорт, kryesisht eksport pas përpunimit të jashtëm. Kjo do të thotë se krahasuar me një vit më parë kemi një rënie të lehtë të eksporteve të rregullta dhe një rënie të madhe të eksporteve pas përpunimit të brendshëm ndërsa një ngritje të vlerës të eksporteve për përpunim të jashtëm.

Sipas destinacionit, apo sipas vendeve, gjatë vitit 2010 pjesa më e madhe eksporteve dhe importeve të Kosovës ka qenë e orientuar drejt vendeve të BE - së. Vlera e eksporteve për vendet e BE është mbi 131 mil/€ ose 44.7 % e totalit të eksporteve ndërsa vlera e importeve të mallrave është mbi 821mil/€ ose 38.4 % e totalit të përgjithshëm të importeve.

Kosova deri në fund të vitit 2010 ka pasur preferenca, pa ju nënshtruar tarifave doganore të cilat i ka vendosur Bashkimi Evropian për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Mirëpo marrëveshja tregtare me BE për lehtësira tregtare me Kosovën ka përfunduar më 31 dhjetor të vitit të kaluar, andaj prej 1 Janarit/ 2011 eksportuesit nga Kosova janë të obliguar të paguajnë taksa doganore gjatë eksportimit në BE.

3. STANDARDET EVROPIANE

3.1. Tregu i Brenshëm

3.1.1 Lëvizja e Lirë e Mallrave

Gjatë kësaj periudhe raportuese zhvillimi i legjislacionit në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave ka shënuar progres. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-069 për Akreditim është miratuar në Qeverinë e Kosovës me datën 30.03.2011. Poashtu, me datën 30.03.2011 në Qeverinë e Kosovës është aprovuar Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2004/18 për Tregtinë e Brendshme. Me datën 21.10.2010 është miratuar Ligji për Metrologji i cili mundëson adaptimin e direktivave për Qasje të Re.

Sa i përket legjislacionit sekondar, janë miratuar dy Udhëzime Administrative në fushën e termometrisë (16.11.2010). Poashtu, është miratuar U.A për Peshoret Jo-Automatike, bazuar në Direktiven Europiane 90/384/EEC (03.2011). Në muajin Shkurt 2011 është miratuar U.A për Testimin e Njehsorëve Elektronik të Energjisë Aktive Elektrike të Klasës së Saktësisë 1 dhe 2. Poashtu, është miratuar U.A për Kërkesat Tekniko - Metrologjike për Njehsorët Elektronik të Energjisë Reaktive të Klasës së Saktësisë 2 dhe 3.

Për më tepër, legjislacioni sekondar për implementimin e Ligjit Nr.03/L-181 për "Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut", është pasuruar me miratimin e dy Udhëzimeve Administrative të reja:

- U.A "Për Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit të Tregut" (Q2-2011)
- U.A "Për dokumentet formale-juridike të Inspektoratit të Tregut" (Q2-2011)

Sektori për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve gjate kësaj periudhe ka filluar me mbikëqyrjen e 5 direktivave të transpozuara nga MTI, për:

- 1. Ski-liftet;
- 2. Emërtimin dhe etiketimin e tekstileve;
- 3. Fibrat dy fishe-tekstil;
- 4. Pajtueshmërinë elektromagnetike;
- 5. Ashensorët dhe komponentët e sigurisë.

Sa i përket politikave të hartura në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, me qëllim të implementimit të Programit Kosovar për Mbrojtjen e Konsumatorit 2009 - 2014 nga 3 këshillimore të parapara, njëra është hapur; ndërsa për zyrtarët e qendrave regjionale ka përfunduar përshkrimi i vendeve të punës.

Në muajin Mars 2011 është mbajtur Java e konsumatorit dhe përgjatë muajit janë realizuar një varg aktivitete që kanë të bëjnë me vetëdijesimin e konsumatorëve (2 debate, shpërndarje e fletushkave, anketime të qytetarëve).

Në fushën e standardizimit numri i standardeve evropiane dhe ndërkombëtare të miratuara si standarde kosovare e arrin numrin 3386 EN të njohura si SK (34% të harmonizuara), kurse në diskutim publik gjenden 902 standarde të cilat duhet të votohen nga komitetet përkatëse para se të bëhet miratimi i tyre si standarde kosovare. Nga gjithsej 17 Komitete Teknike, për këtë periudhë raportuese 3 Komitete Teknike janë të reja. AKS është duke punuar në vazhdimësi për publikimin e veprimtarisë vjetore të saj në Shtator 2011.

Gjatë kësaj periudhe është akredituar një OVK dhe atë laboratorit analitik, bujqësor dhe i ushqimit. Po ashtu, është bërë mbikëqyrja e rregullt e 6 laboratorëve të tjerë. Sa i përket procedurave të vlerësimit dhe paravlerësimit, ato janë kryer edhe në 3 laboratore. Deri më tani DAK ka akredituar 17 Organizma për Vlerësim të Konformitetit (OVK).

Është kompletuar laboratorit për metale të çmuara në kuadër të Laboratorit Qendror të Metrologjisë së Kosovës. (25.12.2010). Ky Departament ka bërë kontrollin e cilësisë së punimeve nga metalet e çmuara mbi 30% në nivel vendi.

Pas aplikimit të DAK për marrëveshje multilaterale (MLA) në Korporatën Evropiane të Akreditimit për laborator testues (21.09.2010) është përcaktuar data e vlerësimit i cili do të bëhet më 15-20 Maj 2011. Si anëtare me të drejta të plota në ILAC dhe IAF, DAK vazhdon të merr pjesë në të gjitha votimet dhe aktivitetet e ILAC (Forumit Ndërkombëtar i Laboratorëve të Akredituar) dhe IAF (Forumit Ndërkombëtar i Akreditimit). Ndërsa, Departamenti i Metrologjisë është anëtarësuar në Lidhjen e Organizatës për EURAMET me datën 25.10.2010.

Gjatë kësaj periudhe DAK është në fazën e negociatave për nënshkrimin e Memorandumeve të Mirëkuptimit me Bosnjën e Hercegovinën, Malin e Zi dhe Hungarinë.

Në kuadër të fushatës për vetëdijësimin e konsumatorëve, inspektorati i tregut ka lansuar web faqen në të cilën lajmërohen produktet e rrezikshme për konsumatorët, sistem ky i cili do të paraprin sistemit të shpejt të alarmimit të produkteve të rrezikshme RAPEX.

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve institucionale, në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit në fushën e Standardizimit dhe Akreditimit, të nënshkruar në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, DAK ka mbajtur trajnimin e 2 zyrtarëve të saj në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit të Shqipërisë (DPA). DAK përgjatë procedurave të akreditimit ka shfrytëzuar një ekspert dhe një kryevlerësues nga DPA.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe është mbajtur trajnimi sipas kërkesave të standardit SK ISO/IEC 17025 për laborator testues, laborator kalibruar dhe trajnimi sipas kërkesave të standardit SK ISO/IEC 17021 për certifikimin e personave. Stafi ka vazhduar të përfitojë nga trajnimet përmes projekteve të PTB-së, me anë të të cilave janë trajnuar 4 zyrtarë. Përmes PTB janë mbajtur edhe 2 trajnime për vlerësues dhe kryevlerësues.

3.1.2. Lëvizja e Lirë e Kapitalit

Korniza e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik është përgatitur dhe aprovuar nga menaxhmenti në Tetor 2009, në Komitetin e Mbikëqyrjes Financiare. Rrjedhimisht,

mbikëqyrja bankare ka adaptuar qasjen e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik sipas kornizës së aprovuar.

Është realizuar Standardi GDDS (General Data Dissemination Standard). Republika e Kosovës nga 01 prill 2011 është anëtarësuar në Sistemin e Shpërndarjes së të Dhënave të Përgjithshëm të FMN-së. Gjithashtu me 24 Nëntor 2011, është themeluar dhe funksionalizuar Komiteti Nacional për GDDS i përbërë nga BQK, ESK dhe MF.

Me 21 Mars 2011, është themeluar Struktura Organizative e Njesisë së Operacioneve të Tregut të Hapur brenda BQK-së (pjesë e Drejtoratit të Menaxhimit të mjeteve). Kjo strukturë organizative përmban zyrën frontale (për operacione te huadhënies dhe garantimit) dhe zyra mbështetëse (back office) për azhurnimin e transaksioneve (finalizimin e procesimit të transaksioneve - settlement transactions), lëshimin e Bonave të thesarit dhe fletobligacioneve të Qeverisë.

3.1.3. Doganat dhe Tatimet

a. Doganat

Në kuadër të zbatimit të ligjit për masa doganore dhe për mbrojtjen e të drejtës së Pronësisë Intelektuale, janë ndërmarrë masa konkrete si: 8 aplikacione të aprovuara për mbrojtje të markës tregtare; 1 aplikacion i refuzuar për shkak se nuk i ka përmbushë kriteret e udhëzimit administrativ 07/2010 për aprovim; 15 raste të zbuluara dhe konfirmuara se shkelin të drejtën e pronës intelektuale; 13 raste të zbuluara sipas kërkesës për veprim; 2 raste të zbuluara EX-OFFICIO; 4 raste të shkatërrimit të mallit, ku janë shkatërruar gjithsej 1637 njësi të mallrave që shkelin të drejtën e pronës intelektuale; 3 raste janë në pritje të vendimit të gjykatës (97404 njësi të mallrave që shkelin të drejtën e pronës intelektuale); 6 raste në pritje për shkatërrim, ku jemi në pritje të përcaktimit të mënyrës së shkatërrimit të mallit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe agjencioni i AVUK-ut (63406 njësi pritet të shkatërrohen).

Gjatë kësaj periudhe në kuadër të Task Forcës (raste nga Dogana, bashkëpunim në mes të Doganës dhe Policisë dhe raste të referuara nga Policia e Kosovës) vetëm në Regjionin e Mitrovicës janë zbuluar 455 raste te kontrabandës, në të cilat raste janë bërë ndalimi dhe konfiskimi i mallrave; 303 raste janë detektuar nga Policia e Kosovës; 102 raste janë detektuar nga Dogana e Kosovës; 50 raste në bashkëpunim me Policinë e Kosovës; 196 raste janë referuar në Komisionin për Kundërvajtje Doganore; 7 Raste i janë referuar Hetuesisë - Doganës se Kosovës; 244 kanë përfunduar me procedurë mandatore;

Spektori për Pronësi Intelektuale më 23 mars 2011 ka përpiluar Procedurat Standarde të Operimit të parapara me Blueprint.

Në luftën kundër kontrabandës dhe krimin të organizuar janë realizuar, 579 operacione. 275 nga to janë referuar në Komisionin për Kundërvajtje

Në kuadër të hulumtimit të rasteve për keqpërdorim të detyrës zyrtare janë realizuar: 3 raste që dyshohen për keqpërdorim të detyrës zyrtare - korrupsion, në të cilat raste janë të përfshirë gjithsej 3 subjekte (zyrtare) doganor. Janë hetuar 3 raste që dyshohet për keqpërdorim të detyrës zyrtare në të cilat janë të përfshirë; janë shqyrtuar nga Komisioni Disiplinor 4 raste me 8 subjekte (zyrtare) që dyshohej për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe janë shqiptuar këto masa: 2 Vërejtje me shkrim; 7 Ndalim promovimi; 2 transfer në

detyrë tjetër; 1 Vërejtje e fundit me shkrim (parapërfundim); 1 anulim i performances së propozuar për shpërblime; 1 Degradim

Në kuadër të përmimit të bashkëpunimit me Prokurorinë e vendit, më 10.01.2011 është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit në mes Doganës dhe Prokurorisë.

Më 3 janar 2011 është plotësuar edhe pozita e udhëheqësit të Sektorit. Zyrtarët që mbulojnë Inteligjencën Lokale nëpër pika kufitare kanë mandat edhe çështjet e DPI.

Janë trajnuar 200 Oficer Doganor dhe janë mbajtur 26 Aktivitete Trajnuese. Përveç trajnimeve të brendshme të DK-së, është ofruar mbështetje edhe nga : Ambasada Amerikane (Dep. i Drejtësisë; Dep. i Thesarit Amerikan - OTA; EXBS), EU-CTA; EU-APO; EU-Anticorruption, IOM, OSBE, TADOC, Ambasada Franceze dhe Dogana Italiane (shih aneksin II, tabela 23).

a. Administrata Tatimore e Kosovës

Administrata Tatimore e Kosovës ka vazhduar me trendin pozitiv të mbledhjes së të hyrave ku për Janar-Mars 2011 janë realizuar të hyra në vlerë prej 62.6 mil.€, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, të hyrat janë më të larta për 15.2 milion Euro ose 32%.

Administrata Tatimore e Kosovës nga Tetori 2010 e deri në Mars 2011 ka arritur progres në realizimin e projektit të fiskalizimit duke pajisur 8.635 biznese me 10.920 Pajisje elektronike fiskale. Gjithsej deri tani janë pajisur 9.267 biznese me 12.306 pajisje elektronike fiskale.

Njësia për Hetime Tatimore, është funksionalizuar dhe gjatë marsit 2011 ka përzgjedhur trembëdhjetë rastet e para për shqyrtim.

Në kuadër të ngritjes së sistemit SIGTAS, krahas moduleve kryesore të aplikacionit, janë aktivizuar edhe këto module: deklarata elektronike, ndërlidhja me Bankën Qendrore dhe deklarimi elektronik.

Deri në këtë kohë është aktivizuar vetëm deklarimi i raporteve të blerjeve mbi 500 Euro. Deri më tani janë regjistruar më tepër se 4.000 tatimpagues, ndërsa janë dorëzuar më tepër se 3.000 deklarata dhe më se 60.000 transaksione në raportet e dërguara.

Në kuadër të fuqizimit të mëtutjeshëm të Njesisë për Hetime Tatimore, janë zhvilluar trajnimet e planifikuara nga projekti EU-CTA deri në mars 2011. Për këtë periudhë janë mbajtur 40 trajnime në lëpinë e zbatimit të legjislacionit tatimor me numër prej 588 pjesëmarrës. Gjithashtu janë në zhvillim e sipër procedurat për ngritjen e kapaciteteve edhe për 40 zyrtar tatimor

Në kuadër të promovimit të politikave tatimore janë mbajtur pesë (5) takime-tryeza me përfaqësues të tatimpaguesve (OEK, OEAK, AKB, SHKCAK) me qëllim të ngritjes së komunikimit për shqyrtimin e shqetësimeve të TP, po ashtu janë mbajtur 10 seminare me tatimpagues nga të cilat tre (3) në Prishtinë dhe shtatë (7) në regjione.

Në ofrimin e shërbimeve elektronike gjatë kësaj periudhe raportuese janë shkarkuar 697.823 deklarata sipas llojeve të ndryshme të tatimeve. Ndërsa me deklarimin

elektronik ende nuk është filluar dhe është në shfrytëzim për tatimpagues vetëm për testimet (shih aneksin II, tabela 23).

3.1.4. Konkurrenca

Sa i përket arritjeve në fushën legjislative gjatë kësaj periudhe raportuese, me datën 10.12.2010 është miratuar Ligji Nr.03/L-229 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës".

Në aspektin operativ, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës gjatë periudhës raportuese ka bërë hetimin e Marrëveshjes së Kompanive të Sigurimit. Lidhur me këtë rast janë hetuar 10 kompani sigurimi dhe të njëjtat është gjetur se kanë qenë nënshkruese të marrëveshjes për price-fixing. Me anë të këtij vendimi këto kompani të sigurimit janë penalizuar me sanksione administrative.

3.1.5. Prokurimi Publik

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), përkatësisht Departamenti për Mbikëqyrje dhe Monitorim për periudhën raportuese deri më 31.03.2011, ka përfunduar monitorimet në 9 (nëntë) autoritete kontraktuese si monitorime të rregullta dhe 2 (dy) monitorime sipas rastit.

Deri me tani nga KRPP-ja janë kryer tri dosjet tenderike:

- a) Dosjen tenderike për furnizime,
- b) Dosjen tenderike për shërbime,
- c) Dosjen tenderike për punë,

Të gjitha dosjet tenderime kanë hyrë në fuqi nga 16 Mars 2011.

KRPP-ja ka shpallur edhe tri Udhëzime Administrative :

- a) Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2011 - për hapjen publike të ofertave, ka hyrë në fuqi më 11 Mars 2011;
- b) Udhëzimi administrativ Nr. 02/2011 - për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, ka hyrë në fuqi më 11 Mars 2011;
- c) Udhëzimi administrativ Nr. 03/2011 - për përdorimin e gjuhëve në dokumentet e prokurimit, ka hyrë në fuqi më 15 Mars 2011.

Konform Ligjit të ri për Prokurim Publik (Nr. 03/L-241), trajnimi për prokurim publik zgjat 15 ditë brenda vitit. Ne vitin 2011 janë duke vazhduar trajnimet e filluara ne vitin paraprak. Trajnimet organizohen nga Instituti Kosovar për Administratë Publike i Kosovës, i mbështetur nga KRPP-ja. Janë duke u trajnuar 521 zyrtarë të prokurimit të cilët punojnë në 161 autoritete kontraktuese të Kosovës. Testimi i zyrtarëve të prokurimit sipas kërkesave të ligjit është në finalizim, dhe pritet të mbahet kah mesi i prillit 2011.

Agjencioni për Prokurim Publik konform dispozitave të LPP-së, ka 5 zyrtarë të certifikuar, me ç'rast zyrtari i fundit është punësuar me 01 Mars 2011 ku edhe është plotësuar stafi.

APP deri më tani ka zhvilluar 2 procedura te centralizuara për Shoqatën e Ujërave dhe Kanalizimeve të Kosovës (SHUKOS) dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB).

OSHP ka pranuar gjithsejtë 43 ankesa të operatorëve ekonomik përfshirë edhe kërkesat e Autoriteteve Kontraktues për rishqyrtimin e vendimeve të APP-së. Prej tyre 38 ankesa janë të Operatorëve ekonomik të ushtruara kundër vendimeve të autoritetit kontraktues për dhënin e kontratës, kurse 5 janë kërkesa për rishqyrtimin e vendimeve të APP-së. Prej 38 ankesave të OE, 20 janë shqyrtuar nga OSHP-ja, kurse 18 janë në shqyrtim e sipër. 30% të ankesave kanë shkuar në favor të operatorëve ekonomik. Ndërsa sa i përket vendimeve të APP-së, 100%, kanë shkuar në favor të Autoriteteve Kontraktuese.

3.1.6. Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale dhe të Drejtat e Autorit

Në këtë periudhë raportuese është marrë e drejta e shfrytëzimit të klasifikatorëve ndërkombëtarë për regjistrim të objekteve të pronës industriale dhe të njëjtat janë përkthyer në gjuhën shqipe.

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve për zbatimin e rregullave të pronësisë intelektuale janë mbajtur 2 seminare për më shumë se 60 gjyqtarë të fushës penale, civile, dhe administrative. Po ashtu, është mbajtur 1 seminar për më shumë se 40 zyrtarë të institucioneve në Kosovë të cilat janë të përfshira në këtë fushë (Zyra për Pronësi Intelektuale; Dogana e Kosovës; Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta; Zyrat e prokurorit; Inspektorati i Tregut; dhe Policia e Kosovës) dhe janë mbajtur tri seminare për rëndësinë e mbrojtjes së pronës industriale për kompani të biznesit.

Në kuadër të fushatës së vetëdijesimit është mbajtur konferenca dhe fushata mediale "Ditët e Pronësisë Intelektuale në Kosovë" i përcjellur me ekspozitë për mallrat e ndaluara të cilat kanë shkelur të drejtat e pronës intelektuale dhe tri seminare një për të drejtat e autorit një për studentë dhe një për të drejtat e pronës industriale (28.04.2011) Me datë 12.04.2011 është publikuar buletini nr.2 i Zyrës së Pronësisë Industriale me objektet e regjistruara të pronës industriale, marka, patenta, dizajn që përmban me shume se 1500 vendime të publikuara dhe me shume se 600 faqe.

Sikurse Zyra për të Drejtat Intelektuale, po ashtu edhe Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta ka arritur progres sa i përket ngritjes institucionale të saj. Gjatë kësaj periudhe raportuese është realizuar një vizitë studimore e kësaj zyre tek Zyra për Pronësi Intelektuale në Slloveni. Në Dhjetor të vitit 2010 është mbajtur një punëtori në të cilën kanë qenë pjesëmarrës autorët, producentët, dhe interpretuesit, ku është diskutuar për legjislacionin në fuqi.

3.1.7. Punësimi dhe Politikat Sociale

Me qëllim të zvogëlimin të mospërputhjes, rritjes së aftësive të regjistruarve të papunë, rritjen e kërkesës për forcën e punës, mundësit për vetëpunësim MPMS-ja gjatë kësaj periudhe raportuese përmes Shërbimeve Publike të Punësimit ka ndërmjetësuar në punësim rreth 306 punëkërkues të gjitha minoriteteve përfshi edhe rom, ashkali dhe Egjiptas(RAE).

Gjithashtu për këtë periudhë kohore Shërbimet Publike të Punësimit kanë regjistruar 9302 punëkërkues të rinj prej tyre femra 5379, minoritete 1028 dhe 72 me aftësi të kufizuara dhe kanë ndërmjetësuar në punësim në total 2991 punëkërkues femra 1096. Bazuar në Udhëzimin Administrativë nr;05/2009; „Për evidentimin dhe regjistrimin e punëkërkuesve në SHPP,, gjatë periudhës raportuese janë ç’regjistruar përmes SHPP-ve 7747 punë kërkues Gjatë kësaj periudhe raportuese në Strategjinë Legjislative është hy

në procedurë kërkesa për draftimin e Ligjit mbi Organizimin dhe Funkcionimin e SHPP-ve dhe Draft Ligjit e mbi Evidencën dhe regjistrimin punëkërkuësve. Tani vetëm ka filluar hartimi i Draft- Ligjit mbi Organizimin dhe Funkcionim e SHPP-ve.

Në Projektin Kosvet-6 "Zhvillimi i skemave të trajnimit në kompani dhe zhvillimi i aftësive në ndërmarrësi" ku deri në mbarim të vitit 2010 janë ndërmjetësuar 1200 punëkërkuës në trajnim në kompani kurse në këtë vit do të përfshihen 530. Po ashtu është duke u implementuar Projekti "Aftësimi profesional në Kosovë" në bashkëpunim me Lux Devevelopment nga Luxemburgu në skemën trajnimit në kompani për punëkërkuësit që e kanë kryer trajnimin në QAP ku janë ndërmjetësuar 227 punëkërkuës. Përmes Projektit ; ,, Tregu Aktiv i Punës për Gjenerim të Punësimit ka ndërmjetësuar 962 punëkërkuës përmes skemave të trajnimit në kompani, trajnime në institucione dhe trajnim në ndërmarrje dhe skemën e praktikantëve.

Ngritjen e efikasitetit të funksioneve të saja konform dinamikës së tregut të punës Departamenti i Punës dhe Punësimit ka vazhduar me thellimin e reformave dhe modernizimit e Shërbimeve Publike të Punësimit. Për këtë ka përfunduar procesi i përmirësimit të softuerit dhe harduerit si dhe është bërë instalimi e pasjeve të TI-së nëpër të gjitha Zyrat e Punësimit, është bërë centralizimi dhe është krijuar moduli shtesë për bazën e të dhënave. Gjithashtu është përfunduar procesi i modifikimit të SIMP-it(Sistemit të Informimit të Menaxhmentit të Punësimit). Është bërë edhe Hulumtimi i Nevojave të Tregut të Punës dhe i Kostos për një vend pune.

Është hartuar projekt koncepti për themelimin e një sistemi të besueshëm të informatave të tregut të punës. Po ashtu është themeluar Grupi i Punës për ndërtimin e modulit të ofertave të punës në kuadër të SITP-së . TOR-i për angazhimin e një eksperti ndërkombëtarë është hartu në bashkëpunim me UNDP-në. Është bërë përzgjedhja e ekspertit ndërkombëtarë nga kjo fushë.

Janë realizuar të gjitha veprimet e parapara sipas Planit Akcional të Strategjisë së Punësimit dhe në fund të vitit 2010 janë realizuar 34 Projekte përmes Programit ; ,, Punët publike ,, ku përfitues ishin 25 Komuna, përmes këtij programi janë ndërmjetësuar në punësim 854 punëkërkuës. Përmes punëve publike të financuara nga MPMS-ja janë ndërmjetësuar 450 punëkërkuës.

Në bashkëpunim me ekspertët nga Projekti; ,, Mbështetje MPMS-së dhe DPP-së DMS-së në ngritje të kapaciteteve ,, e mbështetur dhe financiar nga BE-ja janë mbajtur 5 punëtori lidhur me definimin, implementimin dhe aranzhimin standardeve minimale të SHPP-ve të Kosovës si dhe është hartuar draft dokumenti mbi Programet Aktive të Tregut të Punës.

Gjatë kësaj periudhe është aprovuar Strategjia Sektoriale 2010-2012 dhe Plani i Veprimit.

MPMS në kuadër të krijimit të politikave dhe obligimeve të dala nga Strategjia Sektoriale 2009-2013 e aprovuar në janar 2010 ,ka hartuar Planin e Veprimit 2011-2013 i cili është aprovuar në muajin mars 2011. Më qëllim të promovimit dhe krijimit të mekanizmave të monitorimit të këtij plani dhe koordinimit të asistencës së donatorëve për sektorin e punës dhe mirëqenies sociale me 14 prill 2011 është organizuar një punëtori një ditore ,ku kanë marrë pjesë përfaqësues ambasadash,donatorët mbështetës të MPMS-së dhe të institucioneve të Kosovës.

Në aspektin e ngritjes se kapaciteteve në nivel komunal, është duke u ofruar mbështetje në ofrimin e shërbimeve dhe ngritjen e kapaciteteve të resurseve njerëzore përmes projektit që implementohet nga OJQ-ja "One to One" që ka shtrirje në disa komuna (Prizren, Pejë, Shtime, Graçanicë dhe Prishtinë), ku prioritet parësor ka mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në ofrimin e shërbimeve përmes qendrave ditore.

Vazhdon mbështetja ndaj OJQ-ve, strehimoreve për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe viktimave të trafikimit, përmes së cilave gjatë gjithë vitit 2010 janë trajtuar dhe ofruar shërbime për 560 raste të viktimave të dhunës në familje dhe 48 raste të viktimave të trafikimit. Strehimoret janë të shtrira në 6 Qendra Regjionale të cilat monitorohen nga MPMS-ja dhe bashkëfinancohen me 50% nga buxheti i MPMS-së.

Projekti "Mbështetje nga BE-ja MPMS" është duke ofruar asistencë teknike për hartimin e standardeve të shërbimeve sociale, licencimin e punëtorëve social dhe në rishikimin e skemës së ndihmës sociale.

Këshilli Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare ka arritur që të funksionalizohet në mandatin e dytë trevjeçar dhe të jetë me aktiv në ushtrimin e përgjegjësive në hartimin e legjislacionit sekondar për licencimin e punëtorëve social.

Me mbështetje të asistencës së TAEX-it është arritur të kemi progres në hartimin dhe aprovimin e dy Udhëzimeve Administrative, të cilat mundësojnë zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve në komunitet për personat me aftësi të kufizuara dhe personat e moshuar.

Sipas MOU në mes të Departamentit të Mirëqenies Sociale dhe Departamentit të Punës dhe Punësimit (nr.1038, të dt.05.VII.2005), për çdo muaj Qendrat për Punë Sociale ofrojnë regjistrat e të aftëve për punë, të kategorisë së dytë në SNS, ndërsa zyrat Komunale të Punësimit përmes certifikatave vërtetojnë se ata janë të regjistruar si punëkërkuar. Një numër i caktuar i këtyre të papunëve përfshihet në programe trajnuese për t'u përgatitur për tregun e punës.

Gjatë periudhës janar-mars 2011 në kuadër të funksionalizimit të Sistemit të Integruar Informativ të MPMS-së, është dizajnuar dhe instaluar baza e re e të dhënave për ndihmë sociale e cila tani është në fazën testuese.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Njësia e Kontrollit dhe Monitorimit (NJKM) ka kontrolluar 9 QPS në : Ferizaj, Obiliq, Istog, Deçan, Junik, Novobërdë dhe tri QPS-të në Prishtinë, ku ka kontrolluar 642 lëndë të shfrytëzuesve të ndihmave sociale, prej të cilave 306 lëndë kanë qenë me mungesë të ndonjë dokumenti dhe ka verifikuar drejtpërdrejt në vendbanimin e tyre 552 familje, prej të cilave 74 familje kanë qenë të papërzgjedhura dhe jo në harmoni me kriteret e Ligjit të SNS-së dhe të njëjtat janë larguar nga SNS-ja.

Përmes NJKM në kuadër të DMS-së dhe Auditorit të Brendshëm të MPMS-së në vazhdimësi është bërë kontrollimi dhe inspektimi i QPS-ve, të nëpunësve të SNS-së dhe të parashtruesve të kërkesave për të identifikuar dhe larguar nga SNS mashtresit eventual të përfitimeve të ndihmës sociale.

Gjithashtu, është pajisur me zyre inspektori i punës në Komunën e Graçanicës.

Në sektorin e shëndetësisë Është funksionalizuar Sistemi informimit Shëndetësor në Qendrën Klinike Stomatologjike të Kosovës, dhe spitalin rajonal të Prizrenit. Sistemi dhe është funksional prej Janarit të vitit 2011.

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore për komunitetin RAE dhe komunitetet tjera është veprim në vazhdim dhe është duke u realizuar nga institucionet shëndetësore në ato vendbanime ku është përqendruar ky komunitet dhe komunitetet tjera.

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve institucionale 87 specialistë kanë përfunduar specializimin e emergjencave, janë trajnuar 10 punëtorë shëndetësor për menaxhimin e emergjencave gjithashtu janë specializuar 10 onkolog. Në kujdesin Parësor Shëndetësor janë trajnuar gjithsej 419 infermiere dhe mami dhe profile tjera të nivelit të mesëm. Në kuadër të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2011-2013 do të identifikohet buxheti për përmirësimin e shëndetit të nënës dhe fëmijës dhe Kujdesin Parësor Shëndetësor.

3.1.8. Arsimi dhe Hulumtimi

Për të avancuar më tutje arsimin dhe aftësimin profesional në shtator të vitit 2010 është nënshkruar një memorandum mirëkuptimit në mes të Odës Ekonomike dhe MASHT-it për bashkëpunim mes shkollave dhe biznesit.

Sa i përket infrastrukturës shkollore, ka përfunduar ndërtimi i tri objekteve shkollore (Prizreni, Pejë (Osdrim), dhe Malishevë (Mleqan).

Në aspektin e integritit të minoriteteve, është bërë identifikimi i nevojave për staf mësimdhënës dhe akademik në gjuhën e komuniteteve dhe më 1 Prill 2011 ka filluar grupi i parë i ri-kualifikimit të mësimdhënësve të cilët kanë kryer shkollën e lartë pedagogjike në Fakultetin e Edukimit në gjuhën boshnjake dhe turke.

Me mbështetjen e Odës Tregtare Kosovaro-Turke janë ndanë bursa për 40 nxënës të suksesshëm të shkollave të mesme, të cilët kanë nevojë për mbështetje financiare. Në listë janë përfshirë nxënës nga komuniteti shqiptar (23), turk (9), boshnjak (5), ashkali (2) dhe rom (1). Gjithashtu MASHT në bashkëpunim me MKK dhe me mbështetje të UNDP ka ndarë 70 bursa për nxënës RAE.

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve, janë kryer dy trajnime për mësimdhënës dhe drejtorë të shkollave, të cilët punojnë në shkolla ku ka nxënës nga komunitetet romë, ashkalinjë dhe egjiptianë lidhur me planprogramin e gjuhës rome dhe metodologjinë e re të mësimin. Gjithashtu, Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional ka qenë pjesë e trajnimeve për vetëvlerësimin e shkollave profesionale, dhe vlerësimin e jashtëm.

Ka vazhduar krijimi i kushteve adekuate për fëmijët me nevoja të veçanta. Rrjeti i qendrave burimore është funksional dhe deri më tani janë identifikuar dhe mbështetur 150 fëmijë me nevoja të veçanta.

Është siguruar transporti për të gjithë nxënësit me aftësi të kufizuar (MASHT financon gjithë sistemin e arsimit special dhe vetëm për transport ndanë rreth 200.000 € në vit).

Në kuadër të zbatimit të Programit Kombëtar për Shkencë, është mundësuar abonimi i Universitetit të Prishtinës, Institutit Albanologjik, Institutit i Historisë dhe MASHT-it në bibliotekën elektronike ISI-WEB of Knowledge.

Edhe këtë vit arsimi i lartë ka përfituar nga programet e ndryshme të BE-së, ndër të cilat deri në fund të kësaj periudhe raportuese ka pasur 8 përfitues nga programi CEEPUS, ky numër do të rritet deri në fund të vitit akademik. Pesë programe nga Kosova kanë fituar fonde nga programi i Tempus-it.

3.2. Politikat Sektoriale

3.2.1. Industria dhe NVM-të

Agjencia për mbështetjen e NVM-ve ka nxjerrë të gjitha aktet nënligjore të parapara për implementimin e Ligji për Zona Ekonomike № 03/L-129 në Kosovë si dhe ka kompletuar dokumentacionin për themelimin-legalizimin e dy Zonave Ekonomike (Parku i Biznesit në Drenas dhe Parku Teknologjik në Skenderaj) të cilat u themeluan me vendim të qeveris së Kosovës konform Ligjit në fuqi. Poashtu, ka përfunduar faza e pranimit teknik të objektit të Inkubatorit të ri në parkun e Biznesit në Drenas, dhe është bere hapja e parkut.

Në aspektin operativ, është bërë furnizimi i 3 inkubatorëve me nga një kabinet të IT-së prej 10 kompjuterëve. Programi i shkëmbimit mes mësimëve teorike të të bërit biznes dhe bërjes praktike të biznesit i njohur tani më si “Programi Intern-ship Biznesi” vazhdoi edhe vitin raportues duke përfituar nga këto programe 230 studentë universitar dhe 100 nxënës të shkollave

Në periudhën raportuese Skema Vaucher e Këshillimeve dhe Trajnimeve - përmes trajnerëve dhe këshilltarve profesional të biznesit ka implementuar me sukses 2657 ditë trajnimi dhe këshillimi për kategoritë e ndryshme ndërmarrëse (ndërmarrësit potencial, ndërmarrësit ekzistues, bizneset fillestare dhe bizneset ekzistuese nga sektori i prodhimit dhe shërbimeve) dhe projekti është mbyllur me në Dhjetor 2010.

Janë mbajtur mbi 25 takime të grupeve punuese në të cilat ka debatuar prioritetet strategjike të NVM; rreth 50 takime me akter të tjerë; 5 punëtori dhe 1 konferencë kombëtare për diskutimin e prioritetëve.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, lidhur me ngritjen e kapaciteteve institucionale janë mbajtur 2 punëtori dhe 1 konferencë kombëtare për diskutimin e prioritetëve strategjike të NVM-ve në Kosovë.

Agjencia për Promovimin e Investimeve

Ka krijuar një bazë të dhënave me qëllim të identifikimit të pronave të cilat mund të ofrohen për investitorët e huaj si dhe është në fazën përfundimtare implementimi i bazës së të dhënave CRM/ACT 2011 me të cilën është arritur që të ofrohen shërbime me të mira për investitorët e huaj.

Janë mbajtur 10 takime B2B brenda dhe jashtë Kosovës. SHBA Slloveni, Austri, Zvicër Holandë, Turqi, Shqipëri. Mbi 200 kompani kosovare kanë marrë pjesë në takime B2B brenda dhe jashtë vendit.

Janë botuar materiale promovuese (Botimi i broshurës “Investing Guide” Kosovo Fact Sheet (fletushkë), Top 10 Reasons to Invest in Kosovo (fletushkë), IT and Business Process Outsourcing (BPO) opportunities in Kosovo ,The Legal Guide to Kosovo.

Janë mbajtur 7 panaiere brenda dhe jashtë vendit. UK , Kroaci, Shqipëri, Mal të Zi. Panaiert janë vizituar në total nga mbi 20,000 vizitorë. Mbi 200 kompani kosovare kanë marrë pjesë në panaiere. Shitje totale gjatë panaiereve mbi 2 milion EUR.

Është formuar grupi punues ndërministror për implementimin e ndryshimeve të ligjeve që kanë ndikim në krijimin e një ambienti më të mirë për biznesin.

APIK-u është angazhuar në krijimin e një ambienti më të mirë biznesor dhe klime më të mirë për investime bazuar në raportin e BB Doing Business. Është finalizuar dokumenti, Rekomandimet për thjeshtësim të lejeve dhe Licencave në nivelin qendror dhe lokal.

3.2.2 Bujqësia dhe Peshkataria

Gjatë kësaj periudhe në fushën e Legjislacionit, politikave dhe strategjive sektoriale, MBPZHR ka ndërmarr këto veprime si vijon:

- Është bërë Amandamenti i Ligjit për Blegtorinë e Kosovës 2004/33 dhe është aprovuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës më 28.10.2010.

Me datë 18.04.2011 janë nënshkruar këto Udhëzime Administrative si vijon:

- Udhëzimi Administrativ Nr.09/2011 për masat dhe kriteret e përkrahjes së Bujqësisë dhe Zhvillim Rural për vitin 2011;
- Udhëzimi Administrativ Nr.12/2011 për Pagesa Direkte në Bujqësi për vitin 2011.
- Për ta zbatuar Ligjin për Tokat Bujqësore, me datë 18 prill 2011 është nënshkruar nga Ministri i Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Strategjia për Konsolidimin e Tokës 2010-2020 dhe së bashku me Planin e veprimit për Zbatimin e kësaj Strategjie.
- Me datë 14.02.2011, ref ZSP- 68/11, Nr 32, është formuar Komisioni në përbërje prej shtatë anëtarëve për përgatitjen e Projektligjit për ndryshim-plotësimin e Ligjit Nr.02/L-95 për Mbrojtjen e Bimëve.
- Me vendim të Ministrit të MBPZHR , Ref.ZM/60/2010, dt. 05.08.2010 është formuar Komisioni për përcaktimin e zonave ku do të themelohen vend gjueti me rëndësi të veçantë në regjionin e Bjeshkëve të Nemuna. Komisioni ka 11 anëtar.
- Në mbledhjen e Qeverisë datë 30.03.2011 është themeluar Bordi për Menaxhimin e Pyjeve.

Sa i përket krijimit të regjistrimit të Tokave, janë caktuar Komunitetet ku do të zhvillohen disa prej objektivave të projektit si: Sistemi informativ për parcelat e tokës (LPIS) pilot-zonë; Aplikacioni i GIS-it për modelet e planifikimit hapësinor rural (1 pilot zonë Suhareka dhe 7 ko-pilot zonë-Prishtina, Graçanica, Vitia, Istogu, Peja, Kaçaniku dhe Lipjani); Inventarizimi, vlerësimi, monitorimi dhe krijimi i bazës së të dhënave për tokat e ndotura në Kosovë. Për të realizuar këtë objektiv është shpallur tender rajonal.

Është përgatitur programi vjetor për bujqësi dhe zhvillim rural, masa e 2 – ristrukturimi i potencialit fizik në fermë dhe masa- 8 mbështetje GLV (Grupeve Lokale të veprimit) janë përgatitur sipas rregullave dhe procedurave të programit IPARD.

Thirrjet për aplikim për programin e zhvillimit rural dhe pagesa direkte janë shpall me 30.03.2011.

Ka vazhduar rehabilitimi i sistemit të ujitjes edhe gjatë 2011 me buxhet të njëjtë si në vitin paraprak. Janë rehabilituar pendat-devijuese në fshatin Sheremet të komunës së Gjakovës dhe Junik. Janë ndërtuar kanalet e ujitjes në fshatin Tomoc të komunës së Istogut me gjatësi 2188,6m që do të ujitet 200 ha. Është bërë rehabilitimi i rrjetit të ujitjes

prej 70 ha në fshatin Vitomicicë të komunës së Pejës si dhe është bërë betonimi i kanalit të ujitjes Isniq-Prapaqan-Deçan për ujitjen e 1000 ha në gjatësi prej 6,025m. Me datë 26.11.2010 është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit me kryetarët e 7 komunave të Kosovës për ngritjen e sistemit të informacioneve për parcelat e tokës (LPIS), në komunën e Suharekës dhe do të vazhdoj edhe në 6 komunat tjera ko-pilot.

Sa i përket parandalimit të shkatërrimit të pyjeve dhe tokave pyjore, janë lëshuar 2 kontrata për gurthyes. kurse janë në proces të përmbushjes së obligimeve edhe nga Institucionet tjera si MMPH dhe KPMM, edhe 19 kontrata tjera.

Agjencioni Pyjor i Kosovës ka lëshuar 3 pëlqime për gurëthyes në prona private, ndërsa janë lëshuar 7 vendime për ndalim të shfrytëzimit dhe ndërprerje të pyjeve.

Janë parashtruar 3,933 fletëparaqitje prej të cilave 2,687 janë fletëparaqitje për kundërvajtje dhe 1,246 fletëparaqitje penale. Numri i lendeve të vendosura nga Gjykatat është 698, prej të cilave 546 për fletëparaqitje për kundërvajtje dhe 152 fletëparaqitje penale.

Janë hartuar plane menaxhuese për 24.577 ha.

Janë mbajtur dy trajnime me fermerë përdorues të pesticideve me dt, 08.10.2010 në regionin e Pejës me 20 fermerë, ndërsa me dt. 26.01.2011 në regionin e Gjilanit kanë qenë të pranishëm 50 fermer. Është bërë adaptimi i pyetësorëve të FADN-së në harmoni me standardet e BE-se si dhe ka filluar dizajnimi i softwerit për FADN dhe është bere publikimi i të dhënave për FADN për vitin 2010.

Siguria e Ushqimit dhe Veterinaria

Më 27 Janar 2011 është bërë konstituimi i bordit Drejtues dhe Shkencor të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë. Po ashtu me datën 05.11.2010, në mbledhjen e Rregullt të Qeverisë janë zgjedhur anëtarët e bordit drejtues të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë me nr 02/148. Gjithashtu më 05.11.2010 janë zgjedhur edhe anëtarët e Keshillit shkencor edhe Bordit shkencor të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë me nr 03/148 .

AUVK ka bërë draft rregulloren për organizimin e brendshëm për sistematizimin e vendeve të punës. Me këtë rregullore është përcaktuar struktura organizative e drejtorive të agjencive duke përfshirë edhe zyrat regjionale (pritet të nënshkruhet më 29.04.2011 nga krye shefi i AUVK).

Sa i përket regjistrimit, evidentimit dhe matrikulimit të kafshëve në tërë territorin e Kosovës gjatë kësaj periudhe janë matrikuluar ruminantet e vegjël dhe derrat, me ç'rast këto të dhëna janë duke u procesuar në bazën e të dhënave të sektorit I&R.

Duhet theksuar gjithashtu se ka përfunduar edhe fushata e ri-regjistrimit të pronave blegtorale dhe marrja e koordinatave gjeografike te rreth 92.000 pronave blegtorale. Po ashtu është realizuar edhe krijimi i webfaqes se sektorit te I&R te kafshëve ku, kjo webafaqe përveç qe është e paraparë për përdorim nga stafi i AUV -s, është parapare te përdoret edhe nga veterinaret e licencuar për qasje ne te dhënat ne komunave përkatëse.

3.2.3 Mjedisi

Në aspektin e plotësimit të kornizës ligjore, MMPH ka plotësuar kornizën e legjislacionit sekondar përmes miratimit të udhëzimeve administrative në vijim:

- Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2011, për procedurat e zhvillimit dhe miratimit të dokumenteve të referimit për teknikat më të mira të mundshme, i nënshkruar me datën 31.03.2011.
- Udhëzimi Administrativ Nr.02/2011, për administrimin e mbeturinave nga gypat fluoreshent që përmbajnë merkur, i nënshkruar me datën 31.03.2011.
- Udhëzimi Administrativ Nr.03/2011, për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e plotësimit të aplikacionit për leje të integruar, i nënshkruar me datën 31.03.2011
- Rregullorja Nr.04/2011, për mënyrën e llogaritjes së pagesës për kontrollin teknik të objekteve ndërtimore, e nënshkruar me datën 31.03.2011

Me anë të rregullores Nr. 04/2011 caktohen kriteret, detyrimet, bazat e llogaritjes dhe procedurat për pagesën e komisionit që bën kontrollin teknik të objekteve ndërtimore, për të cilat lejen ndërtimore e lëshon Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Po ashtu në kuadër të amandamentimit të legjislacionit sekondar, ZRRUM, ka aprovuar në muajin Mars, rregullën për Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve, ku ndër të tjera është definuar qartë roli i Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve si një organ i rëndësishëm për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve të shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave në Kosovë.

Në kuadër të intensifikimit të aktiviteteve për mbrojtje të mjedisit dhe planifikimit hapësinor me datën 31.03.2011 ministri i MMPH-së ka nënshkruar udhëzuesin për hartimin e programeve tre vjeçare komunale të banimit. Ky udhëzues është hartuar për të shërbyer si mjet ndihmës për komunat e Republikës së Kosovës gjatë hartimit të programeve tre vjeçare të banimit. Udhëzuesi shërben gjithashtu edhe si model për hartimin e këtyre programeve dhe iu mundëson komunave hartimin e programeve të cilat janë të realizueshme dhe që adresojnë siç duhet nevojat e banimit si dhe mundësitë që ekzistojnë në nivel komune dhe vendi.

Sa i përket procesit të ndërtimit të impianteve për sterilizimin e mbeturinave infektive, deri më tani janë ndërtuar dhe funksionalizuar 5 impiante; në Prishtinë, Mitrovicë, Prizren, Gjilan e Ferizaj. Pesë objektet e lartë përmendura janë pajisur me pajisje për sterilizimin e mbeturinave infektive spitalore. Janë funksionalizuar 2 impiante (Prishtinë e Mitrovicë), ndërkaq 3 impiantet e tjera janë në fazën e provës dhe lëshimit në punë të rregullt.

Për më tepër, në vazhden e angazhimeve për krijimin e rrjetit të monitorimit të cilësisë së ajrit janë caktuar dhe dakorduar 10 lokacione për vendosjen e stacioneve monitoruese të cilësisë së ajrit në këto komuna: Prishtinë (2), Pejë (1), Prizren (1), Gjakovë (1), Gjilan (1), Shtërpce (1), Mitrovicë (1), Drenas (1) dhe Hani i Elezit (1). Deri më tani janë vendosur 2 stacione dhe një pajisje mobile për caktimin e pikave monitoruese. Stacionet raportojnë për këta perimetra: SO₂, CO₂, O₃, NO₂, PM 10/pm 2.5 dhe gjithashtu parametrat meteorologjik.

Forcimi i inspektoratit është njëri nga objektivat kryesorë të MMPH-së për vitin 2011. Nga data 12 deri me 15 Prill 2011, është mbajtur trajnimi i 3 ditorë i organizuar nga RENA në bashkëpunim me MMPH-në.

Në këtë trajnim, i cili i është dedikuar teknikave të ndryshme të inspektimeve mjedisore, janë trajnuar 8 inspektor të profileve të ndryshme. Në periudhën Tetor 2010, Prill 2011 janë punësuar 3 inspektor të rinjë.

ZRRUM, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të saja operacionale, gjatë kësaj periudhe raportuese ka avancuar, procesin e përcaktimit të tarifave për shërbimet e ujësjetillësit dhe të ujërave të zeza, duke aprovuar dokumentin 'Politikat Tarifore për ujë dhe ujëra të zeza' në muajin Shkurt, si dhe 'Kalendarin Rregullator për përcaktimin e tarifave' në muajin Mars.

3.2.4. Politikat e Transportit

Sa i përket kompletimit të projektit zbatues të R7, ka përfunduar projekti zbatues për Segmentet 1-4 (Morinë - Qafa e Dules) si dhe është duke u hartuar studimi për korridorin alternativ të autostradës, segmentet 8-9 (Prishtinë Jug - Besi).

Me qëllim të përmirësimit të bazës së të dhënave rrugore, përkatësisht inventarizimit të rrugëve, procesi ka përfunduar në tri regjione të Kosovës, por pritet që nga maji 2011 të we 00+-fillohet edhe me katër rajonet e mbetura. Gjithashtu, baza e të dhënave rifreskohet në vazhdimësi.

Në frymën e vazhdimin të aktiviteteve për arritjen e marrëveshjeve bilaterale mbi transportin e udhëtareve dhe mallrave kanë filluar iniciativat me Kroacinë, Austrinë, Gjermanin, Italinë dhe me Bullgarinë.

Sa i përket implementimit të ligjit mbi transportin e mallrave të rrezikshme, është dhënë autorizim për certifikimin e automjeteve, dhe pritet fillimi i certifikimit të mjeteve të transportit të mallrave të rrezikshme.

Me qëllim të ngritjes së nivelit të kriterëve për licencim të të gjitha llojeve të transportit të udhëtarëve dhe mallrave, mallrave të rrezikshme dhe terminaleve të udhëtareve dhe mallrave është përfunduar Udhëzimi Administrativ për Licencimin e operatorëve të transportit të mallrave ndërsa lejet vazhdojnë të shkëmbehen në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve. Ndërsa sa i përket vendosjes së linjave në transportin e rregullt ndërkombëtar është duke vazhduar shkëmbimi i lejeve.

Me qëllim të ngritjes së vetëdijes sa i përket sigurisë rrugore, u janë shpërndarë broshura fëmijëve të disa shkollave fillore në komunat e Kosovës për sigurinë në komunikacionin rrugor si dhe është bërë një hulumtim përmes pyetësorit të disa shofer të automjeteve për shkaktarët e aksidentëve në komunikacionin rrugor.

Për më tepër, në kuadër të ngritjes së kapaciteteve profesionale, kanë filluar me trajnimet VISUM software për modelim.

3.2.5. Energjia

Në nëntor të vitit 2010 kanë hyrë në fuqi ligjet e sektorit të energjisë, respektivisht: Ligji për Energji Nr. 03/L-184, Ligji për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185 dhe Ligji për Energji Elektrike Nr. 03/L-201.

Në dhjetor 2010 me qëllim të kompletimit të Kornizës Rregullative, ZRrE-ja ka miratuar rregullat në vijim:

- Rregulla për krijimin e sistemit të certifikatave të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme, mbeturinat si dhe nga bashkëprodhimi i kombinuar me nxehtësinë, në një njësi të vetme gjeneruese.
- Rregulla për mbështetjen e energjisë elektrike për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës dhe Procedurat për praninë në Skemën Mbështetëse.

Në janar 2011 Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRrE) ka përcaktuar Standardet e kualitetit të furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike që të Licencuarit duhet ti plotësojnë.

Progresi në fushën e Eficiencës së Energjisë është në disa rrafshë; përmes një studimi janë identifikuar 41 vendndodhje të reja të hidrocentraleve të vogla, dhe gjithsej studimi përfshinë 77 hidrolokacione.

Gjatë periudhës 2010/2011, gjithsej 51 kandidatë nga komuna të ndryshme kanë dhënë provimin për auditim të energjisë.

Me bashkë-financim mes MZHE, Komunave dhe GIZ-it në dhjetor 2010 ka përfunduar faza e parë e projektit për ndriçimin publik eficient, në qytetet:

- Në Prishtinë janë zëvendësuar 300 trupa ndriçues të vjetër (me drita të zhivës 400 Watt) me trupa të reja ndriçues (me drita të natriumit 250 Watt) gjë që ka mundësuar një kursim rreth 35%.
- Në Prizren janë montuar 300 trupa ndriçues me led drita të fuqisë 28 Watt që korrespondon me një fuqi të dritës klasike të 125 Watt do të thotë një kursim rreth 70%.
- Në Gjilan është bërë ndërtimi i një trase të re rreth 1100 m 38 shtylla me trupa ndriçues me drita të Natriumit, zëvendësimi i trupave të vjetër ndriçues (poqe të zhivës) me trupa të reja ndriçues (poqe të Natriumit) 205 copë.

Sa i përket kapaciteteve gjeneruese nga BRE, ZRrE ka lëshuar këto autorizime:

- Dy gjenerator nga BRE-era (njëri është ndërtuar ndërsa tjetri është në proces të ndërtimit)
- Dy aplikacione për ndërtimin e gjeneratorëve të ri nga BRE-era (u janë lëshuar Autorizimet Fillestare)
- Një aplikacion për ndërtim të Hidrocentralit (i është lëshuar Autorizimi Fillestar)
- Një aplikacion për ndërtim të e Hidrocentralit (në proces të vlerësimit).
- Bordi i ZRrE-së ka miratuar Feed-in Tarifat për energjinë e prodhuar nga Era, Uji dhe Biogasi/Biomasa.

Në janar 2011 USAID ka furnizuar Institutin e Meteorologjisë (MMPH) me software për modelin e dispersionit të gazrave nga objektet industriale dhe është kryer trajnimi i personelit.

KOSTT duke synuar përmirësimin e cilësisë dhe ngritjen e kapaciteteve transmetuese dhe transformuese në Rrjetin e Transmisionit, ka ndërmarr aktivitetet përkatëse, prej të cilave brenda kësaj periudhe ka arritur të implementoj 90% të punëve të projektit

SCADA/EMS dhe Telekomunikacion & shërbimet konsulentë; janë realizuar testimet përkatëse të nenstacioneve 110 kV, janë instaluar pajisjet e SCADA/EMS në Qendrën Emergjente Kontrolluese.

Implementimi i Paket Projektit 400/110 kV Ferizaj 2: është projekt i ndarë në dy LOT-e, LOT1: Ndërtimi i NS 400/110 kV, brenda së cilit është aprovuar dizajni dhe kanë përfunduar punët fillestare ndërtimore, në total të shprehur në përqindje mund të konkludohet përfundimi i 20% të punëve të parapara brenda këtij LOT-i.

LOT2: Ndërtimi i linjave, kanë përfunduar 80% e punëve prej të cilave janë ndërtuar 4 nga 5 linjat 110kV dhe 2 linja 400 kV.

Sa i përket qëndrueshmërisë së shërbimit dhe furnizimit me energji elektrike KEK-u ka realizuar këto projekte përmes së cilave:

- Janë vendosur 9500 njehsor te konsumatorët me njehsor të dëmtuar dhe te konsumatorët pa njehsor, si dhe montimi i 600 grupeve matëse tek konsumatorët me matje gjysmë indirekte dhe në dalje 10 kV.
- Montimi i 526 njësive matëse në TS 10/0.4 kV për distriktin e Ferizajt, Drenasin dhe Prishtinën.
- Është bërë ndërrimi i 1500 grupeve matëse induktive të konsumatorëve industrial me ata elektronik multifunksional.
- Vendosja e 400 njësive matëse elektronike në të gjitha daljet Distributive 10 kV.
- Prej 10.000 njësive matëse elektronike te konsumatorët shtëpiak, të planifikuara për vitin 2011, në tremujorin e parë janë vendosur 3225 sish.
- Në krahasim me periudhën janar 2011 – mars 2011 me janar 2010 – mars 2010, në tre mujorin e parë të 2011 në faturim/energji në disponim për shitje, ka një rritje për **4,5%**, kurse në inkasim/faturim ka një rritje për **1.6%**.
- Të gjitha Hidrocentralet distributive të dhëna me koncesion janë lëshuar në punë dhe në tre mujorin e parë 2011 kanë prodhuar energji elektrike:

- HC Dikanc 1298635 kWh
- HC Radavci 803281 kWh
- HC Burimi 99940 kWh

Në fushën e bashkëpunimeve bilaterale, janë nënshkruar bashkëpunime (memorandume Mirëkuptimi) me Maqedoninë dhe Slloveninë.

3.2.6. Shoqëria Informativ dhe Media

Me qëllim të harmonizimit të tabelës së ndarjes dhe alokimit të frekuencave në përputhje me tabelën Evropiane të ndarjes, bordi i ART-së ka miratuar tabelën e shpërndarjes dhe shfrytëzimit të spektrit frekuencor të Kosovës (datë 01.02.2011, Vendimi Nr .62, Nr. prot. 006/B/11) dhe me 7 Prill, 2011 ka proceduar me dërgimin e tabelës kombëtare për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Në kuadër të aktiviteteve për përgatitjen dhe aprovimin e rregulloreve për krijimin e kushteve për konkurrencë efektive në treg, ART-ja ka miratuar rregulloret e mëposhtme;

- Rregulloren për sigurimin e qasjes (Reg. Nr. 6, Nr. Prot. 011/B/11 e fuqizuar me Vendimin Nr. 64 Nr. Prot. 008/B/11);
- Rregullorja për “ Analizën e tregut dhe definimim e ofruesve me fuqi të ndjeshme në treg”, datë 20/12/2010, (Nr.prot.115/1/10);

- Rregullorja për tarifimin e spektrit frekuencor, datë 25/10/2010, (Nr.prot.95/1/10);
- Aneksimin i Planit të Numeracionit, i datës 22/10/2010
- Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për Licenca dhe Autorizime, datë 03/03/2011, (Nr.prot.017/B/11) dhe
- Rregulloren për shthurjen e lakut lokal (eng. Local Loop Unbundling)/ Reg. 8, Nr. Prot. 021/B/11 e fuqizuar me Vendimin (Nr. 83, Nr. Prot. 020/B/11) si dhe

Me qëllim të zbatimit të politikave lidhur me rrjetet dhe shërbimet për komunikim elektronik, është finalizuar kompletimi i njëjës shkëmbyese të internetit (KOS-IXP) dhe gjatë muajit maj 2011 pritet që njëjës shkëmbyese e internetit të jetë plotësisht operacionale dhe ofroj shërbimet e saj.

Përveç këtyre, në lidhje me analizën e tregjeve në sektorin e komunikimeve elektronike, me 31 janar 2011 është formuar grupi punues për "Analizën e tregut dhe definimin e ofruesve me fuqi të ndjeshme në treg (OFNT)", kurse analiza e tregut ka filluar në muajin shkurt 2011 dhe pritet të përfundojë gjatë muajit shtator 2011.

3.2.7. Kontrolli Financiar

Në vazhdenë e zbatimit të Ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimin e Terrorizmit dhe Bartjen e kompetencave të FIC-it në NJIFK, Bordi Mbikëqyrës i Njësisë së Inteligjencës Financiare të Kosovës në takimin e vet të parë emëroj drejtorin e Njësisë së Inteligjencës Financiare të Kosovës.

Transferimi i stafit është në proces. Në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit bartja parashihet për 6 muaj pas aprovimit të ligjit. Ligji është aprovuar në nëntor të vitit 2010 dhe pritet bartja e plotë deri në Maj 2011.

Në kuadër të ngritjeve të kapaciteteve njerëzore janë mbajtur këto trajnime:

Trajnime auditorëve në PT&Ç: - 54 AB të trajnuar në Modulin ' Bazat e Auditimit të Brendshëm (20,09 - 01,10/2010); Moduli Nacional (25,10 -29,10/2010), Qeverisja dhe kontrolli (29,11-10,12/2010) si dhe mbajtja e provimeve dhe riprovimeve nga Moduli "Bazat e Auditimit të Brendshme" (22/10/2010 dhe 10/02/2011), "Moduli nacional "(18/11/2010 dhe 24/02/2011) dhe "Qeverisja dhe kontrolli "(11,01,2011) .

Trajnime tjera për 69 Auditor të Brendshëm: Përfundimi i 11 pilot auditimeve të mbikëqyra nga ekspertë ndërkombëtar (Janar - 4 Prill). Trajnimi i shtatë anëtarëve të NJQHAB me temën "Programi mbi kualitetin e cilësisë së AB" prej 21-25/03/2011 Prezantimi i " Rolit të Auditimit të Brendshëm" te zyrtarët financiar përmes projektit të USAIDIT/SHKAK (për 6 grupe të zyrtarëve financiar).

Në dhjetor të vitit 2010 është përgatitur Doracaku për menaxhimin e rrezikut" që përfshinë edhe listën e rreziqeve.

ZAP ka azhurnuar dhe funksionalizuar Strategjinë e Zhvillimit të Përbashkët (DATA), me anë të kësaj strategjie janë përcaktuar prioritetet për përmbushjen e misionit të ZAP-

se për të kontribuar në ngritjen e qeverisjes së mirë dhe në reformimin e administratës publike.

Deri në fund të muajit prill - raportet e poshtëshënuara të auditimit do të jenë publike (9 auditime të Rregullsisë; 2 auditime menaxheriale dhe 1 auditim i performances).

Më 15 Prill: Agjencia e Privatizimit (Auditim i Rregullsisë); Komisioni i Pavarur për Media (Auditim i Rregullsisë); Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit (Auditim i Rregullsisë); Zyra Rregullative për Ujë dhe Mbeturina (Auditim i Rregullsisë).

22 Prill: KEK-Importi i energjisë (Auditim i Menaxhimit) ; DANIDA Projekt i Arsimit (Auditim i Rregullsisë dhe Menaxhimit); Doganat (Auditimi i Rregullsisë)

29 Prill: Universiteti i Prishtinës (Auditim i Rregullsisë); Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës (Auditim i Rregullsisë); Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Auditim i Rregullsisë); Menaxhimi i pasurisë (Auditim i Performancës).

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve njerëzore, 3 punonjës janë bërë kontabilist të certifikuar dhe i janë nënshtruar procesit të licencimit për auditor. Janë realizuar gjithsej 1617 orë trajnime. Këtu përfshihen trajnimet nga SCAAK-u; trajnimet e brendshme rreth fushës së auditimit dhe legjislacionit. Për vitin 2011 vetëm 8 poste të auditoreve janë aprovuar nga Kuvendi i Kosovës.

Në shkurt të këtij viti është nënshkruar marrëveshja me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë me qëllim të krijimit të një bashkëpunimi institucional mes këtyre dy palëve. Bashkërisht tanimë kanë filluar adresimet e fushave në vijim: të Mësuarit e një auditimi të performancës; Asistencë për futjen në përdorim të Sistemit për Regjistrimin e Kohës.

3.2.8. Statistikat

Gjatë muajit Prill është bërë finalizimi i rezultateve dhe përgatitja e publikimit, ndërsa në Maj do të bëhet "publikimi i të dhënave për llogaritjet ekonomike bujqësore 2005-2008".

Nga muaji Shkurt zyrtari i statistikave ekonomike ka filluar trajnimin për regjistër të biznesit nga IPA Multi Beneficiary, që do të zgjatë deri në korrik 2011.

Regjistrimi i popullsisë ka filluar me 01 Prill dhe zgjat deri më 15 Prill 2011. Të gjithë udhëzuesit dhe pyetësorët sa i përket procesit të regjistrimit të popullsisë janë përfunduar, shtypur dhe shpërndarë. Janë rekrutuar dhe trajnuar instruktorët shtetëror, mbikëqyrësit, kontrollorët dhe regjistruerit. Janë rekrutuar 7000 punëtor në procesin e regjistrimit të popullsisë. Rezultatet preliminare të regjistrimit të popullsisë do të publikohen sipas komunave dhe nivel vendi më 30 qershor 2011. Të dhënat fillojnë të kodohen pas regjistrimit me 15 maj ndërsa fillojnë të futen në data bazë më 25 maj 2011.

Sa i përket statistikave biznesore dhe makroekonomike janë publikuar: ICK (Indeksi i çmimit të konsumit) shkurt 2011, STJ (Statistikat e tregtisë së jashtme) Janar 2011, Bilanci i energjisë TM4 (Tre mujori i katërt) 2010 ICIMP (Indeksi i çmimit të importit), TM4 (Tre mujori i katërt) 2010 dhe ICP (Indeksi i çmimit të prodhimit) TM4 2010.

3.3. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA

3.3.1. Vizat, kufijtë, azili dhe migrimi

Sa i përket kornizës ligjore dhe të politikave në fushën e Menaxhimit të Integruar të Kufirit, përfshirë kornizën procedurale zbatuese, janë krijuar Grupet e Përbashkëta Punuese PKK-DK-AUV për hartimin e tri PSO-ve të Përbashkëta të cilat pritet të hyjnë në fuqi në mesin e majit 2011:

1. PSO për Qendrën Kombëtare për Kontroll të Kufirit
2. PSO-së për Shfrytëzimin e Pajisjeve të Përbashkëta,
3. PSO-së për Aktivitetet e Përbashkëta.

Më tej, DK ka rishikuar shumicën e PSO-ve të Drejtorisë së Zbatimit të Ligjit (për inteligjencë, hetuesi, analizë të riskut, të drejtën e pronësisë intelektuale) për zbatimin e Kodit Doganor dhe të Akcizës dhe ligjeve në fuqi dhe ka miratuar 11 UA për zbatimin e këtij kodi. Sa i përket kornizës së politikave, në prill 2011 është miratuar Doracaku i Përbashkët për Komunikim (PK - DK - AUV).

Më 14 janar 2011 të tri agjencitë e MIK-ut janë dakorduar mbi bashkërendimi i aktiviteteve në kuadër të MIK-ut për vitin 2011, siç është paraparë me Strategjinë dhe PV për MIK, kurse Sektori i MIK-ut në DK ka përpiluar planin e aktiviteteve për vitin 2011 që mbulon komponentin e çështjeve doganore.

Më 14 janar 2011 të tri agjencitë e MIK-ut janë dakorduar mbi bashkërendimi i aktiviteteve në kuadër të MIK-ut për vitin 2011, bazuar në Strategjinë dhe PV për MIK, kurse Sektori i MIK-ut në DK ka përpiluar planin e aktiviteteve për vitin 2011 që mbulon komponentin e çështjeve doganore.

Me qëllim të avancimit të kontrollit të përbashkët të kufirit me autoritetet homologe të shteteve fqinje, më 1 prill 2011, Ministrat e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës dhe të Maqedonisë kanë nënshkruar marrëveshjen për patrullime të përbashkëta në vijën kufitare, e cila gjithashtu parasheh qarkullimin e shtetasve të të dyja vendeve vetëm me letërnjoftime. Gjithashtu në prill është nënshkruar dhe ka hyrë në fuqi Protokollin i përbashkët Kosovë - Maqedoni për patrullim të sinkronizuar të kufirit. Sa u përket planeve për patrullim të sinkronizuar të vijës kufitare, gjatë periudhës raportuese ka vazhduar realizimi i planeve javore (nga katër në muaj) me homologët e Shqipërisë, kurse me homologët e Maqedonisë janë realizuar nga tri të tilla.

Gjatë periudhës raportuese gjithashtu është shënuar përparim sa i përket bashkëpunimit me agjencitë homologe të vendeve fqinje në kuadër të shtyllës së tretë të MIK-ut, përkatësisht atij doganor, me nënshkrimin e dy marrëveshjeve bilaterale: me Maqedoninë (1 tetor 2010) dhe me Shqipërinë (11 janar 2011, mbi shkëmbimin elektronik të të dhënave në para-ardhje). Gjithashtu më 11 shkurt 2011 është nënshkruar Marrëveshja Bilaterale për ndihmë reciproke në çështje doganore me Doganën e Maqedonisë. Ky lloj bashkëpunimi ka vijuar gjatë periudhës raportuese përmes takimeve të rregullta javore në nivel teknik, si dhe atyre në nivel menaxherial. Në anën

tjetër, me qëllim të përmirësimit të bashkëpunimit ndër-institucional brenda vendit, gjatë periudhës raportuese Dogana ka nënshkruar dy marrëveshje mirëkuptimi: me Agjencinë Kosovare të Inteligjencës (më 17 janar 2011) dhe me Prokurorinë e Shtetit (më 21 janar 2011).

Sa i përket *avancimit të kapaciteteve institucionale dhe teknike në fushën e MIK-ut*, në fund të janarit 2011 Drejtori i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës ka miratuar Strukturën e rishikuar Organizative të saj, në kuadër të së cilës Sektori i MIK-ut është avancuar në nivel të Departamentit në kuadër të Drejtorisë së Operimeve dhe të Hyrave. Së shpejti pritet plotësimi i stafit menaxherial të këtij Departamenti të ri, përkatësisht i shefit të tij. Më tej, në kontekstin e marrjes së përgjegjësisë për mbikëqyrjen e vijës kufitare me Maqedoninë, Policia Kufitare ka rekrutuar edhe 120 zyrtarë policorë.

Gjithashtu janë mbajtur *trajnime* për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit sipas konceptit të MIK-ut për 240 zyrtarë policorë. Më tej, me përkrahjen e IOM-it, më 25 dhe 27 janar 2011 në Prishtinë është mbajtur një Trajnim i përbashkët treditor për Trajnerë (ToT) mbi analizën e riskut, ku kanë marrë pjesë 3 zyrtarë policorë të Policisë Kufitare, 3 të DK-së dhe 2 të AUV-it. Më tej, nga 17 janar deri më 17 shkurt 2011 në QKSPEZH është mbajtur një trajnim i përbashkët i nivelit të lartë ekzekutiv, ku kanë marrë pjesë 11 menaxherë të lartë të PK-së, 6 të DK-së dhe 3 të QKSPEZH-së.

Më 14 - 15 tetor 2010 është mbajtur seminari me temën *Përmirësimi i MIK-ut në Kosovë: bashkëpunimi ndërmjet agjencive që dërgon drejt një pike të vetme të kontrollit*, organizuar nga projekti i Binjakëzimit të fokusuar në asistencë DSHAM-it, i cili është fokusuar në praktikat më të mira evropiane në aspektet e policisë, doganës dhe fito-sanitarisë në kuadër të MIK-ut dhe në të cilin kanë marrë pjesë të tri agjencitë e MIK-ut.

Më 22 - 23 nëntor 2010, në Prishtinë të tri agjencitë e MIK-ut kanë marrë pjesë (me nga 6 pjesëmarrës) në punëtorinë *Fuqizimi i MIK në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi*, të organizuar nga IOM.

Më 27 tetor 2010, Sektori i MIK-ut i DK-së ka mbajtur një punëtori për stafin e EULEX-it me temën *Menaxhimi i Integruar i Kufirit* (me fokus në bazën ligjore, shtyllat e bashkëpunimit dhe organizimin), në kuadër të ciklit të trajnimeve *Trajnimet në vendin e punës për Doganën e EULEX-it*.

Marrë në përgjithësi, gjatë periudhës tetor 2010 - mars 2011, janë trajnuar 263 oficerë doganorë mbi fushën e MIK-ut dhe fusha të tjera të doganës.

Më tej, Zyra e Koordinatorit Nacional për MIK ka hartuar raporte të rregullta dymujore mbi implementimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për MIK, të cilat i janë dërguar Koordinatorit të Strategjive dhe drejtorëve të të tri agjencive të MIK-ut. Gjithashtu Grupi i përbashkët Punues për Analizë të Riskut ka hartuar Analizën e Vlerësimit të Riskut për tremujorin e fundit të vitit 2010.

Përveç këtyre, gjatë periudhës nëntor - dhjetor 2010 janë zhvilluar vizita të përbashkëta DK - PK në 11 pika të kalimit kufitar, rezultati i të cilave është një raport të përbashkët (DK, PK, AUV, EULEX, EU-CTA) me rekomandime për secilën agjenci të MIK-ut me qëllim të përmirësimit të kontrollit kufitar dhe implementimit të legjislacionit e të politikave për MIK përmes ofrimit të pajisjeve shtesë teknologjike dhe trajnimeve. Më 11

shkurt 2011, DK ka bërë një prezantim para agjencive të tjera të MIK-ut mbi mundësitë e fillimit të analizës së riskut për trafikun e udhëtarëve.

Sa i përket demarkacionit të vijës kufitare me Republikën e Malit të Zi, është formuar Komisioni përkatës Shtetëror dhe procesi i demarkacionit pritet të fillojë së shpejti.

Gjatë periudhës raportuese procesi i transferimit të përgjegjësisë për mbikëqyrjen e kufirit me Republikën e Maqedonisë nga KFOR-i te PK ka ecur sipas planit: më 22 janar 2011 ka përfunduar transferimi i sektorit të parë, kurse më 19 mars 2011 ai i sektorit të dytë. Ky proces është planifikuar të përfundojë në qershor 2011, me përfundimin e transferimit të sektorit të tretë.

Në nivelin e *infrastrukturës teknologjike*, deri më tani sistemi BMS është instaluar në të gjitha Pikat e Kalimit Kufitar, si dhe është bërë testimi i tij, me ç'rast janë gjetur 72 meta/zbrazësi, të cilat kanë filluar të adresohen nga kompania e kontraktuar (ASECO), e pas adresimit të tyre do të ri-testohet ky sistem. Sistemi BMS është i lidhur me bazën e të dhënave të regjistrimit të automjeteve. Gjithashtu në 11 pika të kalimit kufitar janë vendosur sistemi i kontrollit të dokumenteve "Visotec 6000". Sa i përket avancimit të kapaciteteve teknologjike të Doganës, më 12 dhjetor 2010 në Intranetin e DK-së janë instaluar dy kurse *online*, donacion i KE-së, të cilat përcjellin praktikat më të mira të BE-së dhe i udhëzojnë oficerët doganorë mbi kontrollimin sa më efikas të automjeteve dhe kontejnerëve me qëllim të kërkimit të mallrave të kontrabanduara. Më tej, DK ka filluar me zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Përbashkët Përmbledhës (DK, PK, AUV, EULEX, EUCTA) me shtrirjen e sistemit të TI-së në pikat kufitare Qafë Morinë dhe Qafë Prush.

Sa i përket përmirësimit të infrastrukturës fizike, në PKK Vërmicë janë ndërtuar 2 shtëpiza të reja dhe është vendosur sistemi i ndalimit me forcë të automjeteve ('iriqët'). Përveç kësaj, gjatë periudhës raportuese Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendim për themelimin e Pikës së Re të Kalimit Kufitar (të kategorisë A) me Republikën e Maqedonisë, në vendin Stançiç. Më 20 tetor 2010 në pikën e kalimit të kufirit në Vërmicë është realizuar plani i përbashkët operativ i koduar "Kontrolli i rreptë", ku kanë marrë pjesë njësi relevante të PK-së, DK-së dhe AUV-it. Qëllimi i këtij plani operativ ishte parandalimi i krimin të organizuar, imigrimit ilegal, kontrabandës, etj.

Me qëllim të kompletimit dhe avancimit të *kornizës ligjore dhe të politikave në fushën e ripranimit dhe ri-integrimit të personave të riatdhesuar*, gjatë periudhës raportuese janë finalizuar negociatat për arritjen e marrëveshjeve bilaterale të ripranimit me Republikën Çeke, Holandën, Luksemburgun dhe Slloveninë, kurse negociatat për marrëveshje të tilla kanë nisur me Kroacinë, Hungarinë dhe Suedinë.

Sa i përket *ngritjes së kapaciteteve institucionale* në këtë fushë, përveç alokimit të €3,420,150 nga buxheti i vitit 2011 (miratuar nga Kuvendi më 31 mars 2011) në Programin për Ri-integrim të personave të riatdhesuar, është funksionalizuar Zyra për Ripranim në kuadër të DSHAM-it dhe Zyra Pritëse për personat e riatdhesuar në Aeroportin e Prishtinës. Gjithashtu në prill është finalizuar raporti vlerësues mbi implementimin e Strategjisë dhe PV për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar gjatë tremujorit të parë 2011.

Në këtë kontekst, gjatë periudhës raportuese është shpërndarë nëpër të gjitha komunat dhe në institucionet qendrore Udhëzuesi për Ri-integrim, i cili shërben për informimin e

personave të riatdhesuar mbi shërbimet publike të cilat kanë të drejtë t'i gëzojnë dhe mënyrat e qasjes në këto shërbime. Përveç kësaj, është finalizuar dhe shpërndarë në të gjitha Komunat një Udhëzues për Zyrtarët Komunalë për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar (të njëjtit gjithashtu janë publikuar në ueb-faqen e MPB-së).

Sa u përket *trajnimeve*, gjatë shkurtit dhe marsit 2011 janë mbajtur pesë (5) punëtori me Komunat, me qëllim të informimit të zyrtarëve relevantë mbi përmbajtjen dhe implementimin e kornizës ligjore dhe të politikave që mbulon të gjitha aspektet e ri-integrimit të personave të riatdhesuar. Në këto punëtori kanë marrë pjesë drejtorët dhe përfaqësuesit e zyrave komunale relevante për ri-integrimin e personave të riatdhesuar (nga Drejtoritë e Arsimit, Shëndetësisë, Kadastrës, Rinisë, si dhe Zyrat e Komuniteteve dhe Kthimit, ato që merren me projekte dhe koordinim të donatorëve, e Njësive të Drejtave të Njeriut, si dhe të Qendrave Komunale për Punë dhe Mirëqenie Sociale) të të gjitha Komunave. Në vijim të masave për ngritjen e kapaciteteve të komunave për këtë proces, nga janari deri më 15 prill është mbajtur Trajnimi për Trajnerë (ToT), në të cilin kanë marrë pjesë dhe janë certifikuar 16 zyrtarë të ministrive anëtarë të Bordit Ekzekutiv për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar, dhe të cilët do të jenë përgjegjës për trajnimin e zyrtarëve relevantë të Komunave mbi kornizën ligjore dhe të politikave për ri-integrimin e personave të riatdhesuar dhe implementimin e saj.

Në ndërkohë, tashmë janë përgatitur materialet trajnuese dhe një orar i mbajtjes së trajnimeve me secilën Komunë, të cilat do të mbahen më nga 18 prill deri në 4 maj 2011. Këto dhe objektiva të tjera kyçe për tremujorin në vijim janë diskutuar dhe dakorduar me Zyrat Komunale për Kthim dhe Komunitete dhe me Kryetarët e Komunave në takimet e mbajtura më 4 dhe 7 prill 2011, i pari me ZKKK-të dhe i fundit me Kryetarët e Komunave. Në takimin me ZKKK-të kanë marrë pjesë Ministria e Integritit Evropian, ai i Punëve të Brendshme dhe ai i Administrimit të Pushtetit Lokal, kurse takimin me Kryetarët e Komunave e ka zhvilluar Kryeministri, me pjesëmarrjen e Ministrave relevantë (MIE, MPB, MAPL, MPMS, MASHT, MSH dhe MMPH) dhe Zv. Drejtori i AKP-së. Në të dyja takimet përfaqësuesit e Komunave janë njoftuar mbi përmbajtjen dhe implementimin e kornizës ligjore dhe të politikave që mbulon të gjitha aspektet e ri-integrimit të personave të riatdhesuar, dhe janë dakorduar 11 prioritete për ngritjen e kapaciteteve të Komunave për ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar.

Në këtë kontekst, në prill 2011 grupi punues ka miratuar Termat të Referencës dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës të ZKKK-ve (bazuar në një plan të aktiviteteve dhe një grup punues, të hartuar dhe bashkë-kryesuar nga ZÇK/ZKM dhe MKK, dhe me pjesëmarrjen e ministrive relevante), të cilat pritet të miratohen së shpejti nga Qeveria.

Me qëllim të *vendosjes së politikës së vizave të Republikës së Kosovës dhe kompletimit të kornizës ligjore për zbatimin e saj*, më 2 mars 2011 Qeveria ka marrë vendim për të iniciuar procedurën e hartimit të politikave për vendosjen e regjimit të vizave në Republikën e Kosovës, në bazë të së cilit MPJ si institucion ka formuar grupit punues përkatës.

Në nivelin e akteve nënligjore, gjatë periudhës raportuese është miratuar UA nr. 04/2010 mbi Procedurat e Lëshimit të Vizave për të Huajt nga Misionet Konsullore të Republikës së Kosovës. Sa i përket *ngritjes së kapaciteteve institucionale* për zbatimin e legjislacionit dhe të politikave në këtë fushë, deri gjatë periudhës raportuese janë mbajtur gjithsej 13 trajnime.

Sa i përket kompletimit të kornizës dhe ngritjes së kapaciteteve institucionale në fushën e regjistrave civilë dhe sigurisë së dokumenteve, përveç Zyrës së Regjistrimit Civil në pjesën veriore të Mitrovicës, deri më tani janë themeluar dhe janë funksionale edhe Zyrat Komunale të Regjistrimit Civil në Mamushë, Graçanicë, Partesh dhe Novobërdë. Më tej, deri më tani janë lidhur në Internet pjesa dërrmuese e Zyrave Komunale të Gjendjes Civile, përveç pesë prej tyre, të cilat përballen me pengesa në rrjet për shkak të konfiguracionit të terrenit. Gjithashtu deri më tani është kryer skanimi i regjistrave të gjendjes civile në 21 komuna, kurse në proces është në 17 komunat e mbetura.

Nga ana tjetër, më 30 nëntor 2010 ka hyrë në fuqi Udhëzuesi për personat të cilët kërkojnë Azil në Republikën e Kosovës, i cili rregullon edhe zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve të azilkërkuesve. Më tej, më 29 mars 2011 janë finalizuar dhe prezantuar termat e referencës për Sistemin e Menaxhimit të Informatave në DSHAM, me synim dizajnimin e një sistemi të përshtatshëm për menaxhimin e informatave dhe, përmes kësaj, përmirësimit të operimit të DSHAM-it përmes automatizimit të mbledhjes së informatave në kuadër të këtij departamenti. Gjithashtu është zhvilluar dhe është në përdorim formulari standard për regjistrimin e të huajve që hynë në territorin e Kosovës.

Sa u përket trajnimeve, gjatë periudhës raportuese janë mbajtur katër (4) prej tyre:

1. Trajnimi për Trajnerë (ToT) mbi *Ri-integrimin e personave të riatdhesuar* (më 17 - 21 janar 2011, 16 pjesëmarrës;
2. Trajnimi mbi *Statistikat e Migracionit* (9 - 10 shkurt 2011), 13 pjesëmarrës;
3. Trajnimi mbi *Migracionin ndërkombëtar dhe migracionin e ligjshëm në përputhje me Deklaratën e Pragës* (21 - 24 shkurt 2011), 25 pjesëmarrës;
4. Trajnimi për Trajnerë (ToT) mbi *Sigurinë e dokumenteve* (21 - 25 shkurt 2011), 1 pjesëmarrës nga DSHAM.

Tabela 100 - Të dhënat mbi kontrollin e personave dhe automjeteve në kufi (tetor 2010 - prill 2011)*

	AUTOMJETE	PERSONA
GJITHSEJ	1,587,657	3,830,124

Tabela 111 - Të dhënat mbi shfrytëzimin e Fondit për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar gjatë periudhës raportuese (tetor 2010 - prill 2011)

NR	NUMRI I PERSONAVE PER SECILËN KATEGORI	JANAR 2011	SHKURT 2011	MARS 2011	GJITHSEJ
1	Numri i personave të strehuar përkohësisht	6	8	4 anëtarë të familjes	18
2	Numri i ditëve të strehimit (personat akoma janë të strehuar)	105	87		192
3	Numri i	0	11	5	16

	personave të transportuar në destinacione të kërkuara								
4	Numri i kërkesave individuale dhe familjare për përkrahje nga Fondi për Ri-integrim	Individuale	Familjare	Individuale	Familjare	Individuale	Familjare	Individuale	Familjare
		5	1	12	2	0	0	17	3
5	Numri i anëtarëve të familjeve	24		52		0		76	
6	Numri i kërkesave individuale dhe familjare të miratuara për përkrahje nga Fondi për Ri-integrim	Individuale	Familjare	Individuale	Familjare	Individuale	Familjare	Individuale	Familjare
		5	1	4	0	0	0	9	1
7	Shuma e mjeteve financiare të miratuara për përkrahje nga Fondi për Ri-integrim (për raste familjare dhe individuale)	Familjare	Individuale	Familjare	Individuale	Familjare	Individuale	Familjare	Individuale
		€9,093.77	€755	€7,470.95	€0.00	€0.00	€0.00	€16,564.72	€755
8	Numri i kërkesave familjare dhe individuale për verifikim	Familjare	Individuale	Familjare	Individuale	Familjare	Individuale	Familjare	Individuale
		0	0	6	2	0	0	6	2
9	Numri i anëtarëve të familjes			0		28		28	
10	Numri i kërkesave individuale dhe familjare të refuzuara*	Individuale	Familjare	Individuale	Familjare	Individuale	Familjare	Individuale	Familjare
		0	0	2	0	0	0	2	0

* Kërkesat e refuzuara janë dorëzuar nga persona të riatdhesuar të cilët janë larguar nga Kosova pas 17 shkurtit 2008, dhe të cilët, bazuar në kriteret për përfitim nga Fondi për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar, nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga ky Fond.

Tabela 122 - Të dhënat mbi azilkërkuesit (2009 - 2011)*

NR.	NUMRI I PERSONAVE PËR SECILËN KATEGORI	2009		2010		2011		GJITHSEJ	
1	Numri i gjithëmbarsëm i azilkërkuesve	31		267		96		394	
2	Mënyra e hyrjes (legale / ilegale)	Legale	Ilegale	Legale	Ilegale	Legale	Ilegale	Legale	Ilegale

		11	20	55	212	2	94	68	326
3	Numri i azilkerkuesve sipas kontinenteve	Afrikë	3	59	6	68			
		Azi	27	205	90	322			
		Evropë	1	3	0	4			
4	Numri i azilkerkuesve sipas gjinisë	M	F	M	F	M	F	M	F
		1	30	28	239	14	82	43	351
TË DHËNAT SIPAS STATUSIT TË VENDIMEVE									
5	Numri i rasteve të mbyllura me ndërprerje të procedurës (34.vi)**	29	209	43	281				
6	Numri i kërkesave të tërhequra nga ana e azilkerkuesve (34.i) **	1	11	0	12				
7	Numri i vendimeve negative (27, 28)**	1	25	3	29				
8	Numri i rasteve në procedurë e sipër	0	22	50	72				
TË DHËNAT MBI ANKESAT DHE LETËRNJOFTIMET									
9	Numri i ankesave të shkallës së parë	0	3	2	5				
10	Numri i letërnjoftimeve të dhëna (50.ii)	0	69	87	156				

* Nuk ka asnjë rast gjyqësor

** Në pikat 5, 6, 7 dhe 9, në kllapa janë dhënë nenet përkatëse të Ligjit mbi Azilin

3.3.2. Pastrimi i Parave

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve institucionale për parandalimin dhe luftimin e krimeve financiare, është themeluar dhe funksionalizuar Bordi Mbikëqyrës i Njesisë së Inteligjencës Financiare. Në mbledhjen e tij të parë Bordi ka emëruar Drejtorin e kësaj njësie.

Tabela 133 - Të dhënat mbi luftimin e krimeve ekonomike dhe korrupsionit gjatë periudhës raportuese (tetor 2010 – mars 2011)

	NR. I RASTEVE	NR. I RASTEVE ME KRYERËS TË NJOHUR DËRGUAR PROKURORISË	NR. I TË ARRESTUARA VE	NR. I PADIVE PENALE	NR. I RAPORTEVE SPECIALE DËRGUAR PROKURORISË	VLERA E PËRAFERT E DËMEVE
Tetor 2010	79	27	5	22	15	€ 593,000.00
Nëntor 2010	59	21	9	31	22	
Dhjetor 2010	73	35	7	37	14	€ 415,900.00
Janar 2011	79	19	5	29	5	€ 32,000.00
Shkurt 2011	93	37	4	29	31	€2,619,441.00
Mars 2011	120	65	6	124	33	€ 114,960.00
Prill 2011*	62	28	2	42	13	€ 676,509.00
GJITHSEJ	565	232	38	314	128	€4,451,810.00

* Deri më 20 prill 2011

3.3.3. Policia dhe Luftimi i Krimit të Organizuar

Sa i përket parandalimit dhe luftimit të trafikimit dhe abuzimit me narkotikë, më 20 dhjetor 2010 Ministri i Shëndetësisë ka miratuar UA nr. 10/2010 mbi Përdorimin e Metadonit. Në nivelin e procedurave, kanë hyrë në fuqi Përshkrimet e Vendeve të Punës së zyrtarëve të Drejtorisë së PK-së për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë, kurse në proces është rekrutimi i 47 zyrtarëve policorë në kuadër të tij. Gjithashtu është hartuar raporti dymujor mbi implementimin e Strategjisë dhe PV kundër Drogave. Në nivelin e trajnimeve, gjatë periudhës raportuese janë mbajtur dy trajnime, ku kanë marrë pjesë 22 zyrtarë policorë. Trajnimi i parë, mbi *Teknikat e intervistimit dhe marrjes në pyetje*, është

mbajtur nga 14 deri më 25 shkurt 2011, ku kanë marrë pjesë zyrtarë hetues të PK-së, ndërsa trajnimi i dytë, mbi *Hetimet ndërkombëtare dhe dërgesat e kontrolluara*, mbajtur nga 22 shkurt deri më 10 mars 2011, ku kanë marrë pjesë zyrtarë të Drejtorisë kundër Drogave.

Përveç këtyre, sa i përket *ngritjes së kapaciteteve institucionale* për hetimin e krimit, gjatë periudhës raportuese ka vazhduar implementimi i Strategjisë dhe PV mbi Policinë e Udhëhequr nga Inteligjenca dhe është hartuar një raport mbi implementimin e këtij dokumenti strategjik. Sa u përket trajnimeve, gjatë kësaj periudhe janë mbajtur pesë (5) trajnime, ku kanë marrë pjesë 49 zyrtarë policorë:

1. Trajnimi mbi *Policinë e udhëhequr nga inteligjenca* (më 1 - 2 shkurt 2011 dhe 3 - 4 mars 2011);
2. *Kursi i avancuar për hetimin e krimit* (më 31 janar - 18 shkurt 2011)
3. *Kursi bazik për hetime penale* (më 10 janar - 4 shkurt 2011);
4. *Kursi i inteligjencës* (më 21 - 25 shkurt 2011); dhe
5. Trajnimi i avancuar mbi *Hetimet dhe intervistimin në fushën e terrorizmit* (më 21 - 25 shkurt 2011).

Një përparim të rëndësishëm përbën edhe finalizimi i Planit të Veprimit për Veriun e Kosovës nga Dogana e Kosovës.

Sa i përket *ngritjes së kapaciteteve institucionale për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore*, gjatë periudhës raportuese janë mbajtur dy trajnime:

1. Trajnimi mbi *Teknikat e intervistimit dhe marrjes në pyetje* (më 14 - 25 shkurt 2011), 4 pjesëmarrës nga Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore; dhe
2. Trajnimi i avancuar mbi *Intervistimin në fushën e terrorizmit* (më 21 - 25 shkurt 2011), 8 zyrtarë policorë të Shtyllës së Hetimeve.

Në aspektin e kapaciteteve teknike, baza e të dhënave për viktimave të trafikimit është funksionalizuar, e cila gjendet nën përgjegjësi të Koordinatorit Nacional Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore.

Gjatë periudhës raportuese gjithashtu janë funksionalizuar Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi në Komunat e reja të Novobërdës, Klllokotit, Junikut, Mamushës, Graçanicës dhe Ranillugut.

Sa i përket *sigurisë publike*, gjatë periudhës raportuese ka përfunduar zhvillimi i Bazës së të Dhënave të TI-së për Eksplozivë, e cila është instaluar dhe aktualisht po kalon në fazën testuese para funksionalizimit të plotë të saj. Në anën tjetër, edhe Baza e të Dhënave të TI-së për Armët e Zjarrit është instaluar dhe pritet të funksionalizohet, gjë që do të bëhet pas nënshkrimit të një marrëveshjeje bashkëpunimi mbi këtë në mes të MPB-së dhe MTI-së.

Tabela 144 - Të dhënat mbi kundëroajtjet gjatë periudhës raportuese - të gjithëmbarshme (tetor 2010 - prill 2011)

	MOSBINDJE NDAJ URDHRAVE TË PERSONIT ZYRTAR	PENGIMI KRYERJES SË DETYRËS ZYRTARE	PRISHJE E RËNDIT DHE QETËSISË PUBLIKE	KEOPËRDORIM DOKUMENTESH	VJEDHJE PYJESH	QËNDRIM ILEGAL	SHKELJE NË KOMUNIKACION	TË TJERA - DËBIME	GJITHSEJ
Tetor 2010	16	43	256	12	52	42	24259	6	24686

Nëntor 2010	18	34	196	9	27	38	19608	19	19949
Dhjetor 2010	10	33	166	10	24	20	14069	10	14342
Janar 2011	15	34	201	7	46	20	25286	18	25627
Shkurt 2011	17	31	204	4	47	48	23614	21	23986
GJITHSEJ	76	175	1023	42	196	168	106836	74	108590

Tabela 155 - Të dhënat mbi kundërvajtjet gjatë periudhës raportuese - pjesa e Policisë Kufitare (tetor 2010 - prill 2011)

	MOSBINDJE INDAJ URDHRAVE TË PERSONIT ZYRTAR	PENGIMI KRYERJES SË DETYRËS ZYRTARE	PRISHJE E RENDIT DHE QETËSISË PUBLIKE	KEOPËRDORIM DOKUMENTESH	VJEDHJE PYJESH	QËNDRIM ILEGAL	SHKELJE NË KOMUNIKACION- TIKETA	TË TJERA - DEBIME	GJITHSEJ
Tetor 2010	2	2	0	12	1	42	122	6	187
Nëntor 2010	1	3	1	9	2	38	101	19	174
Dhjetor 2010	2	1	1	10	0	20	1	10	45
Janar 2011	1	8	0	7	6	20	42	18	102
Shkurt 2011	1	0	1	4	3	48	133	21	211
GJITHSEJ	7	14	3	42	12	168	399	74	719

Tabela 166 - Të dhënat mbi luftimin e drogave gjatë periudhës raportuese (tetor 2010 - prill 2011)*

	NUMRI I RASTEVE	NUMRI TË ARRESTUARVE	NUMRI TË PARABURGOSURVE	NDARJA SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE			NDARJA SIPAS GJINISË		NUMRI I OPERACIONEVE	TRAFIKIM	POSEDIM	KULTIVIM	TË TJERA
				SHOIPTARË	SERBE	TË TJERË	MESHKUJ	FEMRA					
Tetor 2010	28	44	31	42	0	2	42	2	10	12	14	0	2
Nëntor 2010	12	16	9	16	0	0	16	0	5	4	8	0	0
Dhjetor 2010	14	22	7	21	1	0	22	0	8	2	12	0	0
Janar 2011	18	28	14	25	0	3	27	1	12	5	12	0	1
Shkurt 2011	26	34	16	34	0	0	33	1	8	10	15	0	1
Mars 2011	24	46	15	44	2	0	45	1	13	9	11	0	4
Prill*	14	21	16	20	0	1	20	1	7	5	8	0	1
GJITHSEJ	136	211	108	202	3	6	205	6	63	47	80	0	9

* Deri me 20 prill 2011

Tabela 177 - Të dhënat mbi sasinë (në gram) e narkotikëve të konfiskuar gjatë periudhës raportuese (tetor 2010 - prill 2011)

	HEROINE	MARIHUANË	HASHASH	KOKAINE	FIJE KANABISI	ECSTASY	DROGA TË TJERA
Tetor 2010	30338.66	213.23	0	45.96	26	0	25
Nëntor 2010	3010.7	5695.35	0	0	1	0	0
Dhjetor 2010	1101	1779.25	0	0	0	0	0
Janar 2011	6500	9830.22	0	0	0	691	0
Shkurt 2011	42.26	23249.17	0	0	0	0	0
Mars 2011	8841.24	5338.31	0	2228	0	0	0
Prill 2011*	1501.58	761.5	0	38.5	0	0	3065
GJITHSEJ	51335.44	46867.03	0	2312.46	27	691	3090

* Deri me 20 prill 2011

Tabela 188 - Të dhënat mbi luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore gjatë periudhës raportuese (tetor 2010 - prill 2011)

	Nr. i RASTEVE	Nr. i RASTEVE ME KRYERËS TË NJOHUR DËRGUAR PROKURORISË	Nr. i TË ARRESTUARA VE	Nr. i PADIVE PENALE	Nr. i RAPORTEVE SPECIALE DËRGUAR PROKURORISË	Nr. i VIKTIMAVE TË IDENTIKUARA	Nr. i LOKACIONEVE TË BASTISURA
Tetor 2010	5	4	8	4	1	4	53
Nëntor 2010	2	2	10	2	0	6	37
Dhjetor 2010	3	3	13	0	0	4	39
Janar 2011	6	6	18	6	0	5	35
Shkurt 2011	3	3	17	3	0	3	38
Mars 2011	6	6	16	6	0	1	82
Prill 2011*	2	2	4	2	0	1	25
GJITHSEJ	27	26	86	23	1	24	309

* Deri me 20 prill 2011

Tabela 199 - Të dhënat mbi luftimin e llojeve të tjera të krimit ndërkufitar gjatë periudhës raportuese (tetor 2010 - prill 2011)*

	FALSIKIM DOKUMENTESH	KALIME ILEGALE TË KUFIRIT	TRAFIKIM MALLRASH	PRERJE ILEGALE E DRUVE	POSEDIM DHE TRANSPORT ILEGAL I ARMEVE	VJEDHJE	KEPËRDORIM I DETYRËS ZYRTARE	KONTRABAND E ME MIGRANTË	POSEDIM MARKOTIKESH	TË TJERA	GJITHSEJ
Tetor 2010	28	8	14	5	9	2	0	3	2	14	85
Nëntor 2010	17	15	17	6	7	1	3	1	3	15	85
Dhjetor 2010	15	9	18	7	10	0	1	2	0	14	76
Janar 2011	18	11	20	5	16	0	0	2	1	7	80
Shkurt 2011	21	7	27	10	6	0	0	2	0	6	79
Mars 2011	26	7	28	4	7	1	0	0	0	11	84
GJITHSEJ	125	57	124	37	55	4	4	10	6	67	489

Tabela 200 - Të dhënat mbi konfiskimet në kufi gjatë periudhës raportuese (tetor 2010 - prill 2011)

	KAFSHË	DOKUMENTE	SUBSTANCA MARKOTIKE (KG)	DRUNJ (M ³)	AUTOMJETE	ARME	MUNICIONE (NJESI)	BANKËNOTA	BARNA (NJESI)	MALLRA (MISH, MIELL, ETJ.) (KG)	LENDE DJEGËSE (LITRA)	PËJE ALKOOLIKE (LITRA)	CIGARE (KUTI)	TË TJERA (TEKSTIL) (NJESI)
Tetor 2010	46	49	11.4	57.06	2	28	2225	0	0	0	280	0	1500	118
Nëntor 2010	4	120	4.504	92.1	15	5	184	29	2162	6232	1900	771	92	551
Dhjetor 2010	34	26	0	38.19	10	9	2513	0	0	1502	535	0	1060	812
Janar 2011	15	25	6	99.85	6	11	2031	0	2070	3033	200	50	102	780
Shkurt 2011	16	24	0	48.98	11	4	2861	3837	299	15249	1870	0	5527	1402
Mars 2011	37	38	0.01	114.75	9	5	775	362	99	26291	190	0	400	1451
GJITHSEJ	152	282	21.914	450.93	53	62	10589	4228	4630	52307	4975	821	8681	5114

3.3.4. Mbrojtja e të dhënave personale

Pas miratimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Qeveria ka dërguar emrat e 5 Mbikëqyrësve të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Kuvend, në shtator 2010, mirëpo kjo listë nuk u miratua nga Kuvendi. Si rezultat i shpërbërjes së

Kuvendit në nëntor 2010, Qeveria nuk ka qenë në gjendje të dërgojë listë të re ende në kohën e raportimit.

4. ANEKSI I: Lista e Legjislacionit Primar dhe Sekondar të miratuar gjatë periudhës 7 Tetor 2010 – 30 Prill 2011

Zyra e Kryeministrit

LIGJET:

1. Ligji për financimin e subjekteve politike, (gazeta zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010);
2. Ligji për prokurimin publik në Republikën e Kosovës, (gazeta zyrtare, nr.87, 16 nëntor 2010);
3. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/1-073 për zgjedhjet e përgjithshme në republikën e Kosovës, (gazeta zyrtare, nr.87, 16 nëntor 2010);
4. Ligji për qasje në dokumente publike, (gazeta zyrtare, nr.88, 25 nëntor 2010);
5. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/1-132 për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës, (gazeta zyrtare, nr.89, 30 nëntor 2010).

AKTET NËNLIGJORE :

1. Rregullore nr. 06/2010 për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, dt. 04.11.2010;
2. Rregullore nr.02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, dt. 22.03.2011;
3. Rregullore nr.03/2011 për shërbimin e komunikimit qeveritar me publikun, dt. 05.04.2011.

Kuvendi

AKTET NËNLIGJORE:

1. Rregullorja për Rendin dhe Qasjen e Mediave dhe të Publikut në punën e Kuvendit të Kosovës, e miratuar më 19 prill 2011

Ministria e Administratës Publike

LIGJET:

1. Ligji për konfliktin administrativ- është miratuar në Kuvend me 16.9.2010 dhe është shpallur në Gazetën Zyrtare me 21.10.2010
2. Ligji për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë- është miratuar në Kuvend 7.10.2010 dhe është shpallur në Gazetën Zyrtare me 3.11.2010.
3. Ligji për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës është miratuar në Kuvend 16.9.2010 dhe është shpallur në Gazetën Zyrtare me 21.10.2010.

AKTET NËNLIGJORE:

1. Rregullore për procedurat e rekrutimit, dt. 20.09.2010;
2. Rregullore për përshkrimin e vendeve të punës, dt. 20.09.2010;
3. Rregullore për orarin e punës, dt. 20.09.2010,
4. Rregullorja për përfaqësim të drejt dhe proporcional të komuniteteve jo shumicë në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dt. 20.09.2010;
5. Rregullorja për emërimin e nëpunësve civilë, dt. 21.12.2010.
6. Rregullorja për transferimin e nëpunësve civilë, dt. 21.12.2010
7. Rregullorja për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil, dt. 21.03.2011;
8. Rregullorja për punën provuese, dt. 21.03.2011;
9. Rregullorja mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendror të Nëpunësve Civilë, dt. 21.03.2011.

Ministria e Drejtësisë

LIGJET:

1. Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, është miratuar në Kuvend me 30.09.2010, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr. DL-053 -2010, Datë 18.10.2010;
2. Ligji për Prokurorin e Shtetit, Ligji është miratuar në Kuvend me 30.09.2010, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr. DL-049 -2010, Datë 18.10.2010;
3. Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, është miratuar në Kuvend me 30.09.2010, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr. DL-051 -2010, Datë 18.10.2010
4. Ligji për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës, është miratuar në Kuvend me 28.10.2010, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr. DL-068 -2010, Datë 09.11.2010.

AKTET NËNLIGJORE:

1. Rregullore për përzgjedhjen e pjesëmarrësve për trajnim në ndërmjetësim, dt. 09.02.2011;
2. Rregullore për trajnimin dhe certifikimin e ndërmjetësve, dt. 10.01.2011;
3. Kodi i mirësjelljes së ndërmjetësve në Republikën e Kosovës, dt. 22.10.2010;
4. Rregullore mbi regjistrimin e ndërmjetësve, dt. 22.10.2010.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

LIGJET:

1. Ligjin për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 03/L-226 (është miratuar me 28.10.2010

AKTET NËNLIGJORE:

Nuk ka pasur akte nënligjore të miratuara gjate kësaj periudhe.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

LIGJET:

1. Ligji nr.03/L-212 i Punës, (është miratuar me 01.11.2010, data e publikimit në gaz. Zyrtare me 01.12.2010, ndërsa ka hyrë në fuqi me **16.12.2010**).

AKTET NËNLIGJORE:

1. Udhëzimi Administrativ nr. 10/2010 për ofrimin e shërbimeve në komunitet-shtëpi për personat e moshuar dhe pa përkujdesje, nënshkruar më datën **25.10.2010**;
2. Udhëzimi Administrativ nr. 11/2010 për lajmërimin, suspendimin, riaktivizimin, riaplikimin dhe ndërprerjet e pagesave të pensionit themelor pas vdekjes së pensionistit, nënshkruar më datën **25.10.2010**;
3. Udhëzimi Administrativ nr.12/2010 për plotësimin dhe ndryshimin e udhëzimit administrativ nr. 08/2006 për punën e komisionit mjekësor lidhur me vlerësimin dhe caktimin e shkallës së invaliditetit të invalidëve të luftës, nënshkruar më datën **25.10.2010**;
4. Udhëzimi Administrativ nr.13/2010 për ofrimin e shërbimeve në komunitet-shtëpi për persona me aftësi të kufizuara mendore, ngecje në zhvillim mendor, nënshkruar më datën **01.11.2010**;
5. Udhëzimi Administrativ nr.14/2010, për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ nr. 05/2010 për rregullimin e procedurave për dhënien e lejeve për punë dhe punësimin e shtetasve të huaj në republikën e Kosovës, nënshkruar më datën **17.12.2010**;
6. Udhëzimi Administrativ nr. 01/2011 për përcaktimin dhe shqiptimin e gjobave për mos zbatimin të dispozitave të ligjit të punës, nënshkruar më datën **16.02.2011**;
7. Udhëzimi Administrativ nr.02/2011 për përmbajtjen dhe formën e librezës së punës, nënshkruar më datën **11.03.2011**;
8. Udhëzimi Administrativ nr. 03/2011 për trajtimin e fëmijëve kryerës të veprave penale, pa përgjegjësi penale dhe atyre me sjellje asociale, nënshkruar më datën **11.03.2011**;
9. Udhëzimi administrativ nr.04/2010 për ofrimin dhe sigurimin e përkrahjes financiare të OJQ-ve vendore gjatë vitit 2011, nënshkruar më datën **24.03.2011**;
10. Udhëzimi Administrativ nr. 06/2011 për punën dhe vendosjen e rezidentëve, personave me aftësi të kufizuara mendore – ngecje në zhvillimin mendor, në institutin special në shtime dhe në shtëpitë me bazë në komunitet, nënshkruar më datën **01.04.2011**;
11. Udhëzimi Administrativ nr. 07/2011 për punën dhe vendosjen e rezidentëve në shtëpinë e personave të moshuar dhe pa përkujdesje familjare dhe në shtëpitë me bazë në komunitet, nënshkruar më datën **01.04.2011**;
12. Udhëzimi Administrativ nr. 08/2011 për përcaktimin dhe sistemimin e punëve me rëndësi jetike të cilat duhet të kryhen gjatë mbajtjes së grevës, nënshkruar më datën **01.04.2011**.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

LIGJET:

1. Ligji për *Tregtinë me Mallra Strategjike*, Nr.03/L232, dt. 28.10.2010;

2. Ligji për Metrologji. **Nr.03/L203, dt. 28.10.2010;**
3. Ligji për Rezervat shtetërore te Mallrave, Nr.03/L244,dt. 28.10.2010;
4. **Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës, Nr.03/L229, dt. 07.10.2010.**

AKTET NËNLIGJORE:

1. UA Nr.16/2010, Për caktimin e lartësisë së taksave për licencimin e subjekteve nga sektori i naftës dhe derivateve të naftës, Implementon nenin 6 paragrafi 5.2. të Ligjit Nr.03/L-138 Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.2004/5 Për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë dt. e nënshkrimit **13.10.2010;**
2. UA Nr. 17/2010, Për klasifikimin dhe kategorizimin e objekteve hoteliere Implementon nenin 31 paragrafi 2 i Ligjit Nr.03/ L-168 “Për Turizmin dhe shërbimet turistike dt. e nënshkrimit **15.10.2010;**
3. UA Nr. 01/2011 Për përbërjen dhe rregullimin e këshillit të akreditimit, Implementon nenin, 4 paragrafi 4.3 nenit 15 paragrafi 15.4 të Ligjit Nr.03/L-69 “Për Akreditim, dt. e nënshkrimit **30.03.2011;**
4. UA Nr. 02/2011 Për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2010 Për licencimin e subjekteve ndërtimore, Implementon nenin 21 paragrafi 21.5 të Ligjit për Ndërtimin Nr. 2004-15, dt. e nënshkrimit **01.04.2011.**

Ministria e Punëve të Brendshme

LIGJET:

1. Ligji për ndryshim plotësimin e Ligjit nr 03/1037 për dokumentet e udhëtimit, dt. **07.10.2011;**

AKTET NËNLIGJORE:

1. Udhëzim Administrativ nr. 33/2010 për përbërjen e komisionit dhe procedurën e përzgjedhjes së kryeshefit ekzekutiv të inspektoratit policor të Kosovës., dt. **17.12.2010**
2. Udhëzim Administrativ nr. 31/2010 për letërnjoftim për të huajt, dt. **21.10.2010;**
3. Udhëzim Administrativ nr. 30/2010 për përcaktimin e procedurës për skanimin dhe përshkrimin e regjistrave të gjendjes civile, dt. **01.10.2010;**
4. Udhëzim Administrativ nr. 29/2010 për organizimin dhe strukturimin e brendshëm të qendrës së Kosovës për siguri publike, edukim dhe zhvillim, dt. **18.10.2010;**

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

LIGJET:

1. Ligji Nr.03/L-243 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2004/33 për Blegtorinë e Kosovës. Shpallur me Dekretin e U.d Presidentit të Republikës së Kosovës Nr. DL. 069-2010, dt. **09.11.2010;**

AKTET NËNLIGJORE:

1. Udhëzim Administrativ nr.11/2010 për regjistrin e prodhuesve të bimëve, përpunuesve, importuesve, shpërndarësve, deponuesve, paketuesve, eksportuesve, shitësve me shumicë të bimëve, pjesëve tjera dhe produkteve bimore, dt. **19.11.2010**;
2. Udhëzim Administrativ NR. 01/2011 Për Ndryshim Plotësimin e Udhëzimit Administrativ NR.10/2010 për Ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, të datës **19.08.2010**, i dt. **01.02.2011**.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

LIGJET:

Nuk ka ligje të miratuara brenda kësaj periudhe

AKTET NËNLIGJORE:

1. Udhëzim Administrativ Nr. 17/2010, Përcaktimi i kushteve, kriterëve dhe procedurave në përmbushjen e Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar, e dt. **19.11.2010**;
2. Udhëzim Administrativ Nr. 14/2010, Aplikimi i pagesave të studentëve në Universitetin e Prishtinës, e dt. **08.10.2010**;
3. Udhëzim Administrativ Nr. 15/2010, Për vlerësimin e pasurisë së MASHT-it, e dt. **15.10.2010**;
4. Udhëzim Administrativ Nr. 16/2010, Inventarizimi i pasurisë së MASHT-it, e dt. **15.10.2010**.

Ministria e Financave

LIGJET:

1. Ligji nr. 03/L-205 Për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, i publikuar me 10.12.2010;
2. **Ligji nr.03/L-204 Për Tatimin në Pronën e paluajtshme në Kosovë, i publikuar 25.11.2010;**
3. **Ligji nr. 03/ 196 Për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimin e Terrorizmit, i publikuar me 09.11.2010; dhe**
4. Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011, është miratuar me dt. **31 mars 2011**. U.D-së së Presidentit të Republikës së Kosovës ligjin në fjalë e ka Dekretuar me dt. **1 prill 2011**, Nr. DL-001-2011.

AKTET NËNLIGJORE:

1. Udhëzimi Administrativ nr. 12/2010, Për Udhëzimet e Përfundimit të Vitit fiskal 2010, i datës **26.10.2010**;
2. Udhëzimi Administrativ nr. 13/2010, Për zbatimin e Ligjit nr.03/L-161. Për Tatimin në të Ardhura Personale , i datës **25.11.2010**;
3. Udhëzimi Administrativ nr. 14.2010, Për zbatimin e Ligjit nr.03/L-162. Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave , i datës **25.11.2010**;
4. Udhëzimi Administrativ nr. 15.2010, Për zbatimin e Ligjit nr.03/L-222. Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i datës **25.11.2010**;
5. Udhëzimi Administrativ nr. 16.2010, Për Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore, i datës **15.12.2010**;

6. Udhëzimi Administrativ nr. 17.2010, Për Fillimin e vitit Financiar 2011, I datës 15.12.2010;
7. Udhëzimi Administrativ i Brendshëm nr. 02/2010, Për Pagimin e Shpenzimeve Postdiplomike dhe Kualifikimeve Profesionale, i datës **25.11.2010**;
8. Rregulla Financiare nr. 03/2010, Për të Hyrat.???(mungon data e miratimit, nënshkrimit, apo dekretimit)

Ministria e Punëve të Jashtme

LIGJET:

Nuk ka pasur Ligje te miratuara gjate kësaj periudhe.

AKTET NËNLIGJORE:

Nuk ka pasur akte nënligjore te miratuara gjate kësaj periudhe.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

LIGJET:

1. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, nr. 03/L-213, Dekreti Nr.DL-048-2010, dt. **14.10.2010**;
2. Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, nr. 03/L- 230, Dekreti Nr.DL-050-2010, dt. **18.10.2010**;
3. Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, nr. 03/L-233, Dekreti Nr.DL-054-2010, dt. **18.10.2010**.

AKTET NËNLIGJORE:

1. Udhëzim Administrativ- Nr. 21/2010 për Përcaktimin e Radhës së Përparësisë për Kategoritë e Familjeve që mund të Përfitojnë nga Programet e veçanta të Banimit, dt. **18.11.2010**;
2. Udhëzim Administrativ Nr. 22/2010 për Procedurat e Përfitimit nga Programet e Veçanta të Banimit, dt. **18.11.2010**;
3. Udhëzim Administrativ Nr. 23/2010 për Procedurat e Shpalljes së Programeve të Veçanta të Banimit, dt. **18.11.2010**;
4. Udhëzim Administrativ Nr. 24/2010 për Normat Minimale të Banimit për Banesat nga Programet e Veçanta të Banimit, dt. **18.11.2010**;
5. Udhëzim Administrativ Nr.01/2011 për Procedurat e Zhvillimit dhe Miratimit të Dokumenteve të Referimit për Teknikat më të Mira të Mundshme, dt. **31.03.2011**;
6. Udhëzim Administrativ Nr.02/2011 për Administrimin e Mbeturinave nga Gypat Fluorishent që Përmbajnë Merkur, dt. **31.03.2011**;
7. Udhëzim Administrativ Nr.03/2011 për Formën, Pëmbajtjen dhe Mënyrën e Plotësimit të Aplikacionit për Leje të Integruar, dt. **31.03.2011**;
8. Rregullore Nr.03/2011 për Mënyrën e Llogaritjes së Pagesës për Kontrollin Teknik të Objekteve, dt. **31.03.2011**.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik

LIGJET:

1. Ligji për Energjinë Nr.03/L-184, është shpallur me Dekretin e Presidentit, Nr. 058-2010 dt. **25.10.2010**;
2. Ligji për Energjinë Elektrike Nr.03/L-201, është shpallur me Dekretin e Presidentit, Nr. DL-060-2010 dt. **25.10.2010**;
3. Ligji për Rregullatorin e Energjisë Nr.03/L-185, është publikuar më 15 nëntor 2010; shpallur me Dekretin e Presidentit, Nr. DL-060-2010 dt. **25.10.2010**;

AKTET NËNLIGJORE:

1. Nr.01/2010 Për Sigurinë e Furnizimit në Sektorin e Gazit Natyror, dt. **30.09.2010**.

Ministria e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës

LIGJET:

Nuk ka ligje te miratuara brenda kësaj periudhe

AKTET NËNLIGJORE:

1. Rregullorja Nr.11/2011-MFSK për Marrëveshjet me Organizatat Joqeveritare dhe Institucionet Publike dhe Private dt. **15.10.2010**.
2. Rregullorja Nr.12/2011-MFSK për transferim ndërmjet komponentës rezervë dhe aktiv dt. **29.10.2010**.
3. Rregullorja Nr.13/2011-MFSK për Procedurat Administrative të Mobilizimit të komponentit rezervë në FSK dt. **29.10.2010**.
4. Rregullorja Nr.14/2011-MFSK për Planifikimin dhe përgatitjen e dislokimit të FSK-së, jashtë vendit dt. **26.11.2010**.
5. Rregullorja Nr.15/2011-MFSK për Punësim dytësor të pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dt. **08.12.2010**.
6. Udhëzim Administrativ 01/2011 për realizimin e procedurave të udhëtimeve zyrtare dt. **16.02.2011**.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

LIGJET:

Nuk ka ligje te miratuara brenda kësaj periudhe

AKTET NËNLIGJORE:

1. Rregullore nr.05/2010 për Organizimin dhe Funkcionimin e Kosovafilmit dt. **28.12.2010**;

2. Rregullore nr.04/2010 për Rendin Shtëpiak në ndërtesën e MKRS, dt. **05.10.2010;**
3. Udhëzimi Administrativ nr.14/2010 për Arkivin dhe Lëndën Arkivore në MKRS dt. **05.10.2010;**
4. Udhëzim Administrativ nr.13/2010 për Funkcionimin e Depos Qendrore të MKRS dt. **05.10.2010.**

Ministria e Shëndetësisë

LIGJET:

Nuk ka ligje të miratuara brenda kësaj periudhe

AKTET NËNLIGJORE:

1. Udhëzim Administrativ për Trajtim Mjekësor jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike në R.e Kosovës, Nr.03/2010, ka hy në fuqi me dt. **09.12.2010;**
2. Udhëzim Administrativ për Kushtet e Njohjes së Subspecializimeve të Specialistëve, Nr.04/2010, (është shfuqizuar nga Ministri i Shëndetësisë me Vendim nr.05-1284/2011 të datës 23.03.2011 . ka hy në fuqi me datë 03.12.2010.
3. Udhëzim Administrativ për Vaksinoprofilaksë, Seroprofilaks dhe Kimioprofilaks, Nr. 05/2010, ka hy në fuqi me dt. **23.11.2010;**
4. Udhëzim Administrativ Inkurajimi, mbrojtja dhe përkrahja e të ushqyerit me qumësht gjiri në Institucionet Shëndetësore të Republikës së Kosovës, Nr. 06/2010, ka hy në fuqi me dt. **24.11.2010;**
5. Udhëzim Administrativ për Kushtet teknike-mjekësore, hapësira dhe personeli sipas llojit të Institucionit Shëndetësor, Nr.07/2010 ka hy në fuqi me dt. **24.12.2010;**
6. Udhëzim Administrativ për Vendorsja e Banderollave në Produktet Medicinale që importohen, prodhohen dhe qarkullojnë në Republikën e Kosovës, Nr.08/2010 ka hy në fuqi me dt. **16.12.2010;**
7. Udhëzim Administrativ për Funkcionimi i Njësive për Menaxhimin e Projektit për TB dhe HIV/AIDS në Republikën e Kosovës, Nr. 09/2010, ka hy në fuqi me dt. **16.12.2010;**
8. Udhëzim Administrativ për Administrimin dhe Përdorimin e Metadonit për Programe Mbajtëse në Republikën e Kosovës, Nr.10/2010, ka hy në fuqi me dt. **20.12.2010;**
9. Udhëzim Administrativ për Edukim Specilistik Pasdiplomik, nr.11/2010 ka hy në fuqi me dt. **30.12.2010;**
10. Udhëzim Administrativ për Udhërrëfyesit dhe Protokollet Klinike, Nr.12/2010 ka hy në fuqi me dt. **30.12.2010;**
11. Udhëzim Administrativ për Kushtet e njohjes së subspecializimeve të specialistëve. 01/2011, ka hy në fuqi me datë 08.02.2011 me vendim të Ministrit është shfuqizuar (te caktohet data e vendimit për shfuqizimin e këtij UA).
12. Udhëzim Administrativ, Veprimtaria, Struktura dhe funksionet e shërbimeve Shëndetësore për HIV-AIDS 02/2011 ka hy fuqi me dt. **14.02.2011;**
13. Udhëzim Administrativ Njohja Nga Ana E Agjencisë Kosovare për Produkte Medicinale (Akpm) të autorizimeve të marketingut për produktet medicinale për përdorim njerëzor të lëshuara nga instituti federal gjerman për medikamente dhe pajisje medicinale (BfArM) 03/2011, ka hy në fuqi me dt. **21.02.2011;**
14. Udhëzim Administrativ Nr.04/2011 për Certifikatat Shëndetësore, ka hy në fuqi me dt. **18.02.2011.**

Ministria për Komunitete dhe Kthim

LIGJET:

Nuk ka ligje të miratuara brenda kësaj periudhe.

AKTET NËNLIGJORE:

1. Rregulloren për plotesim-ndryshimin e rregullores nr. 299 të dt. 16.03.2010 për financimin e projekteve të ojç-ëve për zhvillimin dhe stabilizimin e komuniteteve

Ministria e Integrit Evropian

LIGJET :

Nuk ka ligje të miratuara brenda kësaj periudhe.

AKTET NËNLIGJORE

1. Rregullorja Nr. 01/2011 për Departamentet për Integrit Evropian dhe koordinim të politikave në kuadër të Ministrive, miratuar me dt. **18.03.2011.**

Autoriteti i Aviacionit Civil

LIGJET:

Nuk ka ligje të miratuara brenda kësaj periudhe

AKTET NËNLIGJORE:

1. Rregullorja 6/2010 (transponim i rregullores EC No. 1032/2006) mbi kërkesat për sistemet automatike për shkëmbimin e shënime vetë fluturimeve me qëllim të notifikimit, koordinimit dhe transferimit të fluturimit midis njërive të kontrollit të trafikut ajror;
2. Rregullorja 7/2010 (transponim i rregullores EC No.1265/2007) mbi kërkesat e kanaleve ajër-tokë në qiellin e vetëm evropian;
3. Rregullorja 8/2010 (transponim i rregullores EC No.1321/2007) për përcaktimin e rregullave implementuese për integrimin e të dhënave të shkëmbyera në përputhje me Direktivën 2003/42/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, për ndodhitë në aviacionin civil në bazën qendrore të të dhënave;
4. Rregullorja 9/2010 (transponim i rregullores EC No.1330/2007) për përcaktimin e rregullave implementuese për shpërndarjen palëve të interesuara të informatave për ndodhitë në aviacionin civil, të listuara në Nenin 7(2) të Direktivës 2003/42/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian;
5. Rregullorja 10/2010 (transponim i rregullores EC No 104/2004) për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe përbërjen e Bordit të Apelit të Agjencisë Evropian të Sigurisë së Aviacionit;
6. Rregullorja 11/2010 (transponim i rregullores EC No 736/2006) mbi metodat e punës së Agjencisë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit për kryerjen e Inspektimeve të standardizimit;

7. Rregullorja 12/2010 mbi certifikimin e ofruesit të shërbimeve të navigacionit ajror
8. Rregullorja 13/2010 që amandamenton Rregulloren nr 4/2008 të 29 dhjetorit 2008 mbi licencën e kontrollorit të trafikut ajror;
9. Rregullorja 14/2010 (transponim i rregullores EC No 1794/2006) mbi vendosjen e skemës së përbashkët të tarifave për Shërbime të Navigacionit Ajror;
10. Rregullorja 15/2010 (transponim i rregullores EC No 1033/2006) mbivendosjen e kërkesave për procedurat e planeve të fluturimit në azën e para-fluturimit në Qiellin e Vetëm Europian;
11. Rregullorja 16/2010 (transponim i rregullores EC No 633/2007) mbi vendosjen e kërkesave për aplikimin e protokollit për transmetimin e porosive të fluturimit që ë përdoren për notifikim, koordinim dhe transferim të fluturimeve mes njësive të kontrollit të trafikut ajror;
12. Rregullorja 17/2010 (transponim i rregullores EC No 219/2007) mbi krijimin e një ndërmarrje të përbashkët për zhvillimin e gjeneratës së re të sistemeve evropiane për Menaxhim të Trafikut Ajror (SESAR);
13. Rregullorja 18/2010 (transponim i rregullores EC No 2150/2005) mbi rregullat e përbashkëta për përdorimin fleksibil të hapësirës ajrore;
14. Rregullorja 1/2011 mbi tarifën në aeroporte;
15. Rregullorja 2/2011 mbi tarifën terminale të navigacionit.

Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit

LIGJET:

Nuk ka ligje të miratuara brenda kësaj periudhe

AKTET NËNLIGJORE:

Rregulloret:

1. Aneksimin i Planit të Numeracionit Nr.15./07, i datës 22/10/2010
2. Rregullorja për "Analizën e tregut dhe definimim e ofruesve me fuqi të ndjeshme në treg", datë 20/12/2010, Nr.prot.115/1/10
3. Rregullorja për tarifimin e spektrit frekuencor, datë 25/10/2010, Nr.prot.95/1/10
4. Rregullorja për "Sigurimin Qasjes", datë 11/02/2011, Nr.prot.012/B/11
5. Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për Licenca dhe Autorizime, datë 03/03/2011, Nr.prot.017/B/11
6. Rregullorja për bashke-shfrytëzimin e plote dhe të përbashkët të lakut/nën lakut lokal, të miratuar me datë 08.04.2011

Vendimet:

1. Vendimi 33, 89/1/10 - Vendosja e tarifave në terminimin e thirrjeve mobile në mes operatoreve PTK sh.a. dhe IPKO
2. Vendimi 35 91/1/10 - Miratimi i Rregullores për tarifim të spektrit frekuencor
3. Vendimi 36 92/1/10 - Tarifat për Numeracion

4. Vendimi 38 96/1/10 - Aprovimi i Aneksit të Planit të Numeracionit për rrjetet telekomunikuese në Republikën e Kosovës
5. Vendimi 51 114/1/10 - Miratimi i Rregullores për Analizën e tregut dhe definimin e ofruesve me fuqi të ndjeshme në treg.
6. Vendimi 57, 001/B/11 - Formimi i Grupit Punues për Analizën e tregut dhe Definimin e ofruesve me fuqi të ndjeshme në treg (OFNT).
7. Vendimi 58, 002/B/11 - Analiza e tregjeve të telefonisë fikse
8. Vendimi 62 006/B/11 - Miratimi i Tabelës së shpërndarjes dhe shfrytëzimit të spektrit frekuencor të Kosovës
9. Vendimi 64 008/B/11 - Miratimi i Rregullores për Sigurimin e Qasjes
10. Vendimi 70 016/B/11 - Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për Licencë dhe Autorizime
11. Vendimi 81 022/B/11 - Miratimi i dokumentit për këshillim publik për Interkoneksionin
12. Vendimi 82 023/B/11 - Miratimi i Rregullores për Bashkeshfrytëzimin e plotë dhe të përbashkët të lakut/nën lakut lokal
13. Vendimi 84 027/B/11 - Alokimi i Numeracionit Gjeografik të serisë 2x dhe 3x

5. ANEKSI II: Tabelat

Tabela 21 - Të hyrat, shpenzimet dhe bilanci aktual për vitin 2010 dhe projekt-buxheti 2011

Përshkrimi	2009	2010 Realizimi	2011 Projekt-buxheti
<i>Në miliona euro</i>			
1. Të hyrat totale	1,147	1,126	1,264
Të hyrat nga tatimet	816	894	1,060
Të hyrat vendore	206	221	261
Të hyrat doganore	635	701	831
Kthimet	-26	-28	-31
Të hyrat jo-tatimore, THV	131	148	159
Të hyrat jo-tatimore	53	41	45
Të hyrat vetanake	78	106	114
Niveli komunal	49	52	58
Niveli qendror	29	54	55
Tantiemat			
Dividenda	200	85	45
2. Shpenzimet totale	1,136	1,202	1,434
Rrjedhëse	720	746	839
Pagat dhe mëditjet	264	311	383
Mallrat dhe shërbimet	198	182	184
<i>Nga të cilat: komunalitë</i>	19	20	25
Subvencionet dhe transferet	258	253	272
Transferet sociale	188	218	238
Subvencionet për NP	70	35	34
Projekti i BB (SEDPP)	0	0	0
Projekti IDA		0	0
Shpenzimet kapitale	400	455	572
<i>Nga të cilat: autostrada</i>		0	0
Rezerva	0	0	3
MM te organizatave buxhetore qendrore (THV)	0	0	20
Anetaresimi ne FMN	16		
3. Bilanci primar	11	-76	-170
Pagesa e interesit (borxhi i jashtëm)	1	10	11
Kredidhënia	79	60	45
Nga të cilat: kreditë për NP	79	60	45
Nga të cilat: kthimet nga NP	0		
4. Bilanci i përgjithshëm	-44	-145	-226
5. Financimi	-44	-145	-226
Financimi i jashtëm	-61.5	47	167
Pagesa e kryegjesë të borxhit	-61.5	-11	-11
Mbështetja buxhetore nga donatorët	0	30	70
Komisioni Evropian	0	30	50
Projekti i BB (SEDPP)	0		20
Huazimi nga jashtë	0	0	8
Huazimi nga INF	0	22	94
FMN	0	22	87
BB	0		7
Fondi i besimit	0	6	6
Financimi i brendshëm	50	98	59
Financimi i njeherëshëm	0	0	300
Huazimi i brendshëm	0		
Ndryshimi në bilancin bankar	50	98	-233
Ndryshimi në mjetet tjera financiare (KFW)	0	0	-8
Ndryshimi në stokun e THV	0	-5	0
6. Bilanci i BKK	187	244	477

Tabela 22 - Operacionet mujore të Qeverisë qendrore gjatë vitit 2010

Pershkrimi	Shpenzimet totale	Jan	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Shpenzimet totale	1,272	19.3	81.4	84.9	93.6	77.0	110.1	106.8	101.0	111.2	127.9	143.9	215.0
Niveli qendror	900.3	19.0	50.4	54.3	70.3	52.5	84.6	69.5	73.9	79.5	94.6	98.9	153.0
Pagat dhe medijtjet	165.0	-	25.5	12.8	13.7	13.2	13.6	13.2	13.2	12.9	13.7	13.7	19.5
Mallrat dhe sherbimet	135.9	2.3	6.9	13.0	8.9	9.3	12.7	7.6	8.5	9.6	9.1	12.2	35.9
Komunalite	11.3	0.1	1.5	1.2	1.4	0.7	0.7	0.4	0.8	0.7	1.0	1.2	1.7
Subvencionet dhe transferet	247.4	16.7	15.5	23.0	17.7	16.7	19.1	20.3	23.3	18.7	21.9	28.8	25.8
Nga te cilat NP:	38.6	0.7	1.2	4.5	-	1.0	2.7	0.4	7.4	3.0	5.2	6.4	6.1
<i>Energji</i>	29.0	-	-	-	-	-	2.7	0.4	6.4	2.8	5.2	5.8	5.7
<i>Hekurudhat</i>	0.5	-	-	-	-	-	-	-	0.5	-	-	-	-
<i>Ngrahetoret</i>	0.9	0.7	-	-	-	-	-	-	-	-	0.0	-	0.2
<i>Ujrat dhe hedhurinat</i>	0.6	-	-	0.1	-	0.1	-	-	-	0.3	0.0	0.0	0.1
<i>Energjia elektrike per rastet sociale</i>	4.5	-	-	4.3	-	-	-	-	-	-	-	-	0.2
<i>Minierat e Trepces</i>	3.1	-	1.2	-	-	0.9	-	-	0.5	-	-	0.5	-
Shpenzimet kapitale	340.8	-	1.1	4.3	28.6	12.7	38.5	28.0	28.0	37.6	48.9	43.0	70.1
Rezervat	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

Tabela 23 - Trendi i të hyrave buxhetore, 2007 - 2010




Tabela 24 - Operacionet mujore të Qeverisë lokale gjatë vitit 2010

Pershkrimi	Shpenzimet totale	Jan	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Komunat	301.4	0.0	27.7	19.7	20.4	21.0	21.3	23.8	24.2	27.8	30.1	31.4	54.0
Pagat dhe meditet	146.4	-	21.7	11.7	11.6	12.0	11.4	13.6	11.8	12.3	12.5	11.9	15.9
Mallrat she sherbimet	26.9	0.0	1.6	2.4	2.9	2.6	1.5	1.5	1.8	1.8	2.4	3.6	4.8
Komunalite	8.3	0.0	0.9	0.7	0.9	0.6	0.4	0.4	0.7	0.5	0.6	0.8	1.7
Subvencionet dhe transferet	5.3	-	0.4	0.6	0.5	0.5	0.5	0.3	0.3	0.6	0.4	0.4	0.9
Shpenzimet kapitale	114.6	-	3.2	4.3	4.6	5.3	7.4	7.9	9.8	12.6	14.2	14.6	30.7

Tabela 25 - Treguesit e sektorit bankar

Përshkrimi	Dhjetor 2010	Janar 2011
Struktura e sektorit financiar		
Bankat komerciale	77%	-
Kompanite e sigurimit	3%	-
Institucionet mikrofinanciare	4%	-
Ndihmësit tjerë financiar	0.6%	-
Fondet pensionale	15%	-
Totali (%)	100.0%	-
Struktura e sektorit bankar		
Numri i bankave (prej të cilave me pronësi të huaj)	8(6)	8(6)
Pjesëmarrja e bankave të huaja në sektorin bankar (% e aseteve)	92.0	92.0
Pjesëmarrja e bankave në pronësi shtetërore në sektorin bankar (% e aseteve)	0.0	0.0
C3 (% e aseteve)	77.0	76.8
Indeksi Herfindahl-Hirschman	2,303	-
Performanca		
Kreditë me probleme (% e totalit të kredive)		5.2
Raporti kredi-depozita (%)		75.4
Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (%)		18.8
Kthimi mesatar në asete (%)		1.6
Kthimi mesatar në kapital (%)		16.5
Niveli dhe kostoja e ndërmjetësimit		
Asetet e sektorit bankar (% e BPV-së)		62.0
Depozitat (% e BPV-së)	48.0	42.5
Kreditë sektorit privat (% e BPV-së)		36.0
Normat e interesit në kredi (%)	14.0	15.4
Normat e interesit në depozita (%)	3.0	3.4

Ndryshimi ndërmjet normes së intersave në kredi dhe depozita	11.0	12.0
Struktura e kredive e sektorit bankar		
Bujqesi (%)	4.0	3.7
Industri (%)	26.0	26.0
Shërbime (%)	70.0	70.3
Totali (%)	100	100

Tabela 26 - Trajnimet në Agjencinë Kosovare të Privatizimit

33 Zyrtarë	Trajnime në Kontabilitet
2 Zyrtarë	Rekrutimi/ Punësimi i Resurseve Njerëzore sipas Ligjit të ri për Shërbimin Civil dhe Ligjit të Punës në Republikën e Kosovës
3 Zyrtarë	Menaxhimi dhe Ekzekutimi I shpenzimeve publike nga Organizata Buxhetore në Kosovë
3 Zyrtarë	Teknikat e hartimit të Ligjeve
3 Zyrtarë	Organizimi I punës, Puna ekipore dhe Menaxhimi i kohës
1 Zyrtar	Rekrutimi/ Punësimi i Resurseve Njerëzore sipas Ligjit të ri për Shërbimin Civil dhe Ligjit të Punës në Republikën e Kosovës
Total:	45 Zyrtarë kane vijuar trajnimet gjate kësaj periudhe